



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 16/2024 regjistër (JR)  
Datë 14.05.2024

Nr. 70 i vendimit  
Datë 09.10.2025

**V E N D I M**  
**NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

<b>Rezarta Schuetz</b>	<b>Kryesuese</b>
<b>Ina Rama</b>	<b>Relatore</b>
<b>Sokol Çomo</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Albana Shtylla</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Natasha Mulaj</b>	<b>Anëtare</b>

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, në dhomë këshillimi, më 09.10.2025, ditën e enjte, në orën 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Theo Jacobs, me Sekretare Gjyqësore Ina Xhetani, vendimin për çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit, që i përket:

**ANKUES:** Subjekti i rivlerësimit, Pranvera Stafa, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

**OBJEKTI:** Shqyrtimi i vendimit nr. 740, datë 08.03.2024, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

**BAZA LIGJORE:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë; Neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë; neni 6 dhe 8 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; neni 62, 63, 65 e vijues i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; neni 46, 50 dhe 51 i ligjit nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, si dhe Kodi i Procedurës Civile në Republikën e Shqipërisë.

## Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, shqyrtoi pretendimet e kërkimet e subjektit të rivlerësimit të paraqitura në ankim, që përfundimisht kërkoi ndryshimin e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, nr. 740, datë 08.03.2024, dhe konfirmimin e saj në detyrë, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes, Ina Rama, si dhe pasi e bisedoi atë,

### VËREN:

#### I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Pranvera Stafa (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), për shkak të funksionit, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, në bazë të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, dhe të nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016, i është nënshtuar procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*.
2. Subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar pranë institucioneve kompetente dhe brenda afatit ligjor, në përputhje me nenet 31, pika 1, 35, pika 1 dhe 41, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, deklaratën e pasurisë, deklaratën për kontrollin e figurës dhe formularin e vetëvlerësimit profesional.
3. Nga raportet e dërguara në Komision nga organet ndihmëse, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim, “ILDKPKI”), Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (në vijim, “AKSIK”), dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim, “KLP”), për subjektin e rivlerësimit Pranvera Stafa (Selita) ka rezultuar si vijon.
  - 3.1 Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së<sup>1</sup>, në aktin e kontrollit konstaton se: (i) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin; (ii) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; (iii) nuk ka kryer fshehje të pasurisë; (iv) nuk ka kryer deklarim të rremë; (v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.
  - 3.2 AKSIK-u, në raportin e dërguar mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit Pranvera Stafa ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës<sup>2</sup>.
  - 3.3 KLP-ja ka hartuar raportin në lidhje me aftësitë profesionale, organizative, të etikës dhe të angazhimit ndaj vlerave profesionale, bazuar në përshkrimin dhe analizimin e formularit të vetëdeklarimit, tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, të dhënat e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit, pesë dosje penale të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, të dhëna nga 23 prokuroritë e rretheve

<sup>1</sup> Me nr. {\*\*\*} prot., datë 30.03.2018.

<sup>2</sup> Raporti nr. {\*\*\*} prot., datë 2.12.2017, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 8.08.2023 të KDZH-së.

gjqësore, Sektori i Protokoll-Arkivit, si dhe nga burimet arkivore të Sektorit të Burimeve Njerëzore.

## **II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit**

4. Komisioni kreu procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit për të tria kriteret e rivlerësimit. Në përfundim, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës, nenin D të Aneksit të Kushtetutës, në bazë të shkronjës “c”, të pikës 1, të nenit 58, dhe pikës 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, me vendimin nr. 740, datë 08.03.2024, Komisioni vendosi shkarkimin e subjektit nga detyra. Vendimi i Komisionit për subjektin e rivlerësimit është marrë bazuar në kriteret e vlerësimit të pasurisë, kontrollit të figurës, vlerësimit të aftësive profesionale, si dhe vlerësimin tërësor të çështjes, për të cilat është konkluduar se:

*4.1. Lidhur me kriterin e pasurisë, subjekti gjendet në kushtet e parashikuara nga neni 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, të cilat janë çmuar në vlerësimin tërësor të procesit për këtë subjekt.*

*4.2. Lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, referuar nenit DH të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut V të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.*

*4.3. Lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale, subjekti mund të arrijë në një nivelin (minimal) kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të shkronjës “c”, të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, problematikat e konstatuara në këtë kriter janë çmuar në vlerësimin tërësor të procesit për këtë subjekt.*

*4.4. Lidhur me vlerësimin tërësor të çështjes, duke marrë në konsideratë problematikat lidhur me kriterin e pasurisë, si dhe mangësitë e evidentuara në vlerësimin e aftësisë profesionale dhe denoncimet nga publiku, subjekti i rivlerësimit ka cenuar me sjelljen e saj besimin e publikut të sistemi i drejtësisë. Gjithashtu, trupi gjykues konstaton se numri më i madh i problematikave të evidentuara e analizuar në këtë vendim janë nga ankesat dhe/ose denoncimet e publikut, ku pesha e mangësive në vlerësimin tërësor të subjektit është e tillë që e bën të pamundur riparimin e tyre nëpërmjet programit të trajnimit të Shkollës së Magjistraturës dhe, si rrjedhojë, konkludoi se vazhdimi i ushtrimit prej saj të funksionit të prokurores do të ishte jo në përputhje me qëllimin dhe parashikimet e nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe, për pasojë, ato çmohen në zbatim të nenit 61, pika 5 dhe pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016.*

## **III. Shkaqet e ankimit**

5. Në respektim të afateve dhe kërkesave ligjore, subjekti i rivlerësimit ushtroi ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit (në vijim “Kolegji”) kundër vendimit të sipërpërmbledhur, adresuar aspekteve procedurale dhe atyre që lidhen me themelin e çështjes. Në përfundim të shkaqeve dhe parashtrimeve të paraqitura, me pretendimin se plotëson në mënyrë kumulative të tria kushtet e parashikuara nga neni 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, dhe në zbatim të kësaj dispozite duhet të konfirmohet në detyrë, subjekti i rivlerësimit kërkoi nga Kolegji: *Ndryshimin e vendimit nr. 740, datë 08.03.2024, të KPK-së, dhe konfirmimin në detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, të*

*subjektit të rivlerësimit, znj. Pranvera Stafa. Shkaqet e ankimit, të përmbledhura, parashtrohen si më poshtë.*

5.1. Për sa i përket argumenteve për cenim të procesit të rregullt dhe të aspekteve procedurale të procesit të rivlerësimit të saj, subjekti i rivlerësimit pretendoi: (i) mospërmbushje të standardit të gjykimit të çështjes në mënyrë të drejtë nga një gjykatë e pavarur dhe e caktuar me ligj, vlerësim të paplotë mbi kontrollin e aftësive të saj profesionale, të kryer jo në përputhje me parashikimet e nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, dhe mosmarrjes në konsideratë të asnjë argumenti e prove të paraqitur në kuadër të barrës së provës lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë; (ii) analiza financiare për vitet 1999 – 2003 nuk i është bërë me dije, as në përmbajtje të vendimit objekt ankimi; (iii) ekzistencë të elementeve të theksuara të paragjykimit, dalje jashtë diskrecionit të dhënë nga ligji prej Komisionit, konstatime të tij në cenim të parimit të sigurisë juridike, vendim të paracaktuar dhe të paarsyetuar për sa nuk analizohet për arsyet e mosmarrjes në konsideratë të analizës financiare të ILDKPKI-së, si dhe të asaj të paraqitur prej saj; (iv) interpretim dhe zbatim të gabuar të ligjit, për shkak të mosarsyetimit se cilat janë procedurat e shkelura prej saj në drejtim të vlerësimit të aftësive profesionale dhe si lidhet cenimi i besimit të publikut në raport me to.

5.2. Për sa i përket kriterit të vlerësimit të pasurisë, argumentet e subjektit, në mënyrë të përmbledhur, janë si më poshtë:

5.2.1. Lidhur me pasurinë “*depozitë bankare në llogarinë nr. {\*\*\*}, pranë BKT-së, Elbasan*”, në emër të saj, në vlerën 5.246 euro, nëse analiza financiare shtrihet në periudhë dhe më të hershme 1991 – 2003, rezulton mundësi për krijimin e depozitës në vitin 2004 me burime financiare të ligjshme. Në analizën financiare të Komisionit nuk janë përfshirë kursimet e krijuara nga puna në emigrim e bashkëshortit, si dhe nga aktiviteti i tij privat në qytetin e Elbasanit, për të cilat konkluzioni i Komisionit, se nuk gjen zbatim pika 2 e nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, vjen në kundërshtim me jurisprudencën e Kolegjit.

5.2.2. Lidhur me pasurinë “*depozitë bankare në llogarinë nr. {\*\*\*}, në FiBank*”, në shumën 2.000.000 lekë, në emër të personit të lidhur/bashkëshortit, nga një përlllogaritje e thjeshtë matematikore, referuar të ardhurave të provuara me dokumentacion dhe shpenzimeve të përlllogaritura për periudhën 01.01.2005 – 01.07.2005, do të rezultonte një balancë negative në vlerë të papërfillshme, prej (-) 73.154 lekësh.

5.2.3. Lidhur me pasurinë “*depozitë bankare në Union Bank*”, në shumën 14.103,17 euro, në emër të personit të lidhur/bashkëshortit, në vitin 2010, ka pasur të ardhura që justifikojnë mundësinë e kursimit dhe hapjen e depozitës bankare, marrja me qëllim përdorimi për vetëm 2 muaj, e shumës së kursimeve, në vlerën 6.000 euro, prej bashkëshortit B. S., nuk tregon për ndonjë veprim të vesuar të subjektit të rivlerësimit. Në analizën financiare duhet të përfshihet shuma 6.000 euro, e marrë hua nga prindërit e bashkëshortit dhe e kthyer brenda 2 muajve, dhe duhet të mos merret në konsideratë, në datën 18.08.2010, gjendja *cash* në shumën 125.000 lekë, e cila nuk krijohet proporcionalisht gjatë vitit, sikundër Komisioni arsyeton në mënyrë të gabuar.

6. Për sa i përket kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale, subjekti i rivlerësimit pretendoi se, në analizë të fakteve, interpretimit të ligjit të zbatueshëm dhe në bazë të parimit të objektivitetit dhe të proporcionalitetit, lidhur me çështjet penale të përzgjedhura dhe

denoncimet e shqyrtuara në kuadër të këtij procesi, gjetjet e konstatuara nuk janë të mjaftueshme për të konkluduar se ajo ndodhet në kushtet e nenit 61, pika 5, dhe nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016. Argumentet e subjektit për çdo çështje të shqyrtuar analizohen në vijim në shkaqet e themelit, por në fokus të tyre subjekti vendos:

6.1. Konkluzionet e Komisionit që lidhen me disa afate të procedimeve penale pa autor, nuk janë të mjaftueshme për të konkluduar se ajo ka shfaqur mangësi në drejtim të aftësive organizative, duke pasur në konsideratë se këto problematika janë të lidhura me ngarkesën e punës së përballuar prej saj.

6.2. Fakti që për disa prej vendimmarrjeve të saj nuk është ushtruar ankim mbështet arsyetimin se nuk ka bërë vendimmarrje të gabuar, për sa rezulton që vetë kallëzuesit kanë hequr dorë nga e drejta e pretenduar.

6.3. Fakti që Gjykatat e Shkallës së Parë apo të Apelit kanë konkluduar për miratimin e vendimmarrjeve të dhëna prej saj, provon që nuk ka shfaqje të mangësive në drejtim të aftësisë për të njohur ligjin dhe për të marrë në kohën e duhur vendimet.

7. Lidhur me vlerësimin tërësor të çështjes, subjekti i rivlerësimit pretendoi se përdorimi i arsytimit përgjithësues: *“në vlerësimin e përgjithshëm të procedurave të rivlerësimit”*, pa treguar cilat elemente procedurale janë vlerësuar në raport me treguesit e kritereve të rivlerësimit, si dhe me sjelljen e subjektit të rivlerësimit në kuadër të këtyre procedurave, përbën dalje jashtë diskrecionit, që ligji nr. 84/2016 i ka dhënë Komisionit. Sipas subjektit, *konkluzioni që subjekti i rivlerësimit Pranvera Stafa, pavarësisht se në vlerësim të secilit kriter veç e veç, pasuri, figurë dhe profesionalizëm, plotëson kriteret për t’u rikonfirmuar në detyrë, në kuadër të vlerësimit tërësor të procedurave shkarkohet nga detyra*, vjen në kundërshtim me parashikimet e ligjit nr. 84/2016, provat dokumentare të dosjeve penale të analizuara dhe praktikën e Kolegjit. Subjekti pretendoi se në rrethanat kur cenimi i besimit të publikut është i lidhur vetëm me kriterin e vlerësimit profesional, nuk mund të konsiderohet si element i mjaftueshëm për të konkluduar se ka cenuar besimin e publikut në sistemin e drejtësisë, sipas parashikimeve të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, pasi nuk ka bazueshmëri në vlerësimin e të tria kritereve<sup>3</sup>, kriteri i vlerësimit të pasurisë nuk tregon për deklaram të pamjaftueshëm dhe në kontrollin e figurës nuk konstatohet problematikë.

#### **IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelit**

##### ***Mbi aspektet procedurale të gjykimit***

##### *i. Juridiksioni i Kolegjit*

8. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion *ratione materiae* për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit. Për rrjedhojë, çështja me objekt kundërshtimin e vendimit të Komisionit, i cili ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

---

<sup>3</sup> Subjekti referon vendimin e Kolegjit nr. 46/2022 (JR).

*ii. Legjitimimi i ankueses*

9. Ankuesja legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe të nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

*iii. Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit*

10. Në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit kur ai bëhet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull, kryhet mbi bazë dokumentesh, në dhomën e këshillimit. Përgjashtim bëjnë rastet kur trupi gjykues vlerëson se plotësohen kriteret e nenit 51 të ligjit nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012”), për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve. Trupi gjykues i Kolegjit (në vijim trupi gjykues) e shqyrtoi këtë çështje në dhomë këshillimi, sipas parashikimeve të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012, pasi nuk konstatoi asnjë prej situatave të parashikuara në nenin 51 të ligjit nr. 49/2012, që diktojnë kalimin e çështjes për gjykim në seancë gjyqësore publike.

***Vlerësimi i shkaqeve të ankimit që lidhen me aspekte procedurale të procesit të rivlerësimit***

11. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se Komisioni nuk ka përmbushur standardin e gjykimin të çështjes në mënyrë të drejtë, nga një gjykatë e pavarur dhe e caktuar me ligj. Lidhur me këtë shkak ankimor, subjekti potencoi vlerësimin/kontrollin e paplotë të aftësive të saj profesionale, të kryer jo në përputhje me parashikimet e nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, ashtu edhe për mosmarrje në konsideratë të asnjë argumenti e prove të paraqitur prej saj në kuadër të barrës së provës lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë. Duke qenë se konstatohet se kryesisht pretendimet e subjektit për shkelje parimeve të procesit të rregullt ligjor, në thelb, synojnë të kundërshtojnë konkluzionet dhe vendimmarrjen e Komisionit lidhur me zgjidhjen e çështjes, dhe jo aspekte procedurale të procesit, ato do të gjejnë pasqyrim dhe vlerësim të plotë, dhe të integruar në shkaqet e ankimit që lidhen me themelin. Për pasojë, në kuadër të shqyrtimit të shkaqeve procedurale të ankimit, trupi gjykues do të analizojë vetëm ato të natyrës specifike procedurale. Në vijim, analiza e trupit gjykues.

**11.1.** Lidhur me pretendimin se: *në vlerësimin e aftësive profesionale, Komisioni është kontradiktor në konkluzion, mban qëndrim se subjekti i rivlerësimit arrin nivel “minimal”, që në kuptim të ligjit është kualifikues, dhe që nuk mund të përmirësohet nëpërmjet Shkollës së Magjistraturës, ndryshe nga sa perifrazon subjekti, në konkluzione, Komisioni shprehet se: çmon se, ndonëse subjekti mund të arrijë në një nivel (minimal) kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, problematikat e konstatuara në këtë kriter janë çmuar në vlerësim tërësor. Në vlerësimin tërësor të çështjes, ndër të tjera, duke theksuar se numri më i madh i problematikave të evidentuara dhe të analizuara janë nga ankesat dhe denoncimet e publikut, dhe se pesha e mangësive në vlerësimin tërësor të subjektit është e tillë që e bën të pamundur riparimin e tyre nëpërmjet programit të trajnimit të Shkollës së Magjistraturës. Për sa më sipër, në kushtet kur Komisioni ka kryer një vlerësim alternativ, bazuar në parashikimet e nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, nëpërmjet një vlerësimi tërësor të çështjes, pretendimi i subjektit për kontradiktoritet në konkluzionin për vlerësimin e aftësive profesionale, vlerësohet prej trupit gjykues, i pabazuar.*

11.2. Lidhur me pretendimet se: *raporti i inspektorëve, kriteret e vlerësimit të parashikuara në legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, aktet e dosjeve penale të analizuara nuk dëshmonin për paaftësi profesionale; nuk ka informacione të siguruara nga burime të tjera, pasi nuk ka pasur burime të tjera informacioni, pjesë e dosjes administrative apo të parashtruara në seancë dëgjimore; konkluzioni se rastet e analizuara krijojnë kushte për cenimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë është standard joligjor, nuk bazohet në prova e në ligj, bën që Komisioni të dalë jashtë diskrecionit të dhënë nga ligji për përmbushjen e funksioneve*, trupi gjykues konstaton dhe vlerëson si vijon. *Së pari*, çmon të sjellë në vëmendje qëndrimin e konsoliduar të Kolegjit, në të njëjtën linjë me qëndrimin e Gjykatës Kushtetuese<sup>4</sup>, se sipas përcaktimit të nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, organet e ngarkuara për vlerësimin etik dhe profesional të magjistratëve kanë rol ndihmës, por janë organet e rivlerësimit ato që kryejnë vlerësimin e aftësive profesionale, pa u kushtëzuar nga gjetjet e raporteve përkatëse. *Së dyti*, përderisa brenda objektit dhe qëllimit për vlerësimin e aftësive profesionale, në përputhje me procedurat dhe indikatorët e parashikuar në ligjin nr. 96/2016, Komisioni ka konkluduar për cenim të tyre, në dokumentin 1 të përzgjedhur nga subjekti, në dosjen nr. 2, përzgjedhur sipas sistemit rastësor, si dhe në rastet e disa denoncimeve, pretendimet e subjektit për standarde joligjore apo dalje jashtë diskrecionit prej Komisionit, vlerësohen prej trupit gjykues, të pabazuara.

11.3. Subjekti pretendoi *për cenim të parimit të sigurisë juridike*, pasi, sipas saj, në disa çështje, vlerësimi i rrethanave dhe mënyra e zbatimit të ligjit prej saj/prokurorit është kontrolluar nga gjykata, vendimmarrja gjyqësore nuk është cenuar, subjektet e ankuara kanë hequr dorë nga pretendimet e tyre, duke mos e ankimuar vendimin e prokurorisë apo të gjykatës, dhe Komisioni me qëndrimet e tij ka kontrolluar vendimmarrjen gjyqësore. Në konsideratë të qëndrimit të Kolegjit në jurisprudencën e tij, trupi gjykues sjell në vëmendje se procesi i rivlerësimit dhe shqyrtimi gjyqësor i vendimmarrjeve të prokurorit nuk janë dy forma kontrolli që përjashtojnë njëra-tjetrën, por ato vlerësohen në mënyrë harmonike për arritjen e konkluzioneve sa më të drejta dhe të sakta lidhur me kriterin të aftësive profesionale. Në këtë kontekst, trupi gjykues mban në konsideratë qoftë parimet mbi të cilat mund të argumentohet në mënyrë legjitime shkelje e parimit të sigurisë juridike, por edhe rrethanat konkrete të procedimeve të potencuara nga subjekti, shtjelluar gjerësisht në shkaqet e ankimit për themelin.

11.4. Subjekti pretendon se *nuk janë marrë në konsideratë asnjë prej argumenteve dhe provave të paraqitura prej saj në kuadër të barrës së provës; në vendim mungon arsytimi në lidhje me pretendimet e saj për burimin e ligjshëm të të ardhurave, dhe përse analiza financiare e bërë prej ILDKPKI-së dhe prej vetë asaj, nuk merret parasysh*. Lidhur me këtë grup pretendimesh, trupi gjykues konstaton dhe vlerëson si vijon. *Së pari*, Komisioni ka pranuar kërkesa të subjektit për kohë fizike shtesë, për paraqitje të provave të çmuara prej saj, si dhe ka pasqyruar në vendim të gjithë provat dhe shpjegimet e subjektit. Fakti që vlerësimi i provave, përfshirë edhe analizën financiare të paraqitur prej subjektit, është i ndryshëm nga pritshmëritë dhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit, nuk tregon se ka munguar vlerësimi i tyre, por tregon se provat e sjella, pasi janë shqyrtuar nga Komisioni, në këndvështrimin e tij, nuk kanë mundur të provojnë faktin për të cilin janë paraqitur. Ky vlerësim përfaqëson një pushtet diskrecional të Komisionit, në përputhje me atributet gjykuese e vlerësuese të tij në këtë proces, sipas parashikimeve të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. *Së dyti*, sa i përket peshës dhe

<sup>4</sup> Shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 2/2017.

ndikimit që ka raporti i kontrollit të kryer nga ana e ILDKPKI-së, në raport me vlerësimin përfundimtar të procesit të rivlerësimit të kryer nga institucionet e rivlerësimit, sikundër u theksua më lart në këtë vendim, është elaboruar gjerësisht nga Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 2/2017, sipas të cilit Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, bazuar edhe në hetimin administrativ që zhvillon ai vetë, dhe nuk është i kushtëzuar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

**11.5.** Subjekti pretendoi se, lidhur me argumentin e shprehur në vendim, *pas bërjes së analizës financiare për vitet 1999 – 2003, balanca nuk ndryshon*, kjo analizë nuk i është bërë e ditur, as në përmbajtje të vendimit përfundimtar dhe se nuk është bërë një analizë e plotë mbi të ardhurat dhe shpenzimet e familjes së saj, sipas dokumenteve provuese, duke ndjekur një standard tjetër nga të subjekteve të tjera të rivlerësimit, të ndodhura në të njëjtat kushte. Megjithëse, lidhur me pretendimet për analizën financiare, për vitet 1999 – 2003, analizohet gjerësisht në shqyrtimin e shkaqeve të ankimit të adresuara drejt kriterit të vlerësimit të pasurisë, në këtë moment, trupi gjykues çmon të ndalet në pretendimet e subjektit lidhur me aspekte procedurale të veprimtarisë administrative të Komisionit. Në këtë kontekst, në vendimin objekt shqyrtimi konstatohet se si një qasje garantiste, sipas pretendimit të përfaqësuesit të subjektit në seancë dëgjimore, Komisioni ka kryer përlllogaritjet edhe për periudhën 1999 – 2003, ku edhe sipas këtij varianti, subjekti është gjendur në pamundësi financiare në shumën (-) 903.600 lekë, që të investojë në depozitat bankare të krijuara në vitin 2004, pranë Intesa Sanpaolo Bank dhe ProCredit Bank. Me rezultatet e hetimit administrativ kryesisht, subjektit i ka kaluar barrë prove për pamundësinë financiare të rezultuar për krijimin e këtyre depozitave bankare me burime të ligjshme financiare, e cila ka rezultuar sipas analizës financiare të kryer nga janari 2004 deri në momentin e krijimit të depozitave. Me parashtrimet, subjekti ka paraqitur një analizë financiare për periudhën 2001 – 2003, për pasurinë “depozitë bankare”, të çelur pranë BKT-së, në vitin 2004, me çmuarje se këto të ardhura janë të mjaftueshme për të mbuluar diferencën e konstatuar nga Komisioni, në vitin 2004. Në seancë dëgjimore, përmes përfaqësuesit të saj, subjekti ka pretenduar që, për të identifikuar mundësitë e krijimit me burime të ligjshme të depozitave bankare në vitin 2004, analiza financiare duhet të fillojë nga viti 1999. Në këto rrethana faktike dhe ligjore, trupi gjykues sjell në vëmendje se në momentin procedural – seancë dëgjimore – kur subjekti ka ngritur pretendimin për shtrirje të analizës financiare përtej periudhës kohore që ajo vetë e ka identifikuar/prenduar në parashtrime, vinte në vështirësi Komisionin për një analizë të detajuar të kësaj periudhe, dhe për më tepër për vënien e saj në dispozicion të subjektit në këtë fazë të procesit. Pavarësisht ngritjes së pretendimit në këtë fazë të procesit në Komision, trupi gjykues, nëpërmjet Njësisë së Shërbimit Ligjor, kontrollon analizën financiare të kryer prej Komisionit, në formatin *Excel*, edhe për periudhën 1999 – 2003, sipas pretendimit të subjektit.

**11.6.** Gjithashtu, trupi gjykues vlerësoi të pabazuara edhe pretendimet e subjektit lidhur me *vlerësimin tërësor të çështjes*, sipas saj me përdorim të arsytimit përgjithësues dhe dalje të Komisionit jashtë diskrecionit të dhënë nga ligji nr. 84/2016. *Së pari*, lidhur me pretendimin e subjektit se, bazuar në parimin e objektivitetit dhe të proporcionalitetit, edhe në kuadër të vlerësimit tërësor të procedurave, nuk është e mjaftueshme për të konsideruar se subjekti ka kryer deklaram të pamjaftueshëm lidhur me kriterin e pasurisë, në konsideratë të qëndrimit të

Kolegjit në çështje të tjera<sup>5</sup>, trupi gjykues, duke sjellë në vëmendje se proporcionaliteti është një pjesë e tërësisë së parimeve nga të cilat udhëhiqen institucionet e rivlerësimit dhe nuk mund të gjejë zbatim si parim i veçantë dhe i vetëm i procesit të rivlerësimit, konstaton se Komisioni ka konkluduar për probleme lidhur me kriterin e pasurisë, si edhe kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, përfshirë këtu edhe ato të rezultuara nga denoncimet nga publiku. *Së dyti*, Komisioni, në ushtrim të funksioneve të tij, dhe në përputhje me kompetencat e dhëna prej ligjit nr. 84/2016, ka kryer vlerësim tërësor të procesit të rivlerësimit për subjektin Pranvera Stafa, dhe në këtë kontekst, duke marrë në konsideratë problematikat lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, për të cilin ka çmuar se subjekti gjendet në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, si dhe peshën e mangësive të evidentuara lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale dhe denoncimet nga publiku, i ka çmuar ato në zbatim të nenit 61, pika 5 dhe nenit 4 të ligjit nr. 84/2016<sup>6</sup>, duke konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë. Pavarësisht nga drejtësia e vlerësimit që Komisioni ka bërë për këto problematika, të cilat do të vlerësohen në vijim nga trupi gjykues, sipas një analize të ndryshme, parimisht, qasja procedurale e Komisionit për të vlerësuar konkluzionet e arritura prej tij, sipas dispozitave të mësipërme, gjendet një ushtrim i ligjshëm i diskrecionit.

12. Në përmbledhje të sa analizuar më sipër, në funksion të pretendimeve të subjektit me natyrë procedurale, trupi gjykues vëren se, përgjithësisht, procesi i rivlerësimit i kryer për subjektin në Komision është i rregullt dhe në përputhje me garancitë kushtetuese, ligjore dhe standardet ndërkombëtare të njohura.

### ***Vlerësimi i Kolegjit për shkaqet e ankimit që lidhen me kriterin e vlerësimit të pasurisë***

13. *Pasuria “depozitë bankare në llogarinë nr. {\*\*\*}”, pranë BKT-së, Elbasan, në emër të subjektit të rivlerësimit*

13.1. Në deklaratën *vetting*, subjekti deklaron: “*Depozitë bankare në llogarinë nr. {\*\*\*}, pranë BKT-së, Elbasan, në emër të Pranvera Stafa, në vlerën 5.246 euro, e hapur më datë 01.02.2006, e cila është shtuar në principal me vlerat 1.245 euro. Më datë 20.1.2017, vlera e depozitës është 8.250,97 euro, nga të cilat 6.492 euro principal dhe 1759,97 euro interes bankar. Kjo depozitë është krijuar me kursime familjare dhe interesat e vetë depozitës të marra ndër vite*”.

13.2. Komisioni, pas vlerësimit të situatës faktike në raport me pretendimet e subjektit, ka çmuar se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e parashikuara në nenin 33, pika 5, shkronja (nuk është përcaktuar), të ligjit nr. 84/2016, konkluzion i cili është vlerësuar në tërësi me rrethanat e çështjes, që janë përcaktuese për vlerësimin e kriterit të pasurisë apo procesin e rivlerësimit në tërësi.

---

<sup>5</sup> *Shih vendimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nr. 2/2020 (JR), datë 27.02.2020; nr. 20/2020 (JR), datë 08.09.2020; nr. 36/2020 (JR), datë 16.12.2020.*

<sup>6</sup> *Ligji nr. 84/2016, në nenin 4, të titulluar “Objekti dhe parimet e procesit të rivlerësimit”, në pikën 2, parashikon: “2. Komisioni dhe Kolegji i Apelimit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit. Vendimi merret bazuar në një ose disa prej kriterëve, në vlerësimin e përgjithshëm të të tria kriterëve, ose në vlerësimin tërësor të procedurave”. Ndërsa, në nenin 61, të titulluar “Shkarkimi nga detyra”, në pikën 5 parashikon: “Shkarkimi nga detyra i subjektit të rivlerësimit jepet si masë disiplinore në këto raste: ... 5. Në rast se nga vlerësimi tërësor, në kuptim të nenit 4, pika 2, të këtij ligji, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë dhe ndodhet në kushtet e pamundësisë për plotësimin e mangësive nëpërmjet programit të trajnimit”.*

13.3. Subjekti i rivlerësimit pretendon se konkluzioni i Komisionit vjen në kundërshtim me sa provuar prej saj me dokumentacionin e dorëzuar për provueshmërinë e burimit të të ardhurave, gjithashtu edhe me parashikimet e ligjit nr. 84/2016, kur subjekti nuk mund të provojë ndryshe, jo për fajin e tij. Në mbështetje të këtij pretendimi, subjekti, në mënyrë të përmbledhur, parashtron se Komisioni:

(i) Nuk ka mbajtur në konsideratë si provë informacionin shtesë të paraqitur në ILDKPKI, në vitin 2004, ku në lidhje me burimin e krijimit të depozitës bankare, të deklaruar në deklaratën periodike vjetore të pasurisë, të vitit 2004 (në vijim DPV), ka shpjeguar se kanë qenë *kursimet familjare ndër vite dhe të depozituara njëherësh në bankë, në vitin 2004*, duke korrigjuar rrjedhimisht edhe deklaratën e pasurisë të vitit 2003, ku nuk ka deklaruar gjendje *cash*. Ky sqarim në ILDKPKI, sipas qëndrimit të Kolegjit, duhet lexuar si korrigjim i deklarimeve të mëparshme, konkretisht të DPV-së të vitit 2003 dhe të DPV-së të vitit 2004.

(ii) Për krijimin e kësaj depozite, Komisioni ka kryer dy analiza financiare, në datën 14.06.2004, kur është depozituar shuma 6.000 euro (5000+1.000), si dhe në datën 17.11.2004, duke përllogaritur në to, të ardhurat e realizuara dhe shpenzimet e kryera nga data 01.01.2004, pa përfshirë kursimet e saj dhe të personit të lidhur/bashkëshortit, përpara vitit 2004.

(iii) Në kuadër të vlerësimit objektiv, real, proporcional, sikur të ardhurat dhe shpenzimet të llogariteshin sipas standardit të Kolegjit, familja e saj, me punën gjatë periudhës 1991 – 2001, ka pasur mundësinë të kursejë vlerën 903.600 lekë. Nëse analiza financiare shtrihet në periudhën 1991– 2003, provohet mundësia për krijimin me burime financiare të ligjshme të depozitave bankare në vitin 2004. Konkluzioni i Komisionit se nuk gjen zbatim neni 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në lidhje me të ardhurat nga emigracioni dhe aktiviteti tregtar për bashkëshortin, është në kundërshtim me ligjin dhe praktikën e Kolegjit, përderisa pamundësia objektive është e prekshme, për shkak të kohës së gjatë të kaluar dhe faktet si: lëvizjet migratore pas vitit 1990 dhe informaliteti i ekonomisë në ato vite; mungesa e të dhënave nga tatimet për të gjitha subjektet, ballafaqimi me konceptin e taksimit mbi të ardhurat në mënyrë të plotë vetëm pas miratimit të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998; deklarata e integruar e të ardhurave personale, zbatuar vetëm pas vitit 2012; licencimi i të parës bankë të nivelit të dytë, në vitin 1999 dhe pagesat e pagave përmes sistemit bankar vetëm pas vitit 2002.

13.4. Trupi gjykues, në kushtet kur pretendimet e subjektit potencojnë dy çështje: (i) analizën financiare, kohështrirjen dhe metodologjinë e saj; (ii) pamundësinë objektive sipas nenit 32/2 të ligjit nr. 84/2016, për të provuar të ardhura të bashkëshortit nga ushtrimi i aktivitetit privat dhe puna në emigracion, pasi analizoi në mënyrë harmonike të gjitha faktet e dala nga hetimi, në raport me ligjin e zbatueshëm, konstaton dhe vlerëson si vijon.

13.4.1. *Së pari*, depozita bankare në llogarinë nr. {\*\*\*}, pranë BKT-së, Elbasan, në emër të subjektit të rivlerësimit Pranvera Stafa, në vlerën 5.246 euro, e hapur në datën 01.02.2006, vjen si rezultat i transfertës nga një depozitë dyemërore, e krijuar në vitin 2004<sup>7</sup>, të cilën subjekti e

---

<sup>7</sup> Nga përgjigjet e subjektit dhe dokumentacioni i paraqitur prej saj, Komisionit i ka rezultuar se depozita e deklaruar në deklaratën vetting, me datë çelje 01.02.2006, vjen si rezultat i transfertës nga llogaria dyemërore Pranvera Stafa ose B. S. (bashkëshorti i subjektit), në të cilën janë kryer veprimet si vijon: (i) në datën 11.06.2004 është depozituar shuma 5.000 euro; (ii) në datën 14.06.2004 është depozituar shuma 1.000 euro dhe po në këtë datë, totali i shumave prej 6.000 eurosh (5.000 + 1.000) është investuar në depozitë; (iii) në datën 17.11.2004

deklaron në DPV-në e vitit 2004, si vijon: “*Depozitë bankare pranë BKT-Elbasan në shumën 10.039 euro, data e krijimit 11.06.2004. Pjesa takuese: 100%*”. Në “*Informacion shtesë për deklarinimin e pasurisë për vitin 2004*”, të depozituar pranë ILDKPKI-së<sup>8</sup>, subjekti deklaron se shuma e të ardhurave të depozitës bankare të deklaruar në DPV-në e vitit 2004, përbëhet nga kursimet familjare ndër vite dhe të depozituara njëherësh në bankë, në vitin 2004. Gjatë hetimit administrativ, lidhur me burimet e krijimit të depozitës në analizë, subjekti deklaron të kenë shërbyer kursimet familjare nga: (i) të ardhurat e bashkëshortit nga puna si mësues dhe drejtor shkolle, në vitet 1984 – 1993, nga puna në emigrim në vitet 1993 – 1995, në Turqi, nga ushtrimi i aktiviteteve privat, në qytetin e Elbasanit, në fushën e tregtimit me shumicë dhe pakicë, në vitet 1995 – 2001, nga puna si mësues në vitet 2002 – 2004; (ii) të ardhurat e saj nga puna si prokurore pranë Prokurorisë Elbasan, në vitet 1989 – 2004; (iii) pension invaliditeti dhe kujdestarie për djalë, në vitet 1999 – 2004.

13.4.2. *Së dyti*, lidhur me depozitën dyemërore pranë BKT-së, krijimit të saj/depozitimeve, Komisioni kreu analizën financiare: (i) në datën 14.06.2004, për vlerën 6.000 euro<sup>9</sup>; (ii) në datën 17.11.2004, kur është kryer depozitimi i shumës 4.000 euro. Gjatë periudhës 15.06.2004 – 17.11.2004, rezultoi se bashkëshorti i subjektit ka investuar edhe në depozita të tjera, konkretisht shumën 10.000 USD, në Intesa Sanpaolo Bank, në datën 25.06.2004, dhe shumën 700.000 lekë, në ProCredit Bank, në datën 30.07.2004, të cilat, ndonëse nuk deklarohen si pasuri në DPV-në e vitit 2004, janë përfshirë si shpenzime në analizën financiare të këtij viti. Lidhur me burimet e krijimit të depozitave pranë Intesa Sanpaolo Bank dhe ProCredit Bank, gjatë hetimit administrativ, subjekti i deklaroi të njëjtat si ato të depozitës pranë BKT-së – kursime nga të ardhurat nga puna e saj, puna e bashkëshortit, si dhe pensioni i invaliditetit të djalit, të mbajtura në banesë deri në vitin 2004, në të cilin u vendosën në bankë, ndarë në depozitat pranë BKT-së, Intesa Sanpaolo Bank dhe ProCredit Bank, ndërsa në parashtrimet në Komision ka deklaruar se si burim krijimi për dy depozitat pranë Intesa SanPaolo Bank dhe ProCredit Bank kanë shërbyer të ardhurat nga puna e bashkëshortit në emigrim, si dhe të ardhurat e tij nga aktiviteti privat. Nga analiza financiare, ku është përlllogaritur shuma prej 1.007.452 lekësh, e cila ka rezultuar si mundësi për kursim e subjektit dhe e bashkëshortit, për periudhën 2001 – 2003, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur: (i) kanë pasur mundësi financiare për krijimin e depozitës 6.000 euro, në datën 14.06.2004, dhe përballimin e shpenzimeve të tjera familjare (për periudhën 01.01.2004 – 14.06.2004); dhe (ii) nuk kanë pasur mundësi financiare në shumën (-) 1.135.564 lekë, për të investuar në depozitat pranë Intesa SanPaolo Bank dhe ProCredit Bank, si dhe të përballojnë shpenzimet familjare në periudhën 14.06.2004 – 17.11.2004. Sikundër u citua më lart, në funksion të një qasje garantiste, sipas pretendimit të subjektit në seancë dëgjimore, nga *përlllogaritjet*, duke përfshirë periudhën 1999 – 2003, subjekti ka rezultuar me një balancë negative në shumën (-) 903.600 lekë, ndërsa edhe sipas pretendimit tjetër të subjektit, duke u bazuar në dokumentacionin

---

*është depozituar shuma 4.000 euro dhe po në këtë datë, totali i akumuluar në llogari prej 10.039,62 eurosh (nga depozitimet dhe interesat) është investuar në depozitë; (iv) në datën 1.2.2006, shuma e akumuluar, prej 10.246 eurosh, është transferuar 5.000 euro në llogarinë e bashkëshortit dhe 5.246 euro në llogarinë e znj. Pranvera Stafa.*

<sup>8</sup> Përcjellë nga ILDKPKI-ja me nr. {\*\*\*} prot., datë 06.11.2023, në përgjigje të kërkesës së Komisionit.

<sup>9</sup> Për shkak të kohës shumë të afërt të dy depozitimeve, 5.000 euro në datën 11.06.2004, dhe 1.000 euro në datën 14.06.2004.

provues të depozituar për të gjitha të ardhurat e përfituara dhe shpenzimet e kryera, nga viti 1994 – 2003<sup>10</sup>, ka rezultuar sërish se subjekti dhe familja e saj gjenden në balancë negative<sup>11</sup>.

**13.5.** Sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se pretendimi i subjektit për shtrirje të analizës financiare për kontrollin e burimeve të këtyre depozitave, prej vitit 1994, është një pretendim i cili duhet të vlerësohet i drejtë. Siç është përshkruar si më sipër, ndonëse subjekti nuk ka deklaruar gjendje *cash* në deklaratën fillestare të pasurisë, në vitin 2003, ajo ka deklaruar krijimin e depozitës dyemërore në BKT, të marrë në analizë, në DPV-në e vitit 2004, pa deklaruar burimin e krijimit. Në deklaratën *vetting*, subjekti ka deklaruar si burim të krijimit të saj: *kursime familjare dhe interesat e vetë depozitës të marra ndër vite*, ndërsa në *informacion shtesë për deklarimin e pasurisë për vitin 2004*, depozituar pranë ILDKPKI-së, në vitin 2004, subjekti deklaron se: *shuma e të ardhurave të depozitës bankare, të deklaruar në DPV-në e vitit 2004, përbëhet nga kursimet familjare ndër vite dhe të depozituara njëherësh në bankë, në vitin 2004*. Në këtë kontekst, trupi gjykues vlerëson se, ndonëse në DPV-në e vitit 2004 nuk është përcaktuar burimi i krijimit të kësaj depozite, deklarimet e bëra rreth burimit në deklaratën *vetting* dhe në informacionin shtesë në ILDKPKI, shumë afër në kohë me deklarimin periodik, japin besueshmëri për vërtetësinë e tyre, për sa kohë që plotësimet e deklarimeve janë bërë me iniciativën e vetë subjektit. Në këtë kuptim, u gjet i drejtë pretendimi i subjektit se, për të kontrolluar burimin e krijimit të depozitës, analiza financiare duhet shtrirë që prej vitit 1994, përderisa nga aktet në fashikull u konstatua se të ardhurat e subjektit dokumentohen prej këtij viti. Ndërsa për periudhën 1989 – 1993, të pretenduar prej saj, trupi gjykues sjell në vëmendje qëndrimin e konsoliduar tashmë në jurisprudencën e institucioneve të rivlerësimit, se nuk mund të krijoheshin kursime për shkak të vlerave shumë të larta të inflacionit nëpër të cilat kaloi shoqëria dhe ekonomia e vendit në ato vite.<sup>12</sup>

**13.6.** Lidhur me pretendimet e subjektit për përfshirje në analizën financiare të të ardhurave të përfituara nga bashkëshorti nga emigrimi në Turqi, për vitet 1993 – 1995, si dhe nga aktiviteti tregtar në Elbasan për vitet 1995 – 2001, e se gjendet në kushtet e pamundësisë objektive sipas nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, për të siguruar dokumentacion provues lidhur me to, trupi gjykues vlerëson se të ardhurat e deklaruara me këto burime mbeten deklarative dhe pretendimet e tjera lidhur me to, të pabazuara. Në vijim, analiza e trupit gjykues.

**13.6.1.** Në deklaratën *vetting*, bashkëshorti i subjektit deklaron: *“Periudha pas dt. 31.08.1993 deri në fillim të vitit 1995 kam shkuar si emigrant ekonomik në Turqi, ku kam punuar në punë të ndryshme dhe jam marrë me tregti. ...Në vitin 1995 deri në fund të vitit 2002 kam punuar në tregti, në Durrës dhe Elbasan; në Elbasan kam pasur 2 dyqane, ku tregtoheshin pije, artikuj ushqimorë me shumicë e pakicë. Kam punuar në sektorin privat, pjesërisht në informalitet, për shkak të periudhës dhe kohës për të cilën bëhet fjalë... në mungesë të dokumentacionit për aktivitetin privat për shkak të kohës së largët, nga ana jonë është kërkuar informacion nga institucionet përkatëse ...por përgjigjet janë negative për atë periudhë, nuk disponohen të dhëna...kanë lëshuar deklarata disa nga personat që kam pasur marrëdhënie në fushën e tregtisë, në furnizimet me pije. Të ardhura të krijuara në periudhën e viteve 1993 – 2002,*

<sup>10</sup> Komisioni ka vlerësuar se të ardhurat e përfituara për periudhën 1989-1993 janë në një masë të tillë, që nuk mund të krijojnë kursime.

<sup>11</sup> Në analizën financiare (format Excel) rezulton balancë negative në shumën (-) 524.389 lekë.

<sup>12</sup> Shih vendimin e Kolegjit nr. 15/2021(JR), datë 18.06.2021.

periudhë që përfshin emigracionin ekonomik dhe aktivitetin tregtar, në kushtet e mungesës së dokumentacionit për shkak të kohës së largët, në mënyrë të përafërt janë mbi 6.000.000 lekë. Për shkak të mungesës së dokumentacionit provues, këtë shumë nuk po e vendos në kolonën përbri”. Nga dokumentacioni i administruar prej Komisionit, gjatë hetimit administrativ,<sup>13</sup> ka rezultuar se bashkëshorti i subjektit ka qenë i regjistruar si person juridik me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, datë 29.10.1997, dhe figuron si ortak në shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK, me objekt shitje më shumicë e pakicë, eksport-import etj., ndërsa Drejtoria e Përgjithshme Tatimeve nuk konfirmon asnjë të dhënë lidhur me ushtrimin e aktivitetit tregtar prej bashkëshortit të subjektit. Përveç se për të ardhurat nga emigracioni të bashkëshortit, për të cilat subjekti ka dështuar të provojë qoftë edhe qëndrimin e tij në Turqi, në periudhën e deklaruar, por edhe sa i përket të ardhurave nga aktiviteti tregtar, për të cilat deklararon se janë krijuar *pjesërisht në informalitet*, ato mbeten deklarative dhe nuk plotësojnë standardin e të ardhurës së ligjshme sipas parashikimit të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016. Në këto rrethana faktike dhe ligjore, pretendimi i subjektit për pamundësi objektive për të siguruar dokumentacion, sipas parashikimit të nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, vlerësohet i pabazuar, përderisa dokumentacioni nuk rezulton se ka ekzistuar as në kohën kur pretendohet se janë krijuar të ardhurat.

13.7. Mbështetur në sa më sipër, në funksion të përlllogaritjes së mundësisë për të përballuar me burime financiare të ligjshme pasuritë dhe shpenzimet e kryera gjatë kësaj periudhe, përfshirë në të depozitën objekt kontrolli, por edhe çdo shpenzim tjetër të kryer nga familja e subjektit, përmes Njesisë së Shërbimit Ligjor, në Kolegj u kontrollua analiza financiare e kryer nga Komisioni, duke e shtrirë atë për periudhën 1994 – 2003. Në këtë analizë u përfshinë të ardhurat e ligjshme të provuara me dokumentacion ligjor dhe shpenzimet e kryera, në të cilat shpenzimet e jetesës u përlllogaritën në masën 30% të të ardhurave deri në vitin 1999, sipas qëndrimit të konsoliduar të Kolegjit<sup>14</sup>, duke e gjetur të drejtë pretendimin e subjektit në këtë aspekt. Nga analiza e kryer mbi këto të dhëna, rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur nuk kanë pasur mundësi të përballojnë krijimin e depozitës dhe përballimin e shpenzimeve në nëntor të vitit 2004, për një vlerë prej (-) 6.279 lekësh.

14. *Pasuria “depozitë bankare në llogarinë nr. {\*\*\*}”, në FiBank, në emër të personit të lidhur B. S., në shumën 2.000.000 lekë*

14.1. Në deklaratën *vetting*, bashkëshorti i subjektit deklaroi: “*Depozitë bankare në llogarinë nr. {\*\*\*}, në FiBank, në emër të z. B. S., në shumën 2.000.000 lekë, e hapur në datën 13.08.2015, afati 24 muaj, me përqindje interesi 3.5 në bazë vjetore. Kjo depozitë është krijuar me kursime familjare dhe interesat e vetë depozitës të marra në vite. Fillimisht, kjo depozitë është hapur në Alpha Bank, në vitin 2005, në shumën 600.000 lekë, me nr. llog. {\*\*\*}*<sup>15</sup>”.

<sup>13</sup> Shkresa nr. {\*\*\*} prot., datë 16.3.2021, e përcjellë nga QKB-ja.

<sup>14</sup> Referuar vendimit nr. 15, datë 18.06.2021, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit. Nga përlllogaritja e shpenzimeve të jetesës në masën 30% të të ardhurave, deri në vitin 1999, kundrejt masës 66% të përlllogaritur prej Komisionit, u reduktua balanca negative (-) 524.389 lekë e rezultuar në Komision.

<sup>15</sup> Deklarimi i bashkëshortit të subjektit vijon: “Në vitet 2007 – 2008 – 2009 ka pasur vetëm shtesa në interesa bankare në shumat respektive 50.236 lekë, 49.764 lekë dhe 41.161 lekë. Në vitin 2010 është bërë shtesë depozite në shumën 240.000 lekë dhe shtesa në interesa ka qenë 19.185 lekë. Në vitin 2011 është bërë shtesë depozite në shumën 39.000 lekë dhe shtesa në interesa ka qenë 61.200 lekë. Në vitin 2012, shtesa në interesa ka qenë 64.634 lekë dhe më datë 25.7.2012 është bërë mbyllja e kësaj depozite. Më datë 25.7.2012 është hapur depozitë te FiBank,

14.2. Komisioni, lidhur me mundësinë e depozitimit të shumës 600.000 lekë, në momentin kur është çelur depozita në Alpha Bank, ka kryer analizën financiare për periudhën 01.01.2005 – 15.07.2005, në të cilën nuk ka marrë në konsideratë si gjendje *cash* të ardhurat e pensionit të invaliditetit të djalit të subjektit, duke arsyetuar se ato nuk janë deklaruar si të tilla dhe, për rrjedhojë, rezultati financiar negativ, në shumën (-) 327.113 lekë, e ka vendosur subjektin në kushtet e parashikuara në shkronjën “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, çmuarje e cila është vlerësuar në tërësi me rrethanat e çështjes, përcaktuese për kriterin e vlerësimit të pasurisë apo procesit të rivlerësimit në tërësi.

14.3. Subjekti i rivlerësimit sjell në vëmendje se, në DPV-në e vitit 2005, ka deklaruar: “*Librezë kursimi, Alpha Bank, në vlerën 600.000 lekë*” dhe “*Burim për çeljen e kësaj depozite janë të ardhurat nga puna të B. S., Pranvera Stafa dhe pensioni i invaliditetit për R. S.*”. Sipas saj, nuk ekziston diferenca e konstatuar prej Komisionit, e vetmja pasuri e krijuar në vitin 2005, ka qenë depozita e hapur në shumën 600.000 lekë dhe, nga përlllogaritja e thjeshtë matematikore e të ardhurave të provuara me dokumentacion dhe e shpenzimeve të përlllogaritura nga Komisioni, për periudhën 01.01.2005 – 01.07.2005, do të rezultonte balanca në vlerë të papërfillshme prej (-) 73.154 lekësh<sup>16</sup>.

14.4. Trupi gjykues, pasi analizoi në mënyrë harmonike të dhënat e rezultuara nga aktet në dosjen gjyqësore dhe të gjitha faktet e dala nga hetimi, në raport me ligjin e zbatueshëm, konstaton dhe vlerëson si vijon.

14.4.1. Në DPV-në e vitit 2005, subjekti deklaron: “*Librezë kursimi, Alpha Bank. Vlera 600.000 lekë. Pjesë takuese 50%*”, dhe në formularin “*Të dhëna që nuk publikohen*” deklaron: “*Librezë kursimi B. S., Alpha Bank, 600.000 lekë, datë 15.07.2005, nr. {\*\*\*}*”. Në DPV-në e vitit 2012, bashkëshorti i subjektit deklaron: “*Mbyllur depozita bankare në llogarinë nr. {\*\*\*}, në Alpha Bank, Elbasan, në emër të B. S., me datë 25.07.2012. Vlera 1.100.102 lekë +71.702 lekë interesa. Hapur depozitë bankare me nr. llogarie {\*\*\*}, në FiBank, me datë 25.07.2012. Shtesë depozite bankare në interesa, në llogarinë e mësipërme të FiBank Elbasan. Vlera 1.200.000 lekë; 75.348.36 lekë.*”

14.4.2. Sa më sipër, *së pari*, rezulton se në DPV-në e vitit 2005, subjekti nuk ka deklaruar burimin e krijimit të shumës 600.000 lekë, të depozituar në Alpha Bank, në datën 15.07.2005, sikundër pretendon në ankim, por me përgjigjet e pyetësorit nr. 3 ka deklaruar se burimet e krijimit të kësaj shume janë të ardhurat nga puna e saj dhe e bashkëshortit, si dhe pensioni i invaliditetit për djalin e saj, R. S. Në këtë pyetësor, këto burime krijimi deklarohen edhe për depozitat bankare të krijuara në vitin 2004, pranë BKT-së Elbasan (shuma 10.039 euro), pranë Intesa San Paolo Bank (shuma 10.000 USD) dhe pranë ProCredit Bank (shuma 700.000 lekë). Në parashtrimet për rezultatet e hetimit administrativ kryesisht, subjekti ka pretenduar: *sikurse*

---

*me nr. llog. {\*\*\*}, në shumën 1.200.000 lekë, nga të cilat 1.163.000 lekë vinin nga depozita e mbyllur në Alpha Bank dhe është bërë shtesë depozite në vlerën 37.000 lekë. Në vitin 2013 është bërë shtesë depozite në vlerën 220.000 lekë dhe shtesa në interesa ka qenë në vlerën 79.943 lekë. Në vitin 2014 është bërë shtesë depozite në vlerën 216.300 lekë dhe ka pasur shtesë në interesa në vlerën 83.710,09 lekë. Në vitin 2015 është bërë shtesë depozite në vlerën 156.500 lekë dhe shtesa në interesa ka qenë në vlerën 43.409 lekë. Në vitin 2016 është marrë interesi në vlerën 59.300 lekë”.*

<sup>16</sup> Subjekti referon shumën (-) 73.154 lekë, por referuar analizës financiare të Komisionit, ku është bazuar edhe subjekti, rezultati është (-)72.795 lekë.

*bashkëshorti depozitoi të gjitha kursimet tona në BKT, në shumën 10.000 euro, deri në datë 17.11.2004, depozitoi gjatë vitit 2005 dhe kursimet e ruajtura nga pensioni i invaliditetit. Së dyti, trupi gjykues konstaton se Komisioni, në rrethanat faktike të rastit, ka vlerësuar se ky pretendim, përpos se duket si përpjekje e subjektit për të rregulluar situatën financiare, e cila nuk përputhet me deklaratimet e saj në deklaratat periodike për gjendjen *cash*, ka vlerësuar se, edhe nëse ai do të merret në konsideratë, atëherë nga përlllogaritjet financiare konstatohet se ndërsa përmirësohet situata financiare e vitit 2005, ku subjekti ka rezultuar me balancë negative në vlerën prej (-) 327.113 lekësh, do të shndërrohej në situatë financiare negative ajo e vitit 2004, duke krijuar pamundësi financiare në kursimin e depozitës 10.000 euro në BKT<sup>17</sup>.*

**14.5.** Sa më sipër, lidhur me depozitim të shumës prej 600.000 lekësh, në datën 15.07.2005, e cila është edhe pjesa e depozitës në FiBank, në emër të personit të lidhur B. S., për të cilën Komisioni ka konkluduar se subjekti ka pasur një balancë negative dhe pamundësi për krijimin e saj me burime të ligjshme, trupi gjykues konstaton: (i) Në analizën financiare të Komisionit janë përfshirë të ardhurat e djalit të ndjerë të subjektit, nga pensioni i invaliditetit, ashtu si subjekti i pasqyron ato në analizën e përgatitur prej saj, në vlerën që i përket periudhës 01.01.2005 – 15.07.2005. Në këtë kuptim, duket se subjekti ka hequr dorë prej pretendimit të parashtruar në Komision, që në analizën financiare të periudhës 01.01.2005 – 15.07.2005, të përfshihen të ardhurat nga pensioni i invaliditetit të djalit për vitet 2002 dhe 2003, të ruajtura në gjendje *cash*, e të depozituara në bankë në vitin 2005. (ii) Në analizën e subjektit të pasqyruar në ankim, mbi bazë të së cilës pretendon se nuk ekziston balanca negative e Komisionit, por pamundësia financiare reduktohet në shumën (-) 73.154 lekë, konstatohet se në zërin “*ndryshim likuiditeti*”, subjekti ka përfshirë vetëm shumën e depozitës së hapur në Alpha Bank, prej 600.000 lekësh, duke përfshirë shtimin e likuiditeteve në llogaritë e tjera bankare, si cituar më lart, për rrjedhojë, kjo analizë financiare dhe rezultati i saj kanë pasaktësi. Në këtë situatë faktike dhe ligjore, trupi gjykues e gjeti të drejtë konkluzionin e Komisionit, se subjekti dhe personat e lidhur janë në pamundësi për të investuar me burime të ligjshme financiare krijimin e depozitës në datën 15.07.2005 dhe përbalimin e shpenzimeve, në vlerën prej (-) 327.113 lekësh.

- 15.** Pasuria “*Depozitë bankare në llog. nr. {\*\*\*}*”, në Union Bank, në emër të B. S., në shumën 14.103,17 euro

**15.1.** Në deklaratën *vetting*, personi i lidhur me subjektin/bashkëshorti, deklaroi: *Depozitë bankare në llog. nr. {\*\*\*}, tek Union Bank, në emër të B. S., në shumën 14.103,17 euro, me datë fillimi 26.10.2016, me afat 14-mujor. Kjo depozitë është krijuar me kursime familjare dhe interesat e vetë depozitës të marra ndër vite.*

*Fillimisht, kjo depozitë është hapur më dt. 10.12.2007, me nr. llog {\*\*\*} dhe principal 125.000 lekë, në emër të B. S. dhe R. S.; në vitin 2008 është bërë shtesë depozite në shumën 225.000 lekë; në vitin 2009 ka pasur shtesë në interesa në shumën 24.885 lekë; më dt. 06.10.2009 është mbyllur llogaria nr. {\*\*\*}, gjithsej në shumën 374.885 lekë. Më dt. 07.10.2009 është hapur depozitë e re, në emër të B. S. dhe R. S., po në Union Bank, në vlerën 6.000 euro (3.000 euro*

---

<sup>17</sup> Në Komision, subjekti ka pretenduar që në analizën financiare, për periudhën 2001 – 2003, të mos përfshijë të ardhurat e djalit nga pensioni i invaliditetit, për vitet 2002 dhe 2003, me pretendimin se i ka ruajtur ato duke i depozituar në bankë në vitin 2005, së bashku me kursimet e tjera, pretendim i cili nuk është marrë në konsideratë prej Komisionit.

*të konvertuara nga depozita në lekë, 374.885 lekë dhe shtuar depozita në vlerën 3.000 euro); në vitin 2010 është bërë shtesë depozite në vlerën 2.746 euro dhe marrë interes në shumën 253.8 euro; në vitin 2011 është bërë shtesë depozite në vlerën 522.58 euro dhe shtesa në interesa ka qenë 477.42 euro; në vitin 2012 është bërë shtesë depozite në vlerën 595.60 euro dhe marrë interes në shumën 404.40 lekë; në vitin 2013, depozita kalon vetëm në emër të B. S., marrë interes në vlerën 199.36 euro dhe është bërë shtesë depozitë në vlerën 800.65 euro; në vitin 2014 është marrë interes në shumën 499.71 euro dhe është bërë shtesë depozite në vlerën 500.29 euro; në vitin 2016 është bërë shtesë depozite në vlerën 1.000 euro dhe vlera e depozitës aktualisht është në shumën 14.103,17 euro. Shuma e interesit, për vitin 2016 është në vlerën 103.17 euro. Interesat e marra ndër vite në këtë depozitë janë investuar po në këtë depozitë.*

**15.2.** Komisioni, pas vlerësimit të situatës faktike në raport me pretendimet e subjektit, lidhur me shumën 9.000 euro, të depozituar në datën 18.08.2010, për të cilën subjekti ka pretenduar se 6.000 euro nga kjo shumë kanë burim huan e marrë prej prindërve të bashkëshortit, për një periudhë dymujore, duke evidentuar se gjatë procesit u provuan vetëm të ardhurat e tyre nga pensionet, vlera e të cilave në periudhën përkatëse rezultonte në masën që nuk arrin të mbulojë shpenzimet e jetesës së tyre, dhe për sa nga analiza financiare e kryer për subjektin e rivlerësimit ka rezultuar pamundësi financiare prej (-) 796.236 lekësh, ka çmuar se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e parashikuara në nenin 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, duke e vlerësuar këtë konkluzion në raport me rrethanat e çështjes, që janë përcaktuese për vlerësimin e kriterit të pasurisë apo procesit të rivlerësimit në tërësi.

**15.3.** Subjekti i rivlerësimit pretendon se konkluzioni i Komisionit është i padrejtë dhe i pabazuar në prova. Sipas saj, ka shpjeguar dhe provuar se:

(i) Bashkëshorti i saj ka deklaruar: – Në DPV-në e vitit 2009, mbylljen e depozitës në emër të B. S. – R. S., në monedhën lekë, duke e tërhequr të gjithë shumën dhe hapjen po në emër të tyre, të një depozite të re në Union Bank, në vlerën 6.000 euro, në datën 07.10.2009; – në DPV-në e vitit 2010, mbylljen e depozitës në Union Bank, në emër të B. S. - R. S., duke tërhequr, në datën 06.10.2010, të gjithë shumën 6.000 euro dhe interesin prej 253.8 eurosh, dhe hapjen, në datën 18.08.2010, të një depozite të re, po në Union Bank, në emër të të dyve, në shumën 9.000 euro, duke deklaruar si burimin përfundimtar të depozitës së fundit, mbylljen e depozitës 6.000 euro.

(ii) Komisioni, në analizën financiare për burimet e krijimit të shumës 9.000 euro, depozituar në datën 18.08.2010, nuk ka marrë në konsideratë deklarin se 6.000 euro kanë qenë kursime të prindërve të bashkëshortit, të dhëna hua për një periudhë të shkurtër kohe. Burimi i krijimit të huas së marrë nga prindërit e bashkëshortit është nga kursimet, nga të ardhurat nga pensionet dhe puna private e ushtruar prej tyre, përfshirë të ardhurat nga paga e E. S. (motra e bashkëshortit), që jetonte bashkë me ta, në emigrim dhe si mësuese, si dhe të ardhurat që B. S. (bashkëshorti) kishte dorëzuar në familje gjatë kohës që ishte në emigrim dhe ushtronte aktivitet privat tregtar. Motra e bashkëshortit, E. S., me deklaratën noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 14.02.2024, deklaroi se është në dijeni të shumës së dhënë nga prindërit, për përdorim për një periudhë 2-mujore, në vitin 2010. Huaja prej 6.000 euro, ndërmjet intervalit 08.08.2010 – 07.10.2010, e shlyer në fund të vitit 2010, nuk është deklaruar në DPV-në e vitit 2010, si burim krijimi i depozitës bankare në Union Bank, ku bashkëshorti ka deklaruar burimin përfundimtar që shërbeu për krijimin e depozitës prej 9.000 eurosh.

(iii) Në analizën financiare duhet të përfshihet shuma 6.000 euro e marrë hua dhe nuk duhet të merret në konsideratë gjendja *cash* në shumën 125.000 lekë, në datën 18.08.2010, pasi mund të ndodhë që ajo të krijohet edhe në ditët e fundit të vitit, duke tërhequr shuma monetare nga banka, dhe nuk qëndron arsyetimi i Komisionit se ajo krijohet proporcionalisht gjatë vitit.

15.4. Trupi gjykues, nga aktet në dosjen gjyqësore, në raport me pretendimet e subjektit dhe ligjin e zbatueshëm, konstaton dhe vlerëson si vijon.

15.4.1. Subjekti i rivlerësimit, në pyetësin nr. 1, deklaron se nuk ka marrë ndonjë hua gjatë periudhës së rivlerësimit,<sup>18</sup> ndërsa në pyetësin nr. 3, në lidhje me hapjen e depozitës në emër të bashkëshortit, në Union Bank, në datën 18.08.2010, dhe burimin e krijimit të shumës së depozituar, prej 9.000 eurosh,<sup>19</sup> subjekti deklaron: *“Në datën 18.08.2010 është çelur llogaria në vlerën 9.000 euro, ku si burim të ardhurash kanë qenë shuma 6.000 euro, kursime të prindërve të bashkëshortit, B. S. dhe 3.000 euro, të ardhura nga paga ime, të bashkëshortit dhe pensioni invaliditetit të djalit, R. S. U përdorën kursimet e prindërve të bashkëshortit për të hapur këtë depozitë, pasi afati i maturimit të depozitës të vitit 2009, prej 6.000 eurosh, ishte në tetor të vitit 2010. Në momentin që është mbyllur depozita në shumën 6.000 euro, vlera u është kthyer prindërve të bashkëshortit. Dokumentacion provues nuk disponoj, pasi kanë qenë marrëdhënie shumë të ngushta, prind – fëmije. Kjo shumë është marrë për përdorim vetëm për pak muaj. Qëllimi i hapjes së kësaj llogarie ishte me idenë e përdorimit të kësaj depozite si garanci për lëvizje jashtë shtetit, pasi problemet familjare shëndetësore të pjesëtarëve të familjes i kisha të tilla, pavarësisht se nuk u realizuan”*. Me parashtrimet për barrën e provës,<sup>20</sup> subjekti ka pretenduar se prindërit e bashkëshortit, përpos të ardhurave nga pensionet dhe *puna private e ushtruar prej tyre*, kanë përfituar të ardhura edhe nga bashkëshorti i saj, si fëmijë i tyre (të ardhurat e dorëzuara në familje gjatë kohës që ishte në emigrim dhe gjatë kohës që ushtronte aktivitet tregtar), e po ashtu edhe nga vajza që jetonte së bashku me ta dhe punonte si mësuese (edhe nga të ardhurat e saj në emigracion). Sa më sipër, përpos ndryshimit të qëndrimit lidhur me huan e pretenduar të marrë nga prindërit e bashkëshortit, fillimisht duke mos e deklaruar një të tillë, e më pas duke e pretenduar si burim krijimi të shumës së depozituar, subjekti nuk ka dëshmuar konsistencë edhe në lidhje me burimet e krijimit të saj, fillimisht duke referuar si të tilla kursimet e huadhënësve, e më tej se për krijimin e tyre kanë shërbyer edhe të ardhura të dorëzuara në familje nga bashkëshorti dhe e motra e tij.

---

<sup>18</sup> Në përgjigje të pyetjes: *“A keni marrë ndonjëherë borxh nga ndonjë person apo shoqëri private? Nëse po, lutem shënoni shumën, datën, marrëdhënien me huadhënësin, kushtet e shlyerjes dhe gjendjen e shlyerjes...”*.

<sup>19</sup> Në përgjigje të pyetjes: *“6. Në deklaratën periodike vjetore për vitin 2009, bashkëshorti juaj deklaroi hapjen e një depozite të re në Union Bank, në vlerën 6.000 euro, në emër të B. & R. S. Nga hetimi rezultoi se depozitimi është kryer në datën 07.10.2009 dhe po në këtë datë është investuar në depozitë. Lutemi deklaroni burimin e krijimit të kësaj depozite, si dhe depozitoni dokumentacion mbështetës. 6.1. Po në Union Bank, në llogarinë në emër të B. dhe R. S., bashkëshorti juaj ka depozituar, në datën 18.08.2010, shumën 9.000 euro, e cila, po në këtë datë, është investuar në depozitë. Lutemi deklaroni burimin e krijimit të kësaj depozite, si dhe depozitoni dokumentacion mbështetës”*.

<sup>20</sup> Me raportin e rezultateve të hetimit administrativ, Komisioni i ka kaluar subjektit barrë prove: *“Duket se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur mundësi financiare, në shumën 921.236 lekë, të investojë në depozitën 9.000 euro, si dhe të përballojë shpenzimet e tjera familjare. Duket se ka mungesë dokumentacioni për krijimin e të ardhurave të prindërve të bashkëshortit të subjektit, për të provuar huan 6.000 euro. Duket se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë, pasi nuk ka deklaruar, në deklaratën periodike vjetore të vitit 2010, burimin e krijimit të depozitës 9.000 euro”*.

15.4.2. Përpos sa më sipër, për pretendimet për të ardhura të anëtarëve të familjes së bashkëshortit që, sipas saj, kanë shërbyer për krijimin e kursimeve të prindërve të tij, subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues dhe, për rrjedhojë, pretendimet e saj mbeten deklarative. Në këtë kontekst, në konsideratë të qëndrimit të konsoliduar të institucioneve të rivlerësimit për vlerën e dobët provuese të deklaratave noteriale të hartuara gjatë procesit të rivlerësimit, deklarata noteriale e motrës së bashkëshortit së subjektit nuk mund të ketë vlerë provuese për pretendimin e subjektit lidhur me përdorimin për një afat 2-mujor të shumës prej 6.000 eurosh, si hua e dhënë prej prindërve të bashkëshortit të saj.

15.4.3. Gjithashtu, nga hetimi i kryer prej Komisionit për prindërit e bashkëshortit të subjektit, pensionistë<sup>21</sup>, rezulton se vlerat e pensionit duket të ketë qenë jo vetëm të ulëta, por edhe të vetmet të ardhura të provuara me dokumentacion, ndërsa masa e tyre bën të vështirë të besohet se ka mundur krijimin e kursimeve, qoftë edhe në rastin hipotetik, të pretenduar prej subjektit, se bashkëshorti dhe e motra kanë kontribuar me të ardhurat e tyre në familje. Përpos kësaj, si burim të të ardhurave të bashkëshortit dhe të motrës së tij për kontributet në familje, subjekti deklaron të ardhura, të cilat nuk përmbushin kriterin e ligjshmërisë në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

15.5. Për sa më sipër, lidhur me pasurinë “*depozitë bankare, në Union Bank, në emër të B. S.*”, objekt kontrolli, pretendimet e subjektit se si burim krijimi për depozitimin e shumës 9.000 euro, në datën 18.08.2010, ka shërbyer një hua e marrë nga prindërit e bashkëshortit, në shumën prej 6.000 eurosh, e krijuar me kursime të tyre, u gjendën nga trupi gjykues të pabazuara. Pas korrigjimit dhe saktësimit në analizën financiare të Komisionit, të një pasaktësie në hedhjen e të dhënave, lidhur me kreditimin e një vlere që përkon me pagën e subjektit për muajin maj të vitit 2010, balanca negative për krijimin e kësaj pasurie u reduktua në vlerën (-) 678.418 lekë.

16. Përveç sa më sipër, në kushtet e mungesës së shkaqeve të ngritura në ankim prej subjektit, trupi gjykues konfirmon, pa një analizë të dedikuar, balancën negative të konstatuar prej Komisionit lidhur me financimin e automjetit me targa {\*\*\*}, në vitin 2007, në vlerën prej (-) 68.115 lekësh, si edhe balancën negative totale të rezultuar prej analizës financiare të po këtij viti, në vlerën prej (-) 519.084 lekësh.
17. Në kushtet e mësipërme, në rezultatin financiar gjithëpërfshirës, totali i balancës negative që korrespondon sipas momenteve të krijimit të pasurive objekt kontrolli, rezulton të jetë në shumën (-) 1.079.925 lekë dhe, së bashku me balancën negative për periudhën e mbetur për vitin 2007, në një shumatore kumulative, arrin në vlerën prej (-) 1.530.894 lekësh.
18. Konkluzionet e mësipërme, të cilat e vendosin subjektin në situatën e kualifikueshme sipas nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, u vlerësuan prej trupit gjykues në kuadër të vlerësimit të përgjithshëm të të tria kriterëve, në zbatim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, sikundër ka bërë edhe Komisioni, por në kushtet e një balance negative më të ulët se ajo që kishte konsideruar Komisioni.

---

<sup>21</sup> Nëna, prej muajit maj 1991, me masë përfundimtare 16.219 lekë, babai, prej muajit shkurt 1992, me masë përfundimtare 17.367 lekë.

## ***Vlerësimi i Kolegjit për shkaqet e ankimit që lidhen me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale dhe të vlerësimit tërësor***

19. Lidhur me procedimin penal nr. {\*\*\*}/2015 (dokumenti ligjor nr. 2), i regjistruar ndaj shtetasit I. Ç., për veprën penale “*Vjedhje e energjisë elektrike ose impulseve telefonike*”, parashikuar nga neni 137/1 i Kodit Penal (në vijim K. Penal), për sa i përket kërkesës së subjektit në cilësinë e prokurores së çështjes, për vleftësimin e arrestit, caktimin e masës së sigurimit dhe gjykimin e shkurtuar, Komisioni ka konstatuar se subjekti, në kërkesën e saj, nuk ka arsyetuar mjaftueshëm *mbi përshtatshmërinë dhe proporcionalitetin e vendosjes së masës më ekstreme, në raport me rrethanat e dala nga kjo çështje*, që tregojnë se shtetasi I. Ç. ka qenë i papunë, invalid i grupit të dytë dhe me dy fëmijë të vegjël (pa ndonjë rrezikshmëri sociale, shkak largimi për të shmangur drejtësinë apo mundësi për të prishur provat), dhe parimet e sundimit të ligjit, në respektim të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, mangësi e cila është vlerësuar në tërësi në çështjen e rivlerësimit të subjektit. Komisioni ka konsideruar në konkluzionet e tij për këtë çështje edhe opinionin ligjor të përcjellë prej vëzhguesit ndërkombëtar të çështjes, në përputhje me nenin 49, pika 11 e ligjit nr. 84/2016, i cili ka pasur mendim lidhur me trajtimin e rastit.

19.1. Subjekti i rivlerësimit pretendon se arsyetimi i Komisionit vjen në kundërshtim me ligjin nr. 84/2016, në kundërshtim me interpretimin që Kolegji i ka bërë dispozitave të këtij ligji,<sup>22</sup> si dhe parimin e sigurisë juridike. Sipas saj, lidhur me kërkesën për vleftësimin e arrestit të shtetasit I. Ç., caktimin e masës së sigurimit dhe gjykimin e drejtpërdrejtë të procedimit penal nr. {\*\*\*}/2015, rezulton se çështja ka kaluar për gjykim, ajo që është kërkuar nga prokuroria është gjetur e drejtë dhe e arsyetuar nga gjykata, dhe ndaj vendimit të gjykatës nuk është ushtruar ankim. Parimi i të drejtës kërkon që kur flet gjykata, palët heshtin. Subjekti potencoi se cenimi i vendimmarrjes gjyqësore indirekt, nëpërmjet interpretimit ndryshe të Komisionit, përbën cenim të sigurisë juridike, duke argumentuar, në mënyrë të përmbledhur, si vijon.

(i) Ligjvënësi veprën penale të “*Vjedhjes së energjisë elektrike*”, të parashikuar nga neni 137 i Kodit Penal, e ka ndryshuar në vitet 2008 dhe 2014, për shkak të rëndësisë së faktit që kishte ndërprerja e këtij fenomeni të paligjshëm në Shqipëri. Dëmi nga ndërhyrjet e paligjshme në rrjetin elektrik, me qëllim vjedhjen e energjisë, me përhapje të madhe, me pasojë dëme aq të mëdha sa ndërhyrja në Kodin Penal, ishte parë si interes i lartë publik, duke e kthyer këtë veprë penale nga kundërvajtje penale në krim. Për shkak të rëndësisë së faktit dhe shkallës së rrezikshmërisë së paraqitnin personat që konsumonin këtë veprë penale, politika penale në vend ishte e tillë që hetimet zhvilloheshin me masë siguri që kufizonte lirinë ndaj tyre. Këto rrethana janë mbajtur në konsideratë në momentin e paraqitjes së kërkesës për vleftësimin e arrestimit dhe caktimin e masës së sigurimit për shtetasin I. Ç.

---

<sup>22</sup> *Subjekti referon qëndrimin e Kolegjit: “Në procesin e vlerësimit të kriterëve të aftësive profesionale në kuadër të procesit të rivlerësimit, është e nevojshme të mbahet në konsideratë fakti që subjektet vlerësohen sa u takon kualifikimeve të tyre dhe atësive për t’i vënë në jetë këto kualifikime në ushtrim të funksionit të tyre dhe përmbushjes së detyrave të përcaktuara nga Kushtetuta dhe ligji, dhe për rrjedhojë, në rastin e një prokurori, në përputhje me nenin 73 të ligjit nr. 96/2016, aspekti i njohurive ligjore vlerësohet duke u bazuar në aftësitë e tij për të hetuar, cilësitë e pranueshme në punë, respektimin e të drejtave të palëve ose viktimave, efikasitetin dhe efektivitetin në masën e pranueshme. Për rrjedhojë, organet e rivlerësimit çmojnë aftësitë profesionale të prokurorit, pa gjykuar mbi korrektësinë dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e prokurorit që vlerësohet”.*

(ii) Në kuadër të respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, çështja është dërguar me gjykim të drejtpërdrejtë, forma më e shpejtë e gjykimit, në mënyrë gjykata të vendoste llojin dhe masën e dënimit që do të arrinte qëllimet e dënimit penal. Referuar praktikës së Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, në çështje ku objekt gjykimi ka qenë shqyrtimi i kërkimeve për vleftësimin e arrestimit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit, është mbajtur në konsideratë jo vetëm fakti i arratisjes së personit apo pengimi i hetimeve, por edhe mundësia e përhapjes së veprës penale, si dhe ekzekutimi eventual i dënimit në funksion të realizimit të qëllimit të dënimeve, parandalimi i posaçëm dhe i përgjithshëm. Mundësia e përsëritjes së vjedhjes së energjisë elektrike, përsëritja e së njëjtës veprë penale, ka qenë e pranishme. Referuar dëshmisë së penalitetit, shtetasi I. Ç. rezultonte i dënuar tri herë më parë. Referuar pamjeve të vendit të ndërhyrjes në matës, ndërhyrja ishte e rrezikshme, lidhje telash jashtë çdo standardi, ku mundësia për rrezikim jete ishte e dukshme, fakt i pohuar edhe nga vetë shtetasi I. Ç.

(iii) Në lidhje me masën e dënimit të kërkuar janë mbajtur në konsideratë rrethanat lehtësuese të përmendura në përmbajtje të kërimit në vlerësim total të rrezikshmërisë së veprës penale, rrezikshmërisë së personit, si dhe rrethanave lehtësuese, siç parashikon neni 47 i Kodit Penal, mbi individualizimin e dënimit, duke vlerësuar se masa e dënimit të kërkuar i shërben qëllimit të dënimit. Këto rrethana janë vlerësuar edhe nga gjykata, që kërkimet e prokurorisë i ka gjetur të bazuara në prova dhe në ligj.

**19.2.** Nga aktet në dosjen gjyqësore, në raport me pretendimet e subjektit dhe ligjin e zbatueshëm, trupi gjykues konstaton dhe vlerëson si vijon.

**19.2.1.** Në kërkesën datë 12.10.2015, drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, “*Për vleftësimin e arrestit në flagrancë, caktimin e masës së sigurimit dhe gjykimin e drejtpërdrejtë të procedimit penal nr. {\*\*\*}, viti 2015*”, kundër të pandehurit I. Ç., me gjendje gjyqësore i dënuar më parë, i papunë, subjekti i rivlerësimit përshkruan rrethanat për arrestimin në flagrancë të këtij shtetasi, i dyshuar si autor i veprës penale “Vjedhja e energjisë elektrike ose impulseve telefonike”, parashikuar nga neni 137/1 i K. Penal, si dhe të dhënat e dokumentuara nga OPGJ-ja, nga verifikimi i të cilave ka vlerësuar të ligjshëm arrestin, të kryer në përputhje me nenin 251 e vijues të K. Pr. Penale. Në kërkesë pasqyrohet deklarimi i këtij shtetasi, si person ndaj të cilit zhvillohen hetime edhe si i pandehur, ndër të tjera: *[...] pranon se është debitor ndaj OSHEE Elbasan, pasi nuk ka paguar energji elektrike prej vitesh... pretendon se nuk ka pasur mundësi ekonomike të paguajë energjinë elektrike, pasi është invalid dhe i papunë. Për shkak se i është ndërprerë energjia elektrike dhe ka dy fëmijë të vegjël, ai e ka lidhur vetë energjinë elektrike... pasi nuk rrinte dot pa drita... [..]. Duke evidentuar se [..] ekzistojnë kushtet dhe kriteret e parashikuara në nenet 228/1, 3/a, b, 229/1, 2, 230/1 të K. Pr. Penale, që ndaj të pandehurit të caktohet një masë sigurimi personal me karakter shtrëngues. [..], dhe për sa i përket kriterëve për caktimin e masës së sigurimit [..] në rastin konkret duhet mbajtur parasysh rrezikshmëria shoqërore e veprës penale dhe të pandehurit, rrethanat në të cilat është kryer ajo, qëndrimin e mbajtur nga i pandehuri që në momentet e para, qëndrim pohues dhe pendues, faktin që është debitor ndaj OSHEE-së ndër vite etj. [..], subjekti ka kërkuar vleftësimin si të ligjshëm të arrestit në flagrancë të shtetasit I. Ç., caktimin ndaj tij të masës së sigurimit personal “arrest me burg”, e parashikuar nga neni 238 i K. Pr. Penale, dhe gjykimin e drejtpërdrejtë të çështjes.*

19.2.2. Në parashtrime, për shpjegimet e kërkuara prej Komisionit për dënime të mëparshme apo të dhëna për gjendjen shëndetësore të shtetasit Ç., subjekti ka depozituar *kopje të dëshmisë së penalitetit*, ku pasqyrohen 3 (tre) dënime për I. Ç. (atësia Q., mëmësia F.), pa të dhëna për kohët e vuajtjes së dënimeve, dhe veprat penale për të cilat është dënuar, si dhe kopje të *Librezë ndihmë paaftësie*<sup>23</sup> (masa e ndihmës Gr II-të 9900 lekë/muaj; periudha e përfitimit 01.04.2015 – 08.02.2017). Gjithashtu, duke shpjeguar se në këtë periudhë prokurorët pranë Prokurorisë Elbasan, si në të gjitha prokuroritë e vendit, për autorët e kësaj vepre penale kërkonin masë sigurimi arrest në burg dhe çështja kalonte në gjykim me procedurën e gjykimit të drejtpërdrejtë, subjekti ka bashkëlidhur treguesit statistikorë për vitet 2014 – 2015, të Prokurorisë Elbasan, në lidhje me kërkimet e kësaj prokurorie mbi masat e sigurimit dhe gjykimet e drejtpërdrejta për autorët e veprës penale të parashikuar nga neni 137 i Kodit Penal.

19.2.3. Për sa më lart, *a prima facia*, duket se subjekti nuk ka analizuar plotësisht rrethanat specifike të rastit, në kërkesën e saj për vlerësimin e ligjshëm të arrestit në flagrancë dhe kërkesën për caktimin e masës së sigurisë “arrest me burg”, të cilat në konsideratë edhe të situatës familjare të të pandehurit mund ta kishin dërguar subjektin në konkluzione e kërkime të ndryshme për llojin e masës së sigurisë ndaj këtij shtetasi, edhe në këndvështrim të jurisprudencës së GjEDNJ-së, e cila ka theksuar se, sipas nenit 5 të KEDNJ-së, arresti në burg duhet të udhëhiqet nga parimet e sundimit të ligjit, sigurisë juridike, proporcionalitetit dhe mbrojtjes nga arbitrariteti<sup>24</sup>. Pavarësisht kësaj analize, trupi gjykues mban në konsideratë se është një fakt jo vetëm i njohur botërisht, por edhe i provuar nga dokumentacioni i dorëzuar nga subjekti, se politika penale e institucionit të prokurorisë në ato vite ishte e orientuar drejt goditjes me forcë të fenomenit që lidhej me abuzimin me energjinë elektrike në vend, konsideruar si një nga prioritetet qeverisëse në atë kohë, të cilin prokuroria duhet ta ndjekë. Në këtë kuptim, vendosja e rastit në kontekstin e kohës kur ka ngjarë, zbeh nivelin e mangësisë në vlerësimin e duhur të rrethanave personale të të pandehurit, të cituara më lart. Gjithashtu, trupi gjykues mban në konsideratë faktin se subjekti ka dërguar çështjen për gjykim, në formën e gjykimit të drejtpërdrejtë, i cili është pranuar prej gjykatës dhe vetë të pandehurit. Kjo formë gjykimi, në këndvështrim të nenit 400 të K. Pr. Penale, shoqërohet detyrimisht me statusin e të pandehurit në masën e sigurisë “arrest në burg” dhe, si e tillë, vlerësohet se ajo i ka shërbyer në rastin konkret, edhe formës së gjykimit të zgjedhur prej prokurores. Nga ana tjetër, kjo formë gjykimi ka prodhuar shmangien e fazës së hetimeve paraprake për një vepër që dukej e provueshme që në fazën fillestare, një gjykim të shpejtë, ekzekutim të dënimit penal të dhënë nga gjykata, dhe vendosjen në kushtet e kufizimit të lirisë të të dënuarit, për një periudhë të arsyeshme, që prezumohet të ketë arritur qëllimin e dënimit të caktuar<sup>25</sup>.

19.2.4. Sa më sipër, lidhur me procedimin penal nr. {\*\*\*}/2015, ndaj shtetasit I. Ç. për veprën penale “*Vjedhje e energjisë elektrike ose impulseve telefonike*” trupi gjykues, ndonëse vlerëson se kërkesa e caktimit të masës së sigurimit “arrest me burg” për veprën penale të parashikuar

<sup>23</sup> *Bashkia Elbasan, Sektori i Ndihmës Ekonomike, dosja nr. {\*\*\*}*.

<sup>24</sup> *Shih vendimin e GJEDNJ-së në çështjen “Simons v. Belgium”, 2012, paragrafi 32, në të cilin arsyeton se: “Arresti në burg i një individi është një masë kaq e rëndë, saqë justifikohet vetëm kur masa të tjera më pak të rënda janë konsideruar dhe janë gjetur të pamjaftueshme për të mbrojtur individin ose interesin publik që mund të kërkojë që personi në fjalë t’i caktohet masa e arrestit në burg. Kjo do të thotë se nuk mjafton që heqja e lirisë të jetë në përputhje me legjislacionin e brendshëm, por duhet të kërkohet edhe nga rrethanat”.*

<sup>25</sup> *Vendos masën e dënimit të caktuar nga gjykata.*

nga neni 137 i Kodit Penal, nuk duket mjaftueshëm e përshtatshme në raport me rrethanat e faktit, ashtu si edhe vëzhguesi ndërkombëtar vlerëson në opinionin e tij ligjor, e konsideroi peshën e kësaj papërshtatshmërie në kontekstin e rrethanave të rastit, që përfshin politikën penale të kohës drejt goditjes së fenomenit, qëndrimet përgjithësisht të unifikuara të sistemit së prokurorisë në trajtimin e rasteve të ngjashme në të njëjtën periudhë, si dhe aplikimin e gjykimit të drejtpërdrejtë, duke synuar efikasitetin dhe kompensimin e pasojave represive që prodhon masa e sigurisë “arrest me burg”.

20. Lidhur me procedimin penal nr. {\*\*\*}/2014, që i përket dosjes nr. 2, regjistruar për veprën penale të “Falsifikimit të dokumenteve”, parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal, pas qëndrimit të subjektit, në përgjigje të barrës së provës<sup>26</sup>, si dhe nga analiza e akteve dhe rrethanave të shqyrtuara e vlerësuara, Komisioni ka çmuar se kohëzgjatja e këtij procedimi, edhe pse pa autor, për një afat prej 15 muajsh, është bërë pa shkaqe të justifikuara, duke konsideruar se subjekti ka shfaqur mangësi në drejtim të kriterit organizativ, përfshirë mbikëqyrjen e çështjes, si dhe mosveprimin me efikasitet në kryerjen e hetimeve, sipas nenit 74, pikat 4 dhe 5 të ligjit nr. 96/2016.

20.1. Subjekti i rivlerësimit pretendon se për këtë dosje penale, pa autor, për të cilën ka marrë vendim *për pushimin e çështjes*, aktet provojnë se ka deleguar veprimet hetimore në kohë, se ka ndjekur dhe orientuar hetimin në dinamikën e tij, dhe të dhënat nga aktet duhet të vlerësoheshin prej Komisionit në mënyrë harmonike në raport edhe me ngarkesën e punës të përballuar prej saj. Me pretendimin se konstatimet nuk mund të ngrihen në ato nivele sa të mund të konsiderohet se ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë, subjekti parashtron sa ka sqaruar, në kuadër të barrës së provës, në mënyrë të përmbledhur, si vijon:

(i) Kodi i Procedurës Penale vendos afate për përfundimin e hetimeve vetëm nëse është regjistruar emri i personit të cilit i atribuohet vepra penale, ndërsa nuk llogariten afate për përfundimin e hetimeve për procedimet penale ku nuk ka emër të shënuar në regjistrin e njoftimit të veprave penale, parim i konsoliduar nga e drejta procedurale, si dhe nga praktika gjyqësore në vend, deri në nivelin e gjykatave më të larta.<sup>27</sup> Kallëzuesi G. K. nuk referonte ndonjë të dhënë konkrete apo veprime konkrete të ndonjë personi, por dyshonte se i kallëzuar A. K., që i kishte bllokuar rrugën, duke qenë kryeplak, mund të kishte përvetësuar tokë *shtet* nëpërmjet falsifikimit të dokumenteve.

(ii) Detyra e prokurorit është ushtruar plotësisht në përputhje me parashikimet e nenit 24/1 të K. Pr. Penale, në ushtrimin e ndjekjes penale, drejtimit dhe kontrollimit të hetimeve paraprake dhe veprimeve të OPGJ-së. Nuk ka pasur mbajtje të çështjes penale nën hetim pa veprime hetimore në vijimësi, provuar nga dokumentacioni i dosjes, administrimi i përgjigjeve nga institucionet diktonte kërkim informacioni shtesë, në varësi të pretendimeve të ngritura prej kallëzuesit dhe personat e pyetur mbi rrethanat e faktit. Çdo dy javë ka pasur nisje shkresash për institucionet, administrim dhe studim material nga prokurori, dhe në varësi të rrethanave

---

<sup>26</sup> Komisioni i ka kaluar subjektin barrë prove: dukej se moskryerja e veprimeve hetimore dhe mbajtja e çështjes nën hetim për një kohë relativisht të gjatë dukej e pajustificuar nën pretendimin e moskryerjes së veprimeve nga OPGJ-ja, pasi sipas nenit 24/1 të Kodit të Procedurës Penale, prokurori ushtron ndjekjen penale..., drejton dhe kontrollon hetimet paraprake dhe veprimtarinë e Policisë Gjyqësore, si dhe kryen vetë çdo veprim hetimor që e çmon të nevojshëm.

<sup>27</sup> Subjekti referon vendimin unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nr. 3, datë 27.09.2022.

planifikoheshin hetime shtesë, duke kërkuar edhe dokumentacion shtesë, pra njëherazi kontrollim të veprimeve hetimore të OPGJ-së, i cili merr urdhra me shkrim dhe me gojë prej prokurorit. Prokurori nuk ka pengesë edhe për të kryer veprimeve hetimore vetë, por përfaqësimi i akuzës në gjykim, numri i lartë i dosjeve penale në gjykim dhe hetim, mosfunksionimi i prokurorisë me numër të plotë prokurorësh, nuk i jep mundësinë e kryerjes së veprimeve hetimore që i delegohen OPGj-ve.

(iii) Nga OPGj-ja pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan, veprimet hetimore janë kryer në një shtrirje kohore prej gati një viti, diktuar nga natyra e hetimit, por të kontrolluara plotësisht prej prokurorit. Duke qenë se hetimet ishin të shtrira në kohë, referuar natyrës së çështjes, nga ana e prokurorit është vendosur zëvendësimi i OPGj-së pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan, me varësi të dyfishtë, me një OPGj pranë prokurorisë, që është më pranë prokurorit dhe që mund t'i shërbente më mirë përshpejtimin të veprimeve hetimore. Pas kryerjes së të gjitha veprimeve hetimore të nevojshme prej OPGj-së, përfundimin e të gjitha veprimeve në kuadër të planit hetimor, është dhënë zgjidhje përfundimtare nga prokurori, duke vendosur pushimin e hetimeve.

(iv) Vendimmarrja është kontrolluar e gjetur e rregullt nga Drejtuesi i Prokurorisë dhe Prokuroria e Përgjithshme/Drejtoria Task-Forcë, dhe ndaj vendimit nuk është ushtruar ankim, provuar me shkresën nr. {\*\*\*}, datë 15.12.2023, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

**20.2.** Nga aktet në dosjen gjyqësore, në raport me pretendimet e subjektit dhe ligjin e zbatueshëm, trupi gjykues konstaton dhe vlerëson si vijon.

**20.2.1.** Subjekti i rivlerësimit, në datën 16.01.2014, me Urdhrin “Për regjistrimin e procedimit penal”, ka urdhëruar të kryhet regjistrimi i procedimit penal me nr. {\*\*\*}, për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186 i K. Penal, mbi bazën e kallëzimit të shtetasit G. K., pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan, të bërë në datën 23.12.2013, dhe me Urdhrin “Për kryerjen e veprimeve hetimore”, urdhëron OPGJ-në K. Zh., të kryejë disa veprime hetimore, brenda datës 16.03.2014. Ndër veprimet e urdhëruara për kryerje renditen: *të thirret/pyetet shtetasi G. K. lidhur me faktin objekt hetimi/të sjellë/paraqesë dokumentacionin në origjinal; të thirret/pyetet shtetasi A. K. lidhur me faktin objekt hetimi/të sjellë/paraqesë dokumentacionin në origjinal; të thirret/pyetet shtetasi H. Ç. topograf në Peqin lidhur me faktin objekt hetimi...; të merret dokumentacioni përkatës pranë ZVRPP Peqin për sipërfaqet e tokës së shtetasve G. K. dhe A. K. në këtë pjesë për të cilën ata kanë konflikt me njëri-tjetrin...; pas grumbullimit të materialit shkresor, dokumentacionit, të ngrihet puna për ekspertimet e nevojshme teknike për vërtetimin e faktit nëse kemi të bëjmë me falsifikim dokumentesh apo jo; të kryhet çdo veprim i nevojshëm që del gjatë hetimit të çështjes; të mbahet kontakt i vazhdueshëm me prokurorin lidhur me ecurinë e hetimeve.*

**20.2.2.** Nga aktet në dosje rezulton një dinamikë intensive e kërkesave të prokurorisë drejtuar institucioneve të treta për sigurimin e dokumentacionit të nevojshëm lidhur me këtë procedim penal, si edhe përgjigjet e administruara prej tyre, të cilat fillojnë prej datës 21.02.2014 deri në 29.12.2014, kohë gjatë së cilës janë kryer edhe aktekspertime në terren, sipas urdhrave të

prokurores/subjektit, dhe në prani të palëve dhe të OPGJ-së<sup>28</sup>. Pas vendimit të datës 07.05.2015, për kryerjen e ekspertimit tekniko-topografik, duke përcaktuar 4 pyetje për ekspertin e caktuar

---

<sup>28</sup> Lidhur me korrespondencën me institucionet e treta, përgjigjet prej tyre dhe dokumentacionin e kërkuar/dërguar, rezulton si vijon:

- Në datën 21.02.2014, prokuroria i adreson shkresë ZVRPP-së Peqin për dërgimin e kopjeve të njësuara të pasurive të kallëzuesit dhe të kallëzuarit [të pasurive të ndodhura në fshatin Bishqem/Komuna Pajovë Peqin, me nr. {\*\*\*}, në pronësi të shtetasit G. K.; të pasurisë në emër të shtetasit A. K., të cilën ia ka blerë shtetasit P. S.]. Në datën 24.02.2014, ZVRPP-ja Peqin kthen përgjigje, së bashku me dokumentacionin e kërkuar.

- Në datën 29.04.2014, prokuroria adreson kërkesa për: (i) ZVRPP-në Peqin, për dërgimin e kopjes së praktikës së shpronësimit të shtetasit A. K., për pjesën e pasurisë me nr. {\*\*\*}, ZK {\*\*\*}; (ii) Zyrën e Administrimit të Tokës Peqin, për dërgimin e kopjeve të njësuara të formularëve A6-ATM, në pronësi të secilit prej shtetasve P. S., G. K. dhe R. K.; (iii) Prefekturës Elbasan, për dërgimin e kopjeve të njësuara të formularëve A6-ATM, të secilit prej shtetasve P. S., G. K. dhe R. K.; (iv) Komunës Pajovë, për informacion dhe kopje të njësuar të praktikës së shpronësimit të shtetasit A. K., për pjesën e pasurisë me nr. {\*\*\*}, Komuna Pajovë/Peqin; (v) Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës për informacion dhe kopje të njësuar të praktikës së shpronësimit të shtetasit A. K., për pjesën e pasurisë me nr. {\*\*\*}, Komuna Pajovë/Peqin. ZVRPP-ja Peqin kthen përgjigje në datën 8.05.2015.

- Në datën 22.07.2014, Prokuroria i adreson kërkesë Komunës Pajovë Peqin, për dërgimin e listës emërore të personave që janë shpronësuar për ndërtimin e seksionit rrugor Rrogzhinë-Elbasan, konkretisht për fshatin Bishqem Kodër/Komuna Pajovë Peqin dhe praktikën e shpronësimit për kalimin e rrugës për shtetasit P., F., M., A., M. S. Shkresa është konceptuar/sigluar nga OPGJ-ja K. Zh. dhe miratuar nga Prokurorja Stafa.

- Në datën 08.08.2014, Prokuroria adreson kërkesa për: (i) Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave Tiranë për dërgim të kopjes të njësuar të praktikës së shpronësimit të disa shtetasve me mbiemër S.; (ii) ZVRPP-së Peqin, nëse veprimet e bëra me pasurinë nr. {\*\*\*}, ZK {\*\*\*}, si bashkim/ndarje/transaksione, a janë të rregullta dhe a janë kryer në përputhje me ligjin; (iii) Këshillin e Qarkut Elbasan/Departamentin e Administrimit të Mbrojtjes së Tokës për dërgimin e kopjeve të njësuara të formularëve A6-ATM, në pronësi të secilit prej shtetasve P. S., G. K. dhe R. K. Shkresat, konceptuar/sigluar nga OPGJ-ja, nuk janë të sigluara nga Prokurorja Stafa. Përgjigjet kthehen: ZVRPP Peqin, në datën 25.08.2014; DPA Tiranë, në datën 18.08.2014; Këshilli i Qarkut Elbasan, në datën 15.08.2014.

- Në datën 29.10.2014, Prokuroria adreson kërkesë Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave për dërgimin e listës emërore dhe praktikën e shpronësimit për kalimin e rrugës për shtetasit P., F., M., A., M. S. DPA/Arkivi Qendror Shtetëror Tiranë kthen përgjigje, në datën 11.11.2014, që materiali i plotë do të dorëzohet nga Ministria pas përpunimit.

- Në datën 10.11.2014, Prokuroria adreson kërkesë ZVRPP Elbasan për kopje të praktikave të pasurisë së shitur nga P. S. të shtetasit E. H., të shpronësimit të pasurisë së shtetasit P. S. për ndërtimin e rrugës automobilistike dhe pasurisë të llojit "përrua", në pronësi shtet nr. {\*\*\*}. ZVRPP Elbasan kthen përgjigje në datën 19.11.2014.

- Në datën 14.11.2014, prokuroria adreson kërkesa për: (i) Komunën Pajovë/Peqin për dërgim të kopjes së njësuar të praktikës së shpronësimit për ndërtimin e rrugës automobilistike në fshatin Bishqem, për pasurinë {\*\*\*}, ZK {\*\*\*}, për shtetasin P. S.

- Në datën 02.12.2014 është kërkuar kryerja e një ekspertimit teknik nga ing. gjeodet H. B., në prezencë të OPGJ-së, për t'i dhënë përgjigje pyetjeve për vendndodhje të pronave të shtetasit S. sipas ATMP-së dhe të shtetasit K. me nr. {\*\*\*}, dhe a bëhet pengesë prona me nr. pasurie {\*\*\*}, për të shkuar te prona me nr. pasurie {\*\*\*}.

- Në datën 16.12.2014, prokuroria adreson kërkesa për: (i) Drejtorinë Rajonale të Mirëmbajtjes së Rrugëve Elbasan, për dërgimin e dokumentacionit tekniko-ligjor për shpronësimin e personave për ndërtimin e seksionit rrugor Rrogzhinë-Elbasan, konkretisht për fshatin Bishqem Kodër/Komuna Pajovë Peqin. Shkresa ka koncept. / printoi dhe sigluar P. Stafa. (ii) ZVRPP Peqin, për dërgim informacioni çfarë statusi kanë pasuritë nr. {\*\*\*} dhe nr. {\*\*\*}.

- Në datën 19.12.2014, prokuroria adreson kërkesa për: (i) Komunën Pajovë/Peqin për informacion nëse ka rrugë për të shkuar tek prona e tij, nr. {\*\*\*}, shtetasi G. K. (ii) Këshillin e Qarkut Elbasan për dërgimin e dokumentacionit tekniko-ligjor të shpronësimit të personave për ndërtimin e aksit rrugor Rrogzhinë-Elbasan, fshatin Bishqem, të shpronësuar me VKM-në nr. 190, datë 08.04.1999.

- Në datën 29.12.2014, prokuroria adreson kërkesa për: (i) Këshillin e Qarkut Elbasan, për dërgimin e informacionit për shpronësimin e pronarëve për ndërtimin e seksionit rrugor Rrogzhinë-Elbasan, konkretisht për

për sqarimin e çështjes, ku pasqyrohen edhe të dhëna të informacionit të administruar në datën 15.06.2015, duke konkluduar se veprimet e ZVRPP-së Peqin janë në përputhje me ligjin dhe nuk ka elemente të veprës penale të “Shpërdorimit të detyrës”, në mbështetje të nenit 328/1 germa “b” të K. Pr. Penale, subjekti ka marrë vendimin “Për pushimin e çështjes”.

**20.3.** Trupi gjykues, nga sa pasqyruar në poshtëshënimin 28, konstaton se kërkesat e adresuara, fillimisht në datën 29.04.2014, për dy institucione, janë vijuar prej prokurorisë deri në fund të vitit 2014, duke e zgjeruar si objektin e kërkimit (listën e plotë të të shpronësuarve dhe dokumentacionin përkatës), ashtu edhe numrin e institucione të adresuara, duke krijuar bindjen për veprime hetimore të derivuara gjatë zhvillimit të hetimeve, sikundër subjekti pretendon *se administrimi i përgjigjeve nga institucionet diktonte kërkim informacioni shtesë, në varësi të pretendimeve të ngritura nga kallëzuesi dhe personave të pyetur mbi rrethanat e faktit*, dhe ndjekje logjikshëm të hetimit prej subjektit. Në këto kushte, edhe koha e marrë për hetimin vlerësohet si e arsyeshme. Në këtë kontekst, evidentohet gjithashtu se ky procedim është kontrolluar edhe nga Prokuroria e Përgjithshme, Drejtoria Task-Forcë, e cila me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 15.12.2015, pas shqyrtimit të akteve mbi bazën e ankimit të shtetasve G. dhe R. K., ka konstatuar se nga ana e kësaj prokurorie janë kryer të gjitha veprimet e mundshme dhe të duhura hetimore, nuk ka vend për të kryer ndonjë veprim tjetër hetimor dhe se vendimi i pushimit është i bazuar në ligj, përfundim me të cilin janë njohur edhe ankuesit. Gjithashtu, ndaj vendimit të subjektit për pushimin e procedimit penal nuk është ushtruar ankim.<sup>29</sup>

**20.4.** Në vijim të sa më sipër, reagimi i subjektit për zëvendësimin e Oficerit të Policisë Gjyqësore të ngarkuar me hetimin me një tjetër, vlerësohet prej trupit gjykues si një masë e përshtatshme e marrë në momentin që është konsideruar i nevojshëm, duke qenë se nuk evidentohen problematika që sugjerojnë marrjen e këtij vendimi më parë, siç Komisioni konkludon. Për pasojë, konkluzioni se afati i hetimit prej 1 vit e 5 muaj demonstroi mangësi në drejtim të aftësive organizative të subjektit, gjendet prej trupit gjykues i pambështetur në fakte, dhe pretendimet e subjektit vlerësohen të bazuara e të drejta.

- 21.** Lidhur me procedimin penal nr. {\*\*\*}/2013, që i përket dosjes nr. 3, Komisioni konkludon se: *edhe në këtë rast, subjekti ka mbajtur të njëjtin qëndrim lidhur me tejkalimin e afatit të kryerjes së hetimeve, duke deklaruar se nuk është detyrim vendimmarrja (ndërmarrja e akteve) për shtyrjen e afatit të veprimeve hetimore në referencë të nenit 323/2 të K. Pr. Penale, dhe se për këto çështje nuk ka afat për përfundimin e hetimeve dhe mbarimin e afatit 3-mujor.*

**21.1.** Subjekti i rivlerësimit pretendon se, edhe në rastin e këtij procedimi penal, ka kryer detyrën në konformitet me parashikimet ligjore dhe nuk ka demonstruar sjellje që kanë shkaktuar zvarritjen e hetimeve. Me të njëjtat pretendime si në Komision, subjekti parashtroi se lidhja e veprës penale me një emër personi, mund të dalë vetëm me kryerjen e hetimeve dhe

---

*fshatin Bishqem Kodër/Komuna Pajovë Peqin [vendime të Këshillit të Komunës, procesverbale për përcaktimin e çmimit, dokumente tekniko-ligjorë etj.]; (ii) Prefekturën Elbasan për dërgim informacioni si kërkuar nga Këshilli Qarkut Elbasan; (iii) Komunën Pajovë/Peqin për dërgim të kopjes së vendimit të Këshillit të Komunës Peqin, procesverbaleve për çmimin e tokës, për shpronësimin e pronarëve nga ndërtimi i aksit rrugor Rrogozhinë-Elbasan, fshatit Bishqem.*

<sup>29</sup> Konfirmuar me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 15.12.2023, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

të dhënave të mbledhura, prej të cilave do të rezultojë një lidhje mes veprës penale që procedohet dhe përgjegjësisë së prezumuar të një personi të caktuar. Sipas saj, në kuptim të parashikimeve të nenit 323 të K. Pr. Penale, për sa kjo çështje nuk i atribuohet një personi të caktuar, nuk llogariten afate procedurale, si dhe nuk merret vendim për zgjatjen e afatit hetimor. Referuar akteve, nuk ka pasur zvarritje hetimesh, menjëherë pas regjistrimit të procedimit penal është hartuar plani për kryerjen e veprimeve hetimore, është administruar dokumentacioni i nevojshëm nga zyra noteriale, ZVRPP etj., janë marrë deklaratime nga personat që kanë dijeni për faktin, duke i njohur me aktet përkatëse. Vendimi për pushimin e çështjes nr. {\*\*\*}, të vitit 2013, është kontrolluar nga Drejtuesi i Prokurorisë, autoritet që, sipas ligjit procedural të kohës, kishte të drejtë të kontrollonte bazueshmërinë në ligj e prova të vendimmarrjes, si dhe shfuqizimin e vendimeve të prokurorit, si dhe ndaj këtij vendimi nuk është bërë ankim në gjykatë.

**21.2.** Nga aktet në dosjen gjyqësore, në raport me pretendimet e subjektit dhe ligjin e zbatueshëm, trupi gjykues konstaton dhe vlerëson si vijon.

**21.2.1.** Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, në datën 10.10.2013, mbi bazën e kallëzimit të shtetasës S. H., ka regjistruar procedimin penal nr. {\*\*\*}, për veprën penale “Mashtrim”, parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal. Kallëzuesja ka pretenduar se banon në një banesë 70 m,<sup>2</sup> në qytetin e Librazhdit, sipas saj blerë me një deklaratë noteriale nga bashkëshorti i saj, prej shtetasit I. Gj. dhe, se së fundmi, ka marrë vesh se prona nuk ka qenë në pronësi të këtij shtetasi, por për të ka shfaqur pretendime pronësie shtetasi E. B. Po në datën 10.10.2013, subjekti ka nxjerrë urdhër “Për kryerjen e veprimeve hetimore”, duke përcaktuar 9 të tilla, si edhe *për mbajtjen e kontakteve të vijueshme me prokurorin e çështjes lidhur me ecurinë e hetimeve, dhe kryerjen e tyre nga OPGj-ja brenda datës 10.12.2013.* Nga aktet në fashikullin e këtij procedimi penal, konstatohet se, përpos adresimit të kërkesave për administrim dokumentacioni dhe përgjigjeve përkatëse, rezulton se, në datën 22.01.2014, subjekti ka nxjerrë urdhra për shoqërimin e detyrueshëm të dy shtetasve të përmendur në kallëzim, cilët nuk ishin paraqitur me thirrjen e bërë prej prokurorisë. Po në datën 22.01.2014, me shkresë të Drejtuesit të Prokurorisë, urdhrat e sipërcituar i janë përcjellë Komisarariatit të Policisë. Ky i fundit, me shkresën e datës 27.01.2013, ka kthyer përgjigje se shtetasit e kërkuar nuk janë gjetur, duke bashkëlidhur edhe raportet përkatëse të mbajtura prej strukturave të angazhuara.

**21.3.** Sa më sipër, trupi gjykues, përveç se konstaton mungesën e evidentimit të problematikave lidhur me rastin nga Komisioni, çmon se në vetvete periudha kohore prej 4 muajsh do të ishte e justifikueshme dhe e pranueshme, për kryerjen e çdo hetimi penal, për më tepër në rrethanat e dokumentuara të pamundësisë të pyetjes së shtetasve të cituar në kallëzim, pavarësisht përpjekjeve të organeve përkatëse. Për pasojë, trupi gjykues e gjen të padrejtë konstatimin e Komisionit për zvarritje të hetimeve në këtë rast, dhe pretendimet e subjektit, të drejta.

**22.** Lidhur me ankesën nr. {\*\*\*}, të vitit 2018, të shtetasës N. D.<sup>30</sup>, administruar në arkivin e Prokurorisë së Përgjithshme, e cila ka pretenduar nisje të procedimit penal për veprat penale

---

<sup>30</sup> Referuar akteve të administruara që i përkasin procedimit penal nr. {\*\*\*}, viti 2016, si dhe vendimeve gjyqësore respektive që kanë shqyrtuar vendimin e pushimit të këtij procedimi penal, identiteti i shtetasës pasqyrohet N. D. Në këtë vendim, përpos rasteve kur citohen pjesë prej akteve të subjektit apo prej vendimeve gjyqësore, identiteti

“Korrupsioni i zyrtarëve publikë dhe magjistratë”, si dhe “Mashttrim”, ndaj shtetasve A. D. dhe të tjerë<sup>31</sup>, bazuar në dokumentacionin e depozituar në raportin profesional të subjektit, Komisioni ka konstatuar se pretendimet e kësaj shtetase, lindur dhe banuese në Itali, janë ngritur mbi moszgjidhjen e një çështjeje pronësore, për të cilat prej saj janë bërë një sërë ankesash dhe kallëzimesh për subjekte të rivlerësimit, përfshirë edhe subjektin Pranvera Stafa, duke theksuar për këtë të fundit se nuk ka hetuar realisht asnjë prej fakteve të parashtruara në kallëzim, duke dëmtuar në këtë mënyrë të gjithë trashëgimtarët V. Komisioni, pasi ka analizuar faktet konkrete të kësaj çështjeje në raport me pretendimet e subjektit, ka çmuar se subjekti i rivlerësimit: (i) nuk ka ndërmarrë logjikisht hetimin, duke mos kryer një hetim të plotë e të thelluar për të siguruar prova konkrete, të cilat do të mund të konfirmonin dyshimin (e ngritur në kallëzim) apo ta rrëzonin atë, por duke bërë qartësi mbi dinamikën e ngjarjeve - çka ka munguar pasi gjithë vlerësimi i subjektit është kanalizuar në rrafshin civil, duke pasjellë pasoja konkrete në ecurinë e procedimit në fjalë; (ii) nuk ka kryer analizë gjithëpërfshirëse dhe në harmoni me faktet dhe nevojat hetimore të materialeve ekzistuese në dosje për të zbardhur të vërtetën, në këtë mënyrë, duke shfaqur mangësi domethënëse në drejtim të përmbushjes së kriterit ligjor sipas pikës 2, të nenit 73, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ku parashikohet: *“Aspekti i njohurive ligjore vlerësohet duke u bazuar në aftësinë e prokurorit për të hetuar dhe për të marrë urdhra dhe vendime, duke u bazuar në tregues të tillë si aftësia e përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht hetimin, sipas kërkesave ligjore për të mbledhur provat e kërkuara me ligj, për të interpretuar ligjin dhe për të analizuar jurisprudencën”*.

22.1. Subjekti i rivlerësimit pretendon se, referuar akteve të procedimit penal nr. {\*\*\*}, viti 2016, si dhe përmbajtjes së vendimit të marrë prej saj, është evidente që ka pasur aftësi të prokurorit për të hetuar, për të marrë vendim, janë mbledhur provat e nevojshme për zgjidhjen ligjore të çështjes, ka pasur logjikë në kryerjen e veprimeve hetimore, si dhe në zgjidhjen ligjore të çështjes, dhe se vendimmarrja është e pacenuar. Konkluzioni i Komisionit që vendimmarrja e Gjykatës së Apelit nuk e ka zgjidhur çështjen në themel, është jo i drejtë, pasi nëse do të ishte e padrejtë zgjidhja ligjore e bërë nga Prokuroria, do të kishte lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë. Arsyeimi i Komisionit del jashtë kompetencave të dhëna nga ligji dhe nuk janë vlerësuar shpjegimet e saj, që prej shumë vitesh, shtetasja N. D. bën padi, dhe *aktet e pretenduara janë kontrolluar nga shumë gjykata*, ku ajo është bërë pjesë e proceseve gjyqësore, dhe nga asnjë gjykatë nuk është vlerësuar se ka falsitet dokumentesh, pikërisht për faktin që bëhej kallëzim penal. Gjithashtu, subjekti parashtron se ka sqaruar në kuadër të barrës së provës:

(i) N. D. ka bërë kallëzim penal për veprat penale të mashtimit dhe falsifikimit të dokumenteve, me pretendimin se një person i pajisur me prokurë prej tyre, pasi ata i kishin shfuqizuar prokurën, u ka shitur pronat. Prokuroria Elbasan ka regjistruar procedimin penal nr. {\*\*\*/2016, ku në përfundim të hetimeve është vendosur pushimi i çështjes, pasi ka rezultuar

---

*i kësaj shtetase do të referohet: “N. D.”, për koherencë me vendimin e Komisionit, si dhe për faktin se ky identitet referohet edhe prej subjektit në ankim.*

<sup>31</sup> Prokuroria e Përgjithshme, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 20.04.2018, i ka kthyer përgjigje ankueses, duke i bërë me dije se ankesa i është përcjellë për kompetencë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Krimeve të Rënda, sot SPAK. Nga informacioni i dërguar nga SPAK, me shkresën nr. {\*\*\*}, plus një CD, datë 28.12.2023, nuk konfirmohet administrim apo trajtim i kësaj ankese.

se jemi para një marrëdhënie juridiko-civile. Ndaj këtij vendimi është ushtruar ankim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan, e cila ka prishur vendimin e pushimit dhe ka urdhëruar vazhdimin e hetimeve, duke urdhëruar kryerjen e disa veprimeve hetimore, që lidhen me pasojat juridike-civile dhe jo faktin penal. Gjykata e Apelit, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 19.12.2018, ka prishur vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe ka vlerësuar të bazuar në prova e në ligj vendimin e prokurorisë për pushimin e çështjes.

(ii) Hetimi i prokurorisë ka qenë i plotë, ndër të tjera, ka kërkuar informacion në gjykatë, e cila ka informuar se kallëzuesja dhe personi i kallëzuar ishin pjesë e proceseve gjyqësore, ku objekt kërkimi ishte pikërisht vlefshmëria e akteve të realizuara në bazë të prokurës së lëshuar nga kallëzuesja, por që më pas ishte shfuqizuar. Nga procesi gjyqësor nuk ka rezultuar asnjë pretendim për falsifikim prokure, për vlefshmërinë në aspektin civil të akteve të dala në bazë të prokurës së lëshuar nga kallëzuesja, kompetente është gjykata, pasi nuk kemi të bëjmë me konsumim të elementeve të ndonjë vepre penale, por me pretendime për shtrirjen e efekteve të prokurës në kohë.

(iii) Në të kundërt nga sa pretendon ankuesja, se prej prokurores nuk është hetuar realisht për faktet e pretenduara prej saj, fakti i kallëzuar është hetuar në mënyrë shteruese, por në përfundim ka rezultuar se fakti nuk përbën vepër penale, por marrëdhënie juridiko-civile. Hetimi i plotë është konfirmuar edhe nga Gjykata e Apelit, që ka vlerësuar të bazuar në prova dhe në ligj vendimin e prokurorisë.

(iv) Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan ka urdhëruar kryerjen edhe të disa veprimeve hetimore shtesë, që çonin tek evidentimi i problemeve civile dhe që nuk i shërbenin faktit penal, të cilat dukshëm nuk do të sillnin asnjë të dhënë të re, duke mos ndryshuar thelbin e vendimmarrjes, që jemi përpara një marrëdhënie juridiko-civile dhe jo një vepre penale. Për këtë shkak është bërë ankim dhe Gjykata e Apelit e ka gjetur të drejtë ankimin e prokurorit. Aktualisht, kjo çështje është pushuar, ku vendimi i pushimit të procedimit penal është miratuar me vendim të Gjykatës së Apelit Durrës.

**22.2.** Nga aktet në dosjen gjyqësore, në raport me pretendimet e subjektit dhe ligjin e zbatueshëm, trupi gjykues konstaton dhe vlerëson si vijon.

**22.2.1.** Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, më datë 29.06.2016, mbi bazën e kallëzimit të shtetasës N. D., ka regjistruar procedimin penal nr. {\*\*\*}, për veprën penale “Mashtrimi” dhe “Falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga neni 143 dhe neni 186 K. Penal.<sup>32</sup> Në datën 22.06.2017, subjekti ka marrë vendim “Për pushimin e çështjes”, ku ndër të

---

<sup>32</sup> Në kallëzimin dhe deklarinimin e saj (procesverbali mbajtur nga OPGJ-ja, dt. 10.06.2016), kallëzuesja sqaron se është trashëgimtare ligjore e Sh. dhe S. V., ish-pronarë të disa pronave në qytetin Elbasan dhe në qytete të tjera të vendit. Duke qenë se nuk e njeh gjuhën shqipe dhe duke qenë larg (ajo, motrat dhe vëllai i saj), me prokurën e përgjithshme nr. {\*\*\*} rep., {\*\*\*} kol., datë 26.11.2008, kanë autorizuar shtetasin A. D. që të merrej me të gjithë procesin e njohjes dhe kthimit të pronave të të sipërcituarve, i kanë dhënë të drejtën që të administrojë pronat e kthyera, të merrej edhe me shitjen dhe dhurimin e tyre, nëse do të ishte e nevojshme. Deri në mars 2010 i kanë kërkuar të dhëna të hollësishme të autorizuarit prej tyre, lidhur me procedurat e ndjekura, por nuk kanë pasur komunikim me të. Duke dyshuar se i autorizuari po kryente veprime në dëm të saj, nëpërmjet prokurës së dhënë, më dt. 24.03.2010, ka revokuar prokurën e përfaqësimit tek i njëjti noter dhe ka vendosur si përfaqësuese të saj shtetasen E. T. Revokimin e prokurës ka kërkuar (ta njoftojë) në rrugë telefonike, nga data 24.03.2010, por telefoni ka qenë i mbyllur dhe është detyruar të njoftojë në datën 13.04.2010, nëpërmjet adresës së saj të email-

tjera pasqyrohet: (i) se i është kërkuar informacion Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, e cila me shkresën nr. {\*\*\*}, datë 25.10.2016, vë në dijeni se pranë kësaj gjykate është depozituar padia me palë ndërgjygjëse, paditëse znj. D., i paditur A. D. etj., me objekt pavlefshmëri absolute e kontratës së shkëmbimit etj. (bashkëngjitur kopje të kërkesëpadisë); (ii) nga notere M. Sh., me shkresën e datës 18.10.2016, janë vënë në dispozicion praktikat e veprimeve noteriale të bëra pranë kësaj zyre noterie; (iii) si persona që tregojnë rrethana hetimi janë pyetur disa shtetas, ndër ta edhe A. D. (i kallëzuar), i cili, ndër të tjera, ka deklaruar se nuk e ka parë/lexuar më parë *email*-in e datës 13.04.2010, depozituar prej kallëzueses, për njoftimin e revokimit të prokurës, dhe ka dorëzuar të printuar nga adresa e tij komunikimin që ka pasur me kallëzuesen, nga data 16.03.2010 – 26.04.2010, si dhe ka sqaruar veprimet e shitjes së pronave. Subjekti, pas analizimit të rrethanave të dala nga hetimi, konkludon se: *Revokimi i prokurës nr. {\*\*\*}, dt. 26.11.2008, me anë të prokurës nr. rep. {\*\*\*}, dt.24.03.2010, të bërë nga N. D., nuk vërtetohet t'i jetë njoftuar në mënyrën dhe rrugën e duhur shtetasit A. D., përpara kohës së lidhjes së kontratave të bëra nga ky shtetas me persona të tretë. Pavarësisht sa ka rezultuar, edhe në rastin e vërtetimit të faktit se i kallëzuar A. D. ka vepruar duke bërë ato veprime noteriale të kontestuara nga kallëzuesja pas revokimit të prokurës së vitit 2008, nga ana e saj, nuk rezulton të ndodhemi para elementeve të veprës penale të “Mashtimit”, parashikuar nga neni 143 i K. Penal apo “Falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186 i K. Penal. Në rastin konkret, nëse shtetasi A. D. ka vepruar në këto rrethana, pra pas revokimit të prokurës së mëparshme, jemi përpara faktit të përfaqësimit pa tagre, siç parashikohet në nenin 78 të K. Civil. Mosmarrëveshjet mes palëve gjejnë zgjidhje në rrugë gjyqësore, duke iu drejtuar gjykatës kompetente për shqyrtimin e konfliktit civil. Vetë kallëzuesja i ka paraprirë kallëzimit të saj të bërë përpara organit të prokurorisë, duke paraqitur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan një kërkesëpadi me objekt pavlefshmëri të veprimeve kontratë shitje pasurish dhe kontratës së shkëmbimit. Nga studimi i kësaj kërkesëpadie dhe nga objekti i saj rezulton se kjo padi, përveç të tjerash, është e njëjtë me pretendimet që paditësja/kallëzuesja N. D. ka paraqitur në kallëzimin e bërë disa muaj pas fillimit të gjykimit sa më lart [...] problematika që ata mund të kenë lidhur me ndarjen e pjesëve takuese në të ardhura të shitjeve të pronave nga shtetasi A. D. janë marrëdhënie juridike civile, të cilat duhet të gjejnë dhe gjejnë zgjidhje me kërkesëpadi civile në gjykatën kompetente ... [...].*

**22.2.2.** Ndaj vendimit të sipërcituar të prokurores/subjektit, nga kallëzuesja është ushtruar ankim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan, e cila, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 27.08.2018, ka vendosur pranimin e ankimit, prishjen e vendimit të pushimit të procedimit penal nr. {\*\*\*}

---

*it: {\*\*\*}, në adresën e shtetasit A. D.: {\*\*\*}, ku ata kanë komunikuar vazhdimisht. Me marrjen dijeni të këtij njoftimi, shtetasi A. D. ka filluar të shesë të gjitha pronat e kthyera dhe të regjistruara në emër të trashëgimtarëve të Sh. V., në Elbasan, Vlorë dhe Tiranë. Në dijeninë e saj, kontratat e shitjes së pronave mbajnë datat 13.04.2010 dhe 14.04.2010, dyshon se çmimet në kontratat e shitjes janë fiktive, nuk janë paguar, pasi sipas saj nuk ka asnjë transaksion bankar, shumat janë të mëdha, në total në rreth 3-4 milionë euro, duke mos qenë vlera reale e çmimit të tregut. Kallëzuesja deklaroi se nga shtetasi A. D. dhe nga blerësit e tjerë nuk ka marrë asnjëherë asnjë lekë nga shitjet e pronave, edhe nga ato të vitit 2009, pa u revokuar prokura (sipas saj, me kontrata që rezultojnë të jenë fiktive, përforcuar me faktin se pronat janë riblerë nga shtetasi A. D.), pasi në rast të kundërt do ishte pasqyruar edhe në të ardhurat e saj shtetin italian. Kallëzuesja, bashkë me kallëzimin, ka paraqitur prokurën nr. rep. {\*\*\*}, disa kontrata shitje e shkëmbimi pronash, me palë A. D., përfaqësues, si dhe printim të email-it datë 07.05.2015. Gjithashtu, kallëzuesja ka deklaruar se kanë hapur një proces pranë Gjykatës Elbasan, për konstatimin e pavlefshmërisë së këtyre kontratave dhe rikthimin e pronave të saj, që është duke u gjykuar, dhe se rreth viteve 2010 ose 2011 kanë bërë kallëzim në Prokurorinë e Vlorës, po nuk di çfarë është bërë me të.*

të vitit 2016, dhe ka urdhëruar Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Elbasan të vijojë hetimet për këtë procedim. Në përmbajtje të këtij vendimi, ndër të tjera, pasqyrohet: “...gjykata çmon se nga marrëdhëniet përfaqësues - i përfaqësuar, të lindura në bazë të një prokure përfaqësimi, mund të kryhet vepra penale e mashtrimit... falsifikimi i dokumenteve, nga ana objektive mund të kryhet në dy mënyra, ose duke ndryshuar të dhënat e një dokumenti, nëpërmjet ndërhyrjes fizike në të, ose duke hartuar një dokument me të dhëna të rreme. Në gjykim, nga ankuesja u paraqit vendimi nr. {\*\*\*}, datë 10.01.2018, i Gjykatës së Krimeve të Rënda, për sekuestrim të një numri të konsiderueshëm pasurish të paluajtshme... nga vendimi rezulton se, në datën 22.06.2016, në Prokurorinë e Krimeve të Rënda, ka bërë kallëzim penal N. D. ... kjo prokurori ka regjistruar procedimin penal nr. {\*\*\*}, për veprat penale të mashtrimit, kryer nga grup i strukturuar kriminal... mbi kërkesën e prokurorit, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 10.01.2018, nga Gjykata e Krimeve të Rënda janë vënë në sekuestro një numër i konsiderueshëm pasurish të paluajtshme, të ndodhura në Elbasan, Vlorë e Tiranë, përfshirë dhe një pjesë të pasurive të cituara më sipër... gjykata çmon të gabuar konkluzionin e prokurorit, se në veprimet e të kallëzuarit nuk ka elemente të veprës penale të mashtrimit dhe falsifikimit të dokumenteve. Ky konkluzion është sa rezultat i një hetimi jo të plotë e të gjithanshëm, aq dhe i vlerësimit të gabuar të provave të administruara në hetimin paraprak deri në këtë fazë të procedimit... Kallëzimi i kallëzueses nuk është trajtuar nga prokurori në kuadrin e pretendimit të saj për kryerje veprimesh juridike fiktive me qëllim... për arsytet e mësipërme, vendimi i pushimit duhet të priset dhe të vijojnë hetimet. Por duke qenë se për të njëjtin fakt po heton edhe Prokuroria e Krimeve të Rënda, në hetimin paraprak, në bazë të neneve 83 dhe 89 të K. Pr. Penale duhet të zgjidhet mosmarrëveshja e kompetencës lëndore në këtë procedim... në rihetim të kryhen veprimet hetimore të cituara më sipër, si dhe të tjera që do të rezultojnë nga dinamika e hetimit...”

**22.2.3.** Ndaj vendimit të sipërcituar kanë bërë ankim subjekti i rivlerësimit, shtetasi A. D., si dhe shtetas të tjerë (palë në kontrata të lidhura prej shtetasit A. D.). Subjekti ka pretenduar se vendimi është i pabazuar në ligj dhe në provat e administruara gjatë gjykimit, duke parashtruar, ndër të tjera: [...] se nga hetimet nuk rezulton e provuar se shtetasi A. D. të jetë njoftuar se ka mbaruar marrëdhënia e përfaqësimit mes tij dhe kallëzueses N. D., përpara lidhjes së kontratave të mësipërme... nga kallëzuesja paraqitet një email, i nisur në datën 13.04.2010, nga adresa e kallëzueses, në adresën e email-it të të kallëzuarit, lidhur me këtë email i kallëzuari A. D. ka rezervat e veta, lidhur me kohën e çeljes së kësaj adrese email-i... [...] dhe më tej: [...] edhe në rastin e vërtetimit të faktit se i kallëzuari ka vepruar duke bërë veprimet noteriale të kontestuara nga kallëzuesja pas revokimit të prokurës së vitit 2008 nga ana e saj, nuk ndodhemi përpara elementëve të veprës penale të parashikuar nga nenet 143 dhe 186 të K. Penal, por jemi përpara faktit të përfaqësimit pa tagër, siç është përshkruar në nenin 78 të K. Civil. [...].

**22.2.4.** Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 19.12.2018, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. {\*\*\*}, datë 27.08.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, dhe rrëzimin e ankimit të shtetasës N. D. Në përmbajtje të këtij vendimi pasqyrohet se: Prokurori i Apelit nuk i është përmbajtur shkaqeve të ankimit të parashtruar nga Prokurori i Shkallës së Parë, por ka vlerësuar se vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan është i drejtë dhe duhet lënë në fuqi, pasi detyrat e lëna prej saj duhet të kryhen. Ndër të tjera, Prokurori i Apelit ka parashtruar se: “...nuk janë kryer edhe veprimet që vetë Prokurorja ka urdhëruar të kryhen nga Policia Gjyqësore, veprime të cituara hollësisht

në vendimin e Gjykatës... kryerja e veprimeve hetimore për këtë procedim penal bëhet e domosdoshme edhe për faktin se nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë është filluar procedimi penal mbi bazën e kallëzimit të shtetasës E. T. ... kallëzimi është bërë edhe për fakte që ka kallëzuar shtetasja N. D. në këtë procedim penal...”. Lidhur me këtë qëndrim, Gjykata e Apelit ka vlerësuar se shkaqet e parashtuara nga Prokurori i Apelit nuk janë ngritur në ankimin e prokurorit të çështjes, i vetmi që ka të drejtën e ankimit në bazë të nenit 408 të K. Pr. Penale, duke i çmuar si të bëra jashtë kompetencës së tij. Gjykata e Apelit në vendimin e saj, ndër të tjera, ka arsyetuar: “Gjykata e Shkallës së Parë ka vendosur të detyrojë organin e akuzës të kryejë veprime hetimore, të cilat nuk janë në kompetencë të saj. Gjykata pranon se për këtë fakt penal është duke u kryer hetim nga Prokuroria e Krimeve të Rënda dhe ia lë për detyrë Prokurorisë Elbasan të zgjidhë çështjen e kompetencës. Ky veprim është në tejkalim të kompetencave të Gjykatës... Nga fakti penal i pretenduar rezulton se kontratat e shitjes për pasurinë e paluajtshme në Elbasan, në pronësi të kallëzueses, janë kryer tek notere M. Sh., e cila e ka selinë në Tiranë... kompetente për të hetuar mashtrimin dhe falsifikimin e kontratave noteriale është Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, pasi në Tiranë është realizuar fakti i pretenduar penal...”.

**22.2.5.** Në parashtrimet për barrën e provës së kaluar me rezultatet e hetimit administrativ pas riçeljes<sup>33</sup>, lidhur me konstatimet e Komisionit pas njohjes me prapësimet dhe dokumentacionin e dërguar prej subjektit mbi rezultatet e hetimit për procedimin penal nr. 2080/2017<sup>34</sup>, ndër të tjera, subjekti ka deklaruar: “...Mbi bazën e studimit të kallëzimit penal dhe dokumentacionit që i bashkëlidhej, është hartuar plan hetimor... Gjatë kryerjes së veprimeve hetimore kanë dalë të dhëna shtesë, si dhe janë marrë prova shtesë, të cilat kanë sqaruar plotësisht faktin e kallëzuar penalisht. Administrimi i këtyre provave të reja ka bërë që të hiqej dorë nga kryerja e një pjese të veprimeve hetimore të planifikuara në urdhrin për kryerjen e veprimeve hetimore. Këto veprime hetimore të planifikuara janë vlerësuar të panevojshme për t’u kryer, pasi provohej se nuk kishim të bënim me konsumim të elementeve të ndonjë vepre penale, por ishim përpara një marrëdhënieje juridiko-civile. Konkretisht, gjatë hetimit është mësuar se mbi të njëjtin fakt ishte hetuar edhe nga Prokuroritë Vlorë dhe Tiranë... Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë ka marrë vendim për pushimin e çështjes penale nr. {\*\*\*}, të vitit 2013, ku është hetuar për të njëjtin fakt. Nga hetimi mbi faktin, Prokurorisë Elbasan i ka rezultuar se kemi të bëjmë me akte procedurale, për të cilat

<sup>33</sup> Komisioni, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 21.02.2024, ka vendosur të riçelë hetimin administrativ për shkak të “Gjetjes” së adresuar nga vëzhguesi ndërkombëtar, me nr. {\*\*\*} prot., datë 20.02.2024, lidhur me procedimin penal nr. {\*\*\*}/2017.

<sup>34</sup> Nga analizimi e akteve të depozituara nga ana e subjektit, Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës, pasi ka konstatuar se në këtë çështje duket se nuk janë kryer hetime të plota në drejtim të ekzistencës së faktit penal e konkretisht:

- Duket se nuk është verifikuar mbi vërtetësinë e korrespondencës me postë elektronike të shtetasit A. D. dhe kallëzueses përmes këqyrjes së email-eve dhe kryerjes së ekspertizës së teknologjisë së informacionit.
- Duket se nuk është hetuar lidhur me faktin e njoftimit të revokimit të prokurës të pretenduar nga shtetasi A. D. se ai nuk ishte njohur në kohë më këtë revokim.
- Duket që nuk janë pyetur persona që mund të tregonin rrethana të hetimit.
- Duket se nuk është hetuar lidhur për pretendimet e kallëzueses për kryerjen e veprimeve juridike fiktive me qëllim përfitimin e drejtave pasurore, përfshirë këtu përfitimin e ndonjë të ardhure në favor të kallëzueses e familjes V., nga shitja e pasurive apo hetime në sistemin bankar.
- Duket se nuk është administruar kontrata e shitjes e lidhur midis shtetasve A. D. e O. L., veprim ky i pasqyruar në urdhrin e kryerjes së veprimeve hetimore.

pretendohet se janë kryer nga përfaqësuesi i kallëzuesit jashtë tagrave të dhëna apo pa e pasur tagrin, për shkak të revokimit të prokurës. Personi i kallëzuar penalisht ishte fakt i dukshëm, që ishte pajisur me prokurë nga kallëzuesja, por që pretendohet se më vonë kjo prokurë ishte revokuar. Përdorimi i një prokure të revokuar në hartimin e dokumenteve noteriale, si dhe pretendimet e palëve në lidhje me përdorimin e këtyre akteve provonin se kishim të bënim me mosmarrëveshje të natyrës civile dhe nuk rezultonte të kishim të bënim me konsumim të elementeve të figurës së veprës penale “Mashttrim” apo “Falsifikimi i dokumenteve”, konkluzion ky plotësisht në përputhje me përfundimin në të cilin kishte arritur edhe Prokuroria e Rrethit Vlorë. Duke qenë se deklaratimet e personave të pyetur dhe dokumentacioni i administruar ishin të plota për zgjidhjen e drejtë të çështjes, është hequr dorë nga pyetja e personave dhe marrja e dokumentacionit të planifikuar në urdhrin për kryerjen e veprimeve hetimore, pasi kryerja e këtyre veprimeve hetimore ishte qartësisht e panevojshme. Është bërë verifikimi i korrespondencës me postë elektronike të shtetases N. D. me shtetasin A. D. Ata kanë pasur komunikim në datat 16.03.2010, 14.04.2010, 15.04.2010 dhe 25.04.2010. Nga përkthimi i përmbajtjes së këtyre email-eve rezulton se bëhet fjalë për revokim të një prokure të bërë nga M. L., e datës 15.03.2010. Lidhur me këto email-e, i kallëzuari A. D. ka deklaruar se nuk i ka parë dhe nuk i ka lexuar asnjëherë më parë. Këto prova janë vlerësuar në harmoni me provat e tjera për zgjidhjen përfundimtare të çështjes. ...Nga hetimi ka rezultuar se në Gjykatën e Shkallës së Parë kishte të regjistruar një padi civile, ku në përmbajtje parashtroheshin të njëjtat rrethana mbi faktin si në kallëzimin penal. Konkretisht, në Gjykatën e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan kishte një kërkesëpadi me objekt pavlefshmëri të veprimeve kontratë shitje pasurish dhe kontratës së shkëmbimit... Sa është konstatuar nga Komisioni si gjetje dhe kalim barrë prove, përshkruhet edhe në përmbajtje të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan. ...Prokuroria ka ankimuar vendimin me arsyetimin se hetimet kanë qenë të plota... detyrat e lëna nga Gjykata ...ishin detyra hetimore që i shërbenin vetëm zgjidhjes civile të mosmarrëveshjes, ku në fakt një zgjidhje e tillë i takonte hetimit gjyqësor... Gjykata e Apelit Durrës, ndër të tjera, ka vlerësuar dhe arsyetuar se vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan është marrë në zbatim të gabuar të ligjit... kontrolli gjyqësor është i kufizuar në të drejtën për të kërkuar hetime të mëtejshme. Gjykata e Shkallës së Parë ka detyruar organin e akuzës të kryejë veprime hetimore, të cilat nuk janë në kompetencë të saj... Kjo Gjykatë ka vlerësuar ashtu si edhe Prokuroria që nuk ka pasur nevojë për kryerje veprimesh hetimore shtesë për zgjidhjen përfundimtare të çështjes penale... ”.

**22.3.** Sa më sipër, trupi gjykues, së pari, gjen të drejtë vlerësimin e Komisionit se: Gjykata e Apelit nuk ka zhvilluar gjykim në themel të çështjes, sa i përket vlerësimit të veprimtarisë hetimore të subjektit, dhe për rrjedhojë, vlerëson të pabazuar pretendimin e subjektit se ky konkluzion është jo i drejtë e se: Gjykata e Apelit ka vlerësuar të bazuar në prova e në ligj vendimin e Prokurorisë për pushimin e çështjes. Së dyti, sikundër Komisioni, trupi gjykues konstaton mungesë të një veprimtarie të plotë hetimore lidhur me faktin e kallëzuar, e që i përket si kohës së marrjes dijeni nga shtetasi A.D., për revokimin e prokurës prej kallëzueses, ashtu edhe fiktivitetit të veprimeve juridike të shitjes së pasurive prej tij, përfitimin e shumave monetare nga shitjet, në funksion të zbulimit të ekzistencës apo jo të elementeve të veprave penale të kallëzuara. Konkretisht, prej subjektit rezulton se nuk janë kryer hetime: (i) për të verifikuar momentin e marrjes dijeni për revokimin e prokurës nga i kallëzuari D., (ii) për verifikimin e deklaratimeve të dhëna nga shtetasja E. T., në procedimin penal të regjistruar në

Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, në vitin 2014; (ii) për të hetuar rreth qëllimit të kryerjes brenda një harku kohor të shkurtër, prej 8 ditësh, nga dita e revokimit të prokurës, prej shtetasit A.D., të një sërë transaksionesh, që lidheshin me një numër të madh pronash të trashëgimtareve, dhe shitjes së tyre tek i njëjti person, në këmbim të vlerave të larta monetare; (iii) rreth pretendimit të kallëzueses se ajo nuk ka përfituar asnjë shumë të ardhurash prej këtyre shitjeve; (iv) rreth të dhënave që kanë rezultuar prej një regjistrimi të fshehtë të kryer prej trashëgimtarëve të pronave, sipas të cilave, i kallëzuari ka pohuar se veprimet në kontratat e shitblerjeve të pasurive janë fiktive; (v) rreth mënyrës së përfitimit të shumave nga kontratat e shitjes, të cilat, ndonëse në vlera të larta, nuk ka qartësi nëse janë paguar *cash* apo me bankë; (vi) nuk është administruar kontrata e lidhur midis shtetasve A.D. e O. L., ndonëse një veprim i caktuar në urdhrin për kryerjen e veprimeve hetimore, e cila do të kishte qartësuar disa nga pretendimet e paraqitura në kallëzimin penal, pavarësisht rezultatit përfundimtar.

22.4. Pavarësisht këtyre mangësive të konstatuara në drejtim të veprimtarisë hetimore të kryer prej subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues konstatoi se çështja, në morinë e problematikave të saj, paraqitej komplekse, me ndërthurje të elementeve civile të mosmarrëveshjeve, por që nuk përjashtonin edhe mundësinë e ekzistencës së elementeve penale, të cilat mund të identifikoheshin vetëm pas një hetimi të plotë të fakteve objekt kallëzimi. Në këtë kuadër, duket e vështirë për trupin gjykues të identifikojë qartazi mangësitë profesionale që lidhen me hetimin e rastit, për sa kohë ato duket se ndërthuren edhe me vlerësimin që ka bërë subjekti/magjistrati për natyrën e konfliktit dhe përcaktimin e veprimtarisë hetimore në varësi të saj. Trupi gjykues vlerësoi se marrja e një qëndrimi kategorik për mangësitë e sipërcituara, të cilat duket se ekzistojnë *a prima facie*, do të duhej të bëhej pas një analizë të plotë e të thelluar të të gjitha rrethanave të çështjes, përshi veprimtarinë hetimore të kryer nga zyra të tjera prokurorie, të cilat kishin trajtuar të njëjtat fakte të kallëzuara penalisht nga e njëjta shtetase. Ky proces dikton një vlerësim të pashmangshëm mbi korrektësinë dhe themelin e çështjes, proces i cili është i paaplikueshëm në kuadër të kontrollit me natyrë disiplinore të magjistratëve, në kuptim të nenit 73, pika 4 e ligjit nr. 96/2016<sup>35</sup>, duke qenë se mbetet tagër i kontrollit gjyqësor brenda kuadrit të procedimit konkret.

22.5. Në përfundim, trupi gjykues çmon se vlerësimi i subjektit, i kanalizuar në rrafshin civil, duket se tregon për vlerësim sipërfaqësor të rastit, i cili duket se përfaqëson, përveç konfliktit të natyrës civile edhe elemente, të cilat do të duhej të hetoheshin në drejtim të përgjegjësisë penale të personave të kallëzuar. Pavarësisht këtij konstatimi, trupi gjykues, në përcaktimin e peshës ndikuese në vlerësimin e çështjes, lidhur me sa më sipër, pati në konsideratë edhe një sërë rrethanash, që lidhen me kompleksitetin e çështjes dhe ndërthurjen e elementeve civile me ato penale në konfliktin mes palëve, përfshirjen në hetime lidhur me faktet e pretenduara si penale, edhe të prokurorive të tjera, si edhe qëndrimin e Gjykatës së Apelit Durrës, që përcakton se kompetencat e subjektit të rivlerësimit në hetimin e plotë të rastit ishin të kufizuara për shkak të mungesës së kompetencës.

23. Lidhur me denoncimin e shtetasit H. S.,<sup>36</sup> i cili ankohet se subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer hetim të plotë për kallëzimin e paraqitur prej tij, për veprën penale të falsifikimit dhe

---

<sup>35</sup> Vlerësuesi çmon aftësitë profesionale të prokurorit pa gjykuar mbi korrektësinë dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e prokurorit që vlerësohet.

<sup>36</sup> Denoncimet me nr. {\*\*\*} prot., datë 13.08.2021, nr. {\*\*\*}, datë 12.08.2021.

përdorimit të dokumentit të falsifikuar dhe, si pasojë, ka vendosur për mosfillimin e procedimit penal të materialit kallëzues nr. {\*\*\*} regj., datë 29.04.2015, Komisioni ka konkluduar se: *Subjekti i rivlerësimit ka treguar mangësi profesionale në trajtimin e kësaj çështje, në kuadër të aspektit të njohurive ligjore, të arsytimit ligjor dhe cilësisë së analizës dhe argumentimit logjik të prokurorit dhe moskryerjes së të gjitha veprimeve hetimore të nevojshme sipas parashikimeve të nenit 73, pikat 2 dhe 3 të ligjit nr. 96/2016, dhe për pasojë, kjo çmuarje duhet të merret në konsideratë në vlerësimin tërësor të çështjes së subjektit të rivlerësimit, sipas nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.* Për të arritur në konkluzionin e mësipërm, Komisioni është bazuar në përfundimet e paraqitura në mënyrë të përmbledhur si vijon:

(i) Vendimi i mosfillimit është marrë jashtë afatit 15-ditor, të përcaktuar nga neni 291 i K. Pr. Penale.

(ii) Subjekti nuk ka hetuar në mënyrë të plotë dhe gjithëpërfshirëse për të konkluduar mbi vërtetësinë e faktit, se mbi bazën e cilit veprimi juridik u lëshua nga ish-punonjësi i ZVRPP-së Elbasan, dokumenti “Vërtetim hipotekor”, datë 21.08.2000, i cili përmbante të dhëna për regjistrin hipotekor nr. {\*\*\*}, ku figuronte e regjistruar në pronësi të shtetasit P., prona truall me sip. 405 m<sup>2</sup>, në kushtet që origjina fillestare e pasurisë së tij rezultonte nga dokumenti “Akt Pjesëtimi”, ku përcaktohej se ai zotëronte 324 m<sup>2</sup> truall në përdorim.

(iii) Nuk ka hetuar lidhur me dyshimin e dokumentit të falsifikuar dhe përdorimin e tij në procesin gjyqësor të vitit 2004.

(iv) Nuk ka hetuar lidhur me shkaqet që çuan ZVRPP-në të bëjë fshirjen në vitet 2009 dhe 2010, nga regjistri hipotekor të dokumentit “Vërtetim hipotekor”, datë 21.08.2000, dhe kalimin në gjendjen e mëparshme.

(v) Nuk ka hetuar në drejtim të dokumentit të pretenduar të falsifikuar, paraqitur nga shtetasi P., në ALUIZNI-n Elbasan, ku konstatohet se ky shtetas ka deklaruar<sup>37</sup> se ka truall në pronësi, ndërkohë që të drejtën e pronësisë e ka fituar vetëm në datën 06.03.2015, me vendimin e AKKP-së. Në këtë rast, subjekti ka pasur të dhënë e dalë nga dokumenti *Relacion i regjistruarit*, datë 22.05.2015, ku pasqyrohet fakti se: “...kjo pasuri figuron e regjistruar në kartelën e pasurisë nr. {\*\*\*}, fq. {\*\*\*}, me sipërfaqe të përgjithshme 405 m<sup>2</sup> dhe nr. pasurie {\*\*\*}, me pronar shtetasin H. P., e në seksionin e kartelës së kësaj pasurie ka shënimin e çregjistrimit të kësaj pasurie e anulimit të këtij regjistrimi, për faktin se origjina e saj është truall në përdorim dhe nga ana e zyrës është bërë regjistrimi i saj në pronësi”.

(vi) Arsytimi i subjektit në vendimin e mosfillimit për këtë material hetimor, i fokusuar te marrëdhënia juridiko-civile dhe instituti i parashkrimit për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, duket se cenon cilësinë e analizës dhe argumentimit logjik të prokurorit në raport me faktin penal të kallëzuar, që konsistonte në përdorimin nga shtetasit e kallëzuar të dokumentit të falsifikuar në proceset gjyqësore nga viti 2004 e në vijim. Në ndryshim nga fokusi i subjektit në hetimin e kësaj çështjeje, rrethanat e konstatuara tregojnë se, nëse do të ishte konkluduar shkencërisht për falsitetin e dokumentit dhe kohën e përdorimit të tij, atëherë do të ishte i ndryshëm edhe vlerësimi i institutit të parashkrimit për këtë veprë penale.

---

<sup>37</sup> Në dokumentin “Formular i deklarimit për përfshirje në procedurat e legalizimit të ndërtimit pa leje/dhe ose shtesës së ndërtimit me leje, datë 22.01.2015”.

(vii) Vetëm përmes hetimit, për përdorimin e dokumentit të pretenduar të falsifikuar, do të zbardheshin rrethanat e faktit penal të kallëzuar, në kuptim të nenit 186/1 të Kodit Penal në formën e përdorimit, ku më së paku në këtë çështje duhej se provohej përdorimi i aktit, por njëkohësisht, po përmes hetimit, duhej të vërtetohej se akti i përdorur përmbante ose jo të dhëna të rreme, në mënyrë që të evidentohej edhe qëllimi i fitimit apo çdo lloj interesi tjetër personal nga përdorimi i këtij dokumentacioni të falsifikuar, ose në të kundërt të konstatohej mungesa e veprave apo e përgjegjësisë penale (por, pasi të ishin administruar e analizuar dokumentet përkatëse dhe të ishin kryer hetime të plota e gjithëpërfshirëse, të cilat kanë munguar).

23.1. Subjekti i rivlerësimit pretendon se konstatimet e Komisionit, të evidentuara si problematika, referuar akteve në dosje, nuk qëndrojnë. Sipas subjektit: (i) Nga ana e saj janë kryer të gjitha verifikimet e mundshme dhe të duhura hetimore, nuk ka vend për të kryer ndonjë veprim tjetër hetimor, vendimmarrja është kontrolluar nga Prokurori i Përgjithshëm, autoriteti epror që kishte të drejtën e shfuqizimit të vendimeve të padrejta, sipas ligjit të kohës, ndaj vendimit nuk është ushtruar ankim, fakt që indirekt provon se vendimmarrja ka qenë e bazuar në ligj e prova, dhe se është bindur edhe personi që ka pretenduar të drejtën. (ii) Komisioni, me arsyetimin e tij, duke vlerësuar se cila do të ishte zgjidhja ligjore e çështjes penale, ka marrë rolin e prokurorit të çështjes, por edhe të prokurorit më të lartë. Subjekti, në vijim, parashton shpjegimet e dhëna për barrën e provës, në mënyrë të përmbledhur, si vijon:

(i) Çështja nuk ka qenë në hetim, por në proces verifikimi. Nuk është kaluar afati 30-ditor për dhënien e vendimit të mosfillimit të procedimit penal, pasi brenda këtij afati, prokurori ka vlerësuar se nuk ka pasur vend për regjistrimin e ndonjë procedimi penal, pasi sa pretendonte kallëzuesi ishte zgjidhur me vendim gjyqësor të Gjykatës Administrative të Apelit, ku pretendimet e A. S., të ngritura në kallëzimin penal, ishin gjetur të padrejta. Duke qenë se nuk plotësoheshin kushtet dhe kriteret ligjore për regjistrimin e procedimit penal, pasi nuk ekzistonin të dhëna për konsumim të elementeve të ndonjë figure vepre penale, me qëllim që verifikimi të ishte shterues mbi vërtetësinë e dokumenteve bashkëlidhur kallëzimit penal, është pritur ardhja e dokumentacionit të kërkuar dhe, më pas, është dokumentuar vendimi për mosfillimin e procedimit penal. Aktet e administruara, me qëllim që fashikulli i verifikimit të kallëzimit penal të ishte i plotë, është plotësuar edhe me akte të kërkuara me shkresë, provonin sa rezultonte nga përmbajtja e vendimeve gjyqësore, ndaj është konkluduar me vendim mosfillimi të procedimit penal.

(ii) Vendimi i mosfillimit është kontrolluar nga Prokuroria e Përgjithshme mbi bazë të ankimit të shtetasit A. S. dhe është gjetur i bazuar në ligj, përfundim me të cilin është njohur dhe ankuesi. Ndaj vendimit të mosfillimit nuk është ushtruar ankim në gjykatë.

(iii) Ligjvënësi, me qëllim që prokuroria të mos shërbejë si organ për të mbledhur prova apo dokumentacion zyrtar, për interes të palëve, në mënyrë që ata t'i paraqesin në procesin civil, ka parashikuar se çdo shkresë në procesin civil mund të goditet për falsitet (nenet 270 dhe 271 të K. Pr. Penale), dhe kur falsifikimi i atribuohet një personi të caktuar, mund të bëhet denoncim për ndjekje penale. Nëse do të kishte rezultuar përdorim i dokumentit të falsifikuar në procesin gjyqësor civil, gjyqtari do të kishte referuar materialin në prokurori, pasi ka detyrim ligjor. Nëse do të kishim të bënim me dokument të falsifikuar të përdorur në gjykatë, shtetasi S., duke përmendur procesverbalin e seancës, ku ishte pasqyruar ky fakt i konstatuar nga gjykata, do ta kishte sjellë atë për ta bërë pjesë të fashikullit hetimor.

23.2. Trupi gjykues, nga shqyrtimi i akteve në dosjen gjyqësore, në raport me pretendimet e ngritura nga subjekti për këtë shkak ankimor dhe ligjin e zbatueshëm, konstaton dhe vlerëson si vijon.

23.2.1. Në vendimin “Për mosfillimin e procedimit penal”, datë 14.07.2015, subjekti i rivlerësimit pasqyron se, mbi bazën e kallëzimit të A. S. dhe materialit bashkëlidhur tij, më datë 29.04.2015, ka regjistruar materialin hetimor nr. {\*\*\*}, për veprën penale “Falsifikim i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal, nga i cili rezulton se kallëzuesi ka paraqitur kallëzim penal kundër shtetasit Z. Z., me detyrë ish- regjistruar në ZVRPP Elbasan. Në këtë vendim, subjekti pasqyron në mënyrë të hollësishme veprimet hetimore të kryera lidhur me pretendimin e kallëzuesit se, padrejtësisht, kufitarët veriorë, në pronën e tyre, kanë pushtuar pjesën lindore të pronës së tij, përmes dokumentit të falsifikuar “Vërtetim dokumenti hipotekor”, të datës 21.08.2000, lëshuar nga ZVRPP-ja Elbasan, ku paraqitet e pavërtetë vlera e sipërfaqes së truallit, mbështetur në regjistrin hipotekor të origjinës, datë 10.01.1978, ku figuron i regjistruar “Akt-pjesëtimi vullnetar {\*\*\*} rep., {\*\*\*} vol., datë 10.01.1978”. Subjekti shprehet se, për verifikimin e pretendimeve të kallëzimit, janë bërë kërkimet përkatëse pranë Gjykatës Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe pranë ZVRPP-së Elbasan, nga ku ka rezultuar se shtetasi A. S. i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, lidhur me pretendimet që ka pasur për këtë pronë, e cila me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 28.05.2004, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë së tij kundër Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave dhe pranimit e padisë së ndërhyrësve kryesorë, Pasmaqi kundër të paditurve S., duke detyruar të paditurit të njohin ndërhyrësit kryesorë, pronarë të sipërfaqeve respektivisht 160 m<sup>2</sup> dhe 250 m<sup>2</sup>, të ndodhura në lindje dhe në veri të pronës së të paditurve. Në vijim, pasqyrohen vendimet e gjykatave më të larta, që kanë disponuar mbi ankesën e kallëzuesit A. S., përmbyllur me vendimin e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr. 89, datë 20.06.2006, e cila ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur prej këtij shtetasi. Gjithashtu, pasqyrohet edhe ndjekja e kësaj çështjeje prej shtetasit A. S. në rrugë administrative, ku ZVRPP-ja Elbasan, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 13.07.2009, ka vendosur fshirjen e pronësisë në emër të H. P., të truallit objekt konflikti nga regjistrimet përkatëse, vendimi i miratuar nga Zyra Qendrore në Tiranë, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 04.03.2010. Për këto akte administrative, të kundërshtuara gjyqësisht nga shtetasi H. P., Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 02.05.2011, ka vendosur *anulimin* e tyre, për sa ka konstatuar se dispozitat e ligjit nr. 7843/1994, që kanë përbërë bazën ligjore mbi të cilën janë marrë këto akte, janë shfuqizuar prej Gjykatës Kushtetuese, dhe pushimin e gjykimit për sa i takon regjistrimit të pronës së shtetasit H. P., pasi ky shtetas disponon vërtetimin e pronësisë datë 21.08.2000, pronë e cila është e regjistruar në ZVRPP-në Elbasan. Mbi bazën e ankimit të shtetasit S., Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 07.05.2014, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. {\*\*\*}, datë 02.05.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, me arsyetimin e *deklarimit si absolutisht të pavlefshme të akteve administrative të ZVRRP-së Elbasan dhe ZQRPP-së Tiranë*, dhe ka vlerësuar se pala e paditur, ZVRRP Elbasan dhe ZQRPP Tiranë, duhet të kryejnë veprimet e nevojshme apo të bëjnë shënimet përkatëse në regjistrin e pasurive të paluajtshme, për të mundësuar anulimin e efekteve që mund të kenë sjellë këto akteve administrative. Në zbatim të këtij urdhërimi, ZVRPP Elbasan ka bërë veprimet e nevojshme dhe, prej Prokurorisë, është administruar praktika përkatëse. Gjithashtu, pasqyrohet se është administruar vendimi nr. {\*\*\*}, datë 06.03.2015, “Për tjetërsim të sipërfaqes ‘oborr në përdorim’”, dhënë nga Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, marrë mbi bazën

e kërkesës së shtetasit H. P., që ka vendosur pranimin e kërkesës, tjetërsimin pa kundërshpërblim dhe kalimin në pronësi të oborrit në përdorim, duke cituar edhe arsyetimin e këtij vendimi: *se nga hetimi dhe shqyrtimi tekniko-ligjor i fakteve dhe provave shkresore, subjekti kërkues (H. P.) provon të drejtën e pronësisë për sipërfaqen e pretenduar (referuar origjinës së dokumenteve të vjetra), por në zbatim të ligjeve të kohës, kjo sipërfaqe ka kaluar në përdorim të tij, sipërfaqe të cilën e ka poseduar në mënyrë të vazhdueshme dhe të pandërprerë. Subjekti, ndër të tjera, analizon se: Siç shihet edhe nga dokumentacioni ligjor i administruar nga ana jonë, çështja për të cilën ka paraqitur kallëzim penal shtetasi A. S. ka marrë zgjidhje në rrugë administrative por edhe gjyqësore... objekt i shqyrtimeve administrative dhe gjyqësore ka qenë edhe dokumenti “Vërtetim nga dokumenti hipotekor”, i datës 21.08.2000, i lëshuar nga regjistruesi Z. Z., vërtetim i cili ka rezultuar i drejtë dhe është pranuar nga gjykata. Terminologjia e përdorur në këtë vërtetim është sqaruar dhe pranuar përfundimisht edhe me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 06.03.2015, “Për tjetërsimin e sipërfaqes ‘oborr në përdorim’”, i dhënë nga Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave”. Duke konkluduar se në rastin konkret nuk ndodhemi para elementeve të veprës penale “Falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal, subjekti evidenton gjithashtu se, nga koha e lëshimit të dokumentit hipotekor, kanë kaluar gati 15 vjet, duke qenë jashtë çdo lloj mundësie për ushtrim të ndjekjes penale për shkak të kalimit të afateve të parashkrimit të kësaj vepre penale, të parashikuara në nenin 66 të Kodit Penal.*

**23.2.2.** Referuar shkresës së Prokurorisë së Përgjithshme, Drejtoria Task-Forcë, me lëndë “Kthim dosje” nr. {\*\*\*} prot., datë 12.11.2015, rezulton se mbi kërkesën dhe për nevoja të shqyrtimit të ankesës së shtetasit A. S., është dërguar fashikulli i kallëzimit penal, të mosfilluar, nr. {\*\*\*}/2015. Ky organ epror, pas shqyrtimit të ankimit ndaj vendimit të mosfillimit të procedimit penal nr. {\*\*\*}/2015, konfirmon se: *rezulton se nga ana e kësaj prokurorie janë kryer të gjitha veprimet e mundshme dhe të duhura hetimore, nuk ka vend për të kryer ndonjë veprim tjetër hetimor dhe se vendimi i mosfillimit është i bazuar në ligj, përfundim me të cilin është njohur dhe ankuesi. Gjithashtu, rezulton se shtetasi A. S. nuk e ka ankimuar në gjykatë vendimin e mosfillimit të këtij procedimi penal dhënë prej subjektit.*<sup>38</sup>

**23.2.3.** Mbështetur në sa pasqyruar më lart, rezulton se informacioni/të dhënat që gjenden në vërtetimin hipotekor, i cili ka qenë objekt i kallëzimit të shtetasit A. S., si i falsifikuar, janë verifikuar në rrugë administrative dhe janë kontrolluar nga sistemi gjyqësor, në të gjitha shkallët e tij, si pasojë e padive përkatëse të ngritura nga palët, të cilat kanë pasur në thelb të njëjtin objekt, verifikimin e përkatësisë së të drejtave që burojnë nga dokumenti i pretenduar si i falsifikuar, proces që dikton në mënyrë të pashmangshme edhe debatin mbi vërtetësinë e këtij dokumenti, dhe pasojat ligjore që vijnë nga përmbajtja e tij. Ky kontroll gjyqësor është konkluduar me konfirmimin e të drejtave të familjes P., që burojnë nga vërtetimi hipotekor i kontestuar edhe në kallëzim. Nga proceset gjyqësore të zhvilluara në vite, nuk ka rezultuar ndonjë e dhënë/indicie, që të çon drejt dyshimeve për falsifikim të këtij dokumenti nga punonjësit e ZVRPP-së Elbasan, që e kanë lëshuar atë, qoftë nga palët në gjykim, qoftë nga vetë gjykata në vendimmarrjet e saj. Në këtë kontekst, trupi gjykues konstaton se e gjithë kjo veprimtari gjyqësore, e cila i ka dhënë zgjidhje konfliktit civil mes palëve, nuk ka nxjerrë në dukje elemente të mund të trajtoheshin në lëmin penal apo ndonjë sjellje të dyshuar si

---

<sup>38</sup> Sipas informacionit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan me shkresën nr. {\*\*\*}, datë 15.11.2023

veprimtari kriminale, përveç se ka potencuar natyrën civile të konfliktit dhe ka dhënë zgjidhjen e vlerësuar si të drejtë. Për pasojë, trupi gjykues e gjen të drejtë analizën e bërë prej subjektit të rivlerësimit, se pretendimet e paraqitura në kallëzim janë, në fakt, pretendime që lidhen me përkatësinë e të drejtave civile, që burojnë prej këtij dokumenti, të cilat janë zgjidhur nga gjykatat kompetente. Përdorimi i një kallëzimi penal për të fituar/mbrojtur të drejtat civile, për të cilat gjykatat kompetente kanë mbajtur qëndrime përfundimtare, nuk legjitimon drejtësinë e këtyre pretendimeve.

**23.2.4.** Gjithashtu, trupi gjykues gjen të drejtë edhe argumentin tjetër të përdorur prej subjektit, se në çdo rast, ushtrimi i ndjekjes penale ndaj këtij pretendimi nuk mund të ushtrohej referuar kalimit të afateve të parashkrimit të parashikuara nga neni 66 i K. Penal. Vërtetimi, i cili pretendohet të jetë objekt hetimi si i falsifikuar, rezulton të jetë lëshuar prej ZVRPP-së Elbasan, në vitin 2000. Në pikën e tij fundore, ai rezulton të jetë përdorur në arsyetimin e gjykatës, për marrjen e vendimit në vitin 2004,<sup>39</sup> dhe në këndvështrim të argumentit të Komisionit, se ky përdorim do të mund të ndryshonte qasjen e subjektit në drejtim të parashkrimit të ushtrimit të ndjekjes penale, trupi gjykues konstaton sërish se ato do të vepronin njësoj. Vepra penale e pretenduar se është kryer, është ajo e falsifikimit të dokumenteve, parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal, referuar masës së dënimit, në maksimum prej tre vjetësh, parashkruhet me kalimin e një periudhe kohore prej 5 (pesë) vjetësh, sipas parashikimit të nenit 66, paragrafi 1, shkronja “c” e këtij kodi. Ky afat parashkrimi rezulton të kishte kaluar në vitin 2015, kur është paraqitur kallëzimi, qoftë në raport me kohën kur është krijuar dokumenti, viti 2000, qoftë në raport me kohën kur ai është përdorur, që në çdo rast shkon deri në vitin 2004, kur është dhënë vendimi i gjykatës që ka zgjidhur konfliktin civil. Trupi gjykues konstatoi se, edhe nëse do të kontrolloheshin afatet e parashkrimit për veprën penale të parashikuar nga neni 186, paragrafi 3 i K. Penal, duke qenë se pretendohet falsifikimi nga punonjësi i ZVRPP-së, referuar maksimumit të dënimit që parashikon kjo dispozitë prej 7 (shtatë) vjetësh, afati i parashkrimit, sipas nenit 66, paragrafi 1, shkronja “ç” e Kodit, prej 10 (dhjetë) vjetësh, sërish do të kishte kaluar, në vitin 2015, në raport me vitin 2000, dhe ndjekja penale nuk do të mund të ushtrohej as në këtë drejtim.

**23.2.5.** Trupi gjykues kontrolloi edhe konkluzionin e Komisionit, se subjekti e ka marrë vendimin e mosfillimit në shkeljet të afatit prej 15 ditësh, të parashikuar nga neni 291 i K. Pr. Penale. Së pari, trupi gjykues konstaton se konkluzioni i Komisionit mbështetet në një referim të gabuar ligjor, duke qenë se, në vitin 2015, kur subjekti ka marrë vendimin e mosfillimit objekt kontrolli, neni 291 nuk parashikonte afate procedurale ligjore, brenda të cilave duhej të kryhej veprimtaria verifikuese nga prokurorët për materialet kallëzuese. Ky afat prej 15 ditësh, i referuar në vendimin e Komisionit, është miratuar me ndryshimet e pësuar në K. Pr. Penale me ligjin nr. 37/2017, pasi ky vendim ishte marrë prej subjektit, për pasojë, ai nuk mund të jetë i zbatueshëm në këtë rast. Afati orientues/rregullator, që normonte situatën në vitin 2015, ishte udhëzimi i Prokurorit të Përgjithshëm nr. 241, datë 21.11.2005,<sup>40</sup> i ndryshuar, sipas të cilit, ky

---

<sup>39</sup> Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan ka vendosur rrëzimin e padisë së paditësit A. S. kundër Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, dhe pranimin e pranimit të padisë së ndërhyrësve kryesorë, P., me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 28.05.2004, i cili ka marrë formë përfundimtare me vendimin e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr. 89, datë 20.06.2006, e cila ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur prej këtij shtetasi.

<sup>40</sup> Udhëzimi nr. 241, datë 21.11.2005, i ndryshuar, në pikën 2 të tij, parashikon: “2.1. Në rastet kur me gjendjen e akteve, prokurori vlerëson se ekzistojnë rrethana që nuk lejojnë fillimin e procedimit, vendos mosfillimin e

afat ishte 30 ditë nga dita e regjistrimit të materialeve kallëzues/referuese. Në këndvështrim të këtij afati, rezulton se subjekti i vlerësimit e ka tejkalluar atë me 45 ditë, ka regjistruar materialin kallëzues, në datën 29.04.2015, dhe ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, në datën 14.07.2015. Ky tejkallim, në vlerësimin e trupit gjykues, duket se ka ardhur për shkak të një veprimtarie të zgjeruar verifikuese dhe kërkim dokumentacioni nga disa institucione, proces i cili ka marrë një kohë, që të paktën nuk evidenton neglizhencë nga ana e subjektit për tejkallimin e afatit, në kuadër të kompleksitetit të vetë kallëzimit. Në këto kushte, ndonëse konstatohet kjo e dhënë, trupi gjykues vlerëson se ajo ka një peshë jodomethënëse në konkluzionet që vijnë nga analiza e mësipërme e rastit.

23.3. Në përfundim, trupi gjykues, pas shqyrtimit dhe analizës së akteve në dosjen hetimore, vlerëson se qëndrimi i mbajtur prej subjektit të rivlerësimit, se në thelb fakti i pretenduar si penal kishte natyrë juridiko-civile, është i drejtë. Gjithashtu, i drejtë gjendet edhe qëndrimi i subjektit për kalimin e afatit të parashkrimit për ushtrimin e ndjekjes penale, për një falsifikim dokumenti, në vitin 2000, për të cilin kallëzimi ishte paraqitur në vitin 2015. Konkluzioni i Komisionit, se subjekti duhej të hetonte për përdorimin e këtij dokumenti, në një proces gjyqësor, në vitin 2004, përveç se nuk dokumentohet, në aktet e fashikullit, të ketë qenë pjesë e pretendimeve të denoncuesit, në materialin kallëzues të trajtuar prej subjektit, sërish do të sillte në zbatim dispozitat mbi parashkrimin e ushtrimit të ndjekjes penale. Në fund, pretendimet e denoncuesit ishin shqyrtuar në kuadër të proceseve gjyqësore dhe administrative, dhe ishin gjetur, në mënyrë përfundimtare, të padrejta, edhe për shkak të hetimit në origjinë të përmbajtjes së dokumentit të pretenduar si të falsifikuar. Për pasojë, trupi gjykues gjen të drejtë, lidhur me këtë procedim, vetëm konstatimin e Komisionit për tejkallim, me 45 ditë, të afatit 30-ditor, brenda të cilit do të duhej të merrej një vendim mosfillimi procedimi.

24. Lidhur me denoncimin e shtetasit R. B.,<sup>41</sup> i cili ankohet kundrejt disa subjekteve të rivlerësimit<sup>42</sup>, të cilët, me veprimet apo mosveprimet e tyre, kanë lënë të lirë vjedhësit e pasurisë së tij familjare, ndër ta edhe për subjektin e rivlerësimit,<sup>43</sup> për të cilën ankohet se: (i)

---

*procedimit, por jo më vonë se 10 ditë nga mbërritja e kallëzimit apo referimit të veprës penale. Gjatë kësaj periudhe nxitet të bëhet një minimum verifikimesh nëse ka nevojë për një gjë të tillë, në të kundërt, vendoset regjistrimi i procedimit. 2.2. Në një minimum verifikimesh, nëse ka nevojë për një gjë të tillë, në të kundërt, vendoset regjistrimi i procedimit. 2.3. Në raste të veçanta, kur me gjithë verifikimet e kryera në afatin e përcaktuar – në pikën 2.1 të sipërpërmendur, prokurori vlerëson se është e domosdoshme të kryhen verifikime të tjera për ekzistencën e elementeve thelbësore të faktit dhe/ose të elementeve të figurës së veprës penale, afati i verifikimit të kallëzimit penal dhe/ose njoftimit të veprës penale, të marrë me iniciativën e tij, të jetë në maksimum deri në 30 ditë. 2.3 Gjatë periudhës 30-ditore, të parashkuar në pikën 2.2 të këtij udhëzimi, prokurori kryen vetëm verifikime në lidhje me rrethanat që lejojnë ose nuk lejojnë fillimin e procedimit penal. Gjatë kësaj periudhe, prokurori nuk kryen veprime hetimore nga ato të parashkuara në Kodin e Procedurës Penale”.*

<sup>41</sup> Administruar prej Komisionit me nr. {\*\*\*} prot., datë 06.09.2019. Denoncuesi sqaron se, në janar të vitit 2018, i kanë grabitur një sasi të konsiderueshme cigaresh, të magazinuara në shtëpinë e prindërve të tij, në Polis të qytetit të Librazhdit. Pas ngjarjes, ai ka mundur të identifikojë autorët e grabitjes dhe, në datën 11.1.2018, ka paraqitur kallëzim penal për grabitësit. Në datën 22.1.2018 është regjistruar procedimi penal për veprën penale “Vjedhja”. Në datën 16.01.2018 janë sekuestruar cigaret e vjedhura të gjendura në dyqanet e shtetasve I. B. dhe L. K., si dhe janë marrë mostra për të kryer aktin e ekspertimit të tyre.

<sup>42</sup>Problematika e kësaj çështje është trajtuar edhe në emisionin investigativ “{\*\*\*}” - [https://\\*\\*\\*.tv/{\\*\\*\\*}.al/vjedhja-700-mije-euro-qe-nderroi-8-prokurore-pas-denoncimit-te-stop-rinisin-hetimet](https://***.tv/{***}.al/vjedhja-700-mije-euro-qe-nderroi-8-prokurore-pas-denoncimit-te-stop-rinisin-hetimet)

<sup>43</sup> Me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 28.12.2023, SPAK ka informuar se, pranë Prokurorisë për Krime të Rënda, janë regjistruar kallëzime penale të shtetasit R. B., në adresë të subjektit të rivlerësimit: (i) nr. {\*\*\*}, datë

ka kërkuar prej saj informacion për aktet dhe kryerjen e veprimeve hetimore, por nuk ka marrë asnjë informacion; (ii) nga subjekti nuk është vendosur lidhur me ekspertim teknik të USB-ve. Ankuesi shpjegon se, për këto arsye, nga data 26.06.2018 e në vijim, ka kërkuar përjashtimin e subjektit, kërkesë e pranuar nga Prokuroria, pas shumë refuzimesh, në datën 20.03.2019.

**24.1.** Komisioni, në analizë të shpjegimeve të subjektit dhe dokumentacionit të administruar, në raport me ligjin e zbatueshëm, ka konkluduar: (i) duket se shtetasi R. B. ka drejtuar kërkesat e tij bazuar në ligj dhe jo në mënyrë të gabuar, për sa kohë ai nuk ka cilësinë e palës, sikurse e kërkon neni 110 i K. Pr. Penale, por ka cilësinë e viktimës si kallëzues i veprës penale. Bazuar në nenin 58 të K. Pr. Penale, subjekti nuk ka përmbushur kërkesat e viktimës në kohë sipas kërkit<sup>44</sup> të bërë nga ana e tij, mangësi, që në vlerësimin e Komisionit, cenon anën profesionale të subjektit, pasi nuk ka respektuar të drejtat e viktimës, parashikuar në nenin 44, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016; (ii) veprimet hetimore në tërësinë e tyre duket se janë kryer sipas urdhrat të subjektit për kryerjen e hetimeve, shpjegimet e subjektit, se kishin mbetur pa kryer disa veprime hetimore, që sipas saj vareshin nga dinamika, duken bindëse, e për rrjedhojë, nuk evidentohen mangësi, që të mund të cenojnë veprimtarinë profesionale të subjektit; (iii) lidhur me konstatimin e Komisionit, se dukej se personat të cilëve iu atribuohet vepra penale ishin të qartë, që në aktet e hetimit fillestar dhe, për rrjedhojë, dukej se në mënyrë të pajustificuar, nuk ishte regjistruar emri i tij/tyre, në analizë të të dhënave të përfituara në këtë çështje dhe dinamikës së ngjarjes, ku aktualisht rezulton se një subjekt tjetër rivlerësimi ka pezulluar hetimin e këtij procedimi dhe dërgimin e tij pranë Drejtorisë së Policisë për gjetje autori, ka çmuar të argumentuara shpjegimet e subjektit dhe, për pasojë, nuk ka konkluduar në ndonjë rrethanë, që ndikon në vlerësimin e aftësisë profesionale të subjektit.

**24.2.** Subjekti i rivlerësimit pretendon se, në lidhje me këtë procedim penal, prej Komisionit është keqinterpretuar përgjigjja e saj. Sipas saj, ka shpjeguar se në çdo kohë, me cilësinë e viktimës ka njohur R. B. me gjendjen në të cilën ndodhej procedimi penal, si dhe i ka marrë deklarime sa herë ai ka kërkuar, fakt i provuar nga aktet e dosjes. Për kërkesat e R. B. nuk ka pasur vendimmarrje nga prokurori, pasi kërkimet nuk janë bërë në kuadër të nenit 110 të K. Pr. Penale, por me cilësinë e viktimës të veprës penale, këtij shtetasi nuk i është cenuar asnjë e drejtë procedurale, veprimet hetimore janë kryer në kohë dhe në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi. Në vijim, subjekti parashtron sa ka sqaruar për Komisionin në kuadër të barrës së provës, ku lidhur me disponimin e kërkesave të shtetasit R. B., ka shpjeguar si vijon:

(i) Kërkesat e denoncuesit, nëpërmjet avokatit të tij, janë bazuar në nenin 58 të K. Pr. Penale, që lidhen me të drejtat e viktimës për t’u njohur me aktet, dhe në këtë cilësi, i është dhënë mundësia për të marrë informacion në çdo kohë, të njihet me aktet, si dhe t’i drejtohet Prokurorisë me kërkesa për të marrë prova, ku për sa është kërkuar prej tij, është vlerësuar dhe këto prova janë marrë. Këtë fakt e provon më së miri pyetja e tij nga ana e organit procedues, sa herë ai është paraqitur.

(ii) Referuar përmbajtjes së deklarimeve të R. B., të datave 12.01.2018, 15.01.2018, 16.01.2018, 17.01.2018, 19.01.2018, 27.02.2018, 05.07.2018, 27.11.2018, nga ana e organit

---

*12.07.2018, dhe pas verifikimeve, në datën 23.07.2018, është vendosur mosfillimi i këtij procedimi; (ii) nr. {\*\*\*}, datë 16.09.2019, dhe pas verifikimeve, në datën 30.09.2019, është vendosur mosfillimi i këtij procedimi.*

<sup>44</sup> *Ky vlerësim duket se përkon edhe me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 58, datë 28.05.2022, dhe të Gjykatës së Lartë nr. 220, datë 13.09.2022 (poshtëshënimi 93, f. 60 e vendimit të Komisionit).*

procedues, viktimës R. B. i është bërë me dije se hetimet vazhdojnë, ai është njohur me aktet që nuk përbëjnë sekret hetimor dhe i janë marrë të dhënat që vlerësoheshin në ndihmë të hetimit. Janë respektuar të drejtat që i njihen viktimës nga K. Pr. Penale, i cili nuk e barazon viktimën me prokurorin, duke i bërë bashkëhetues, pasi përndryshe do të kishim të bënim me shkelje procedurale të nxjerrjes së sekretit hetimor.

**24.3.** Trupi gjykues, nga aktet në dosjen gjyqësore, në raport me pretendimet e subjektit dhe ligjin e zbatueshëm, konstaton dhe vlerëson si vijon.

**24.3.1.** Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, mbi bazën e vendit të ngjarjes, materialit referues nr. {\*\*\*}, datë 16.01.2018, të paraqitur në prokurori nga Komisariati i Policisë Librazhd, ka regjistruar procedimin penal nr. {\*\*\*}, të vitit 2018, për veprën penale “Vjedhje”, parashikuar nga neni 134 i Kodit Penal, pa autor. Në përgjigje të kërkesës së Komisionit, subjekti ka depozituar kopje të akteve të kryera për hetimin e këtij procedimi penal, duke sqaruar se ato i përkasin periudhës që ajo ka qenë prokurore për hetimin e këtij procedimi penal<sup>45</sup>. Nga aktet e administruara, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka urdhëruar, në datën 22.01.2018, kryerjen e veprimeve hetimore nga OPGj-ja dhe përcaktuar afatin e përfundimit të tyre, në datën 25.03.2018, për të cilën në Komision ka sqaruar se është data për përfundimin e veprimeve hetimore të planifikuara dhe jo për përfundimin e hetimeve, pasi dalja e të dhënave të reja dikton kryerje veprimesh hetimore shtesë.

**24.3.2.** Nga fashikujt e këtij procedimi penal, për sa është pretenduar nga denoncuesi e kërkuar gjatë këtij procedimi, konstatohet se ky denoncues në cilësinë e viktimës:

(i) Ka depozituar, përmes avokates së tij, V. V., kërkesë për vënien në dispozicion të kopjeve të akteve të hetimeve paraprake, në datën 01.02.2018, dhe nuk rezulton që të jetë pajisur me kopje të akteve apo përgjigje të kërimit të tij. Kjo kërkesë është ripërsëritur prej avokates, në datën 16.02.2018 (administruar në datën 19.02.2018, sipas shënimit) dhe 24.03.2018 (administruar në datën 26.03.2018, sipas shënimit). Në kërkesën e datës 24.03.2018, avokatja shprehet se: *“Kemi depozituar në sekretarinë e Prokurorisë dy kërkesa, përkatësisht në datat 01.02.2018 dhe 19.02.2018, me të cilat kemi kërkuar të njihemi dhe të na vihen në dispozicion fotokopje të akteve të dosjes hetimore pa autor të regjistruar nga ana juaj, në lidhje me veprën penale të vjedhjes, të kryer në pronën e prindërve të tij, në fshatin Polis-Gostimë, Librazhd. Edhe pse kërkesat tona rezulton të jenë plotësisht të bazuara në nenin 58 të K. Pr. Penale, nga ana juaj ende nuk na janë vënë në dispozicion akte të hetimeve paraprake në lidhje me këtë çështje. Në këto kushte, ripërsërisim kërkesën tonë për të marrë informacion për gjendjen e procedimit, për t’u njohur me aktet e provat e marra deri në këtë fazë të hetimit, si dhe për të marrë kopje të këtyre akteve, për të realizuar sa më mirë mbrojtjen e interesave të viktimës, konform nenit 58 të K. Pr. Penale... edhe pse nuk na janë vënë në dispozicion aktet e hetimeve paraprake të kërkuara, në të dy kërkesat e paraqitura pranë jush, kemi parashtruar disa kërkesa për marrje provash, për të cilat nuk kemi asnjë informacion nëse janë marrë në konsideratë apo jo nga ana juaj”*.

(ii) Në datën 27.07.2018, avokati F. T., përfaqësues me prokurë i shtetasit R. B., ka paraqitur kërkesë me objekt *“Kthim përgjigje për shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 25.07.2018, të*

---

<sup>45</sup> Dy fashikuj, marrë nga fashikujt që i përkasin procedimit penal nr. {\*\*\*}, viti 2018 (fashikulli i parë fillon nga faqja 15).

*prokurores Pranvera Stafa*”. Avokati shprehet se, në datën 10.07.2018, ka bërë kërkesë për marrje të kopjes së dosjes së procedimit penal nr. {\*\*\*/2018 dhe është bërë me dije se, me shkresën e drejtuar të dëmtuarit nga vepra penale, R. B., prej prokurores Stafa, me nr. {\*\*\*/ prot., datë 25.07.2018, kërkohet *çfarë aktesh kërkon të marrë avokati nga dosja*. Avokati vijon: *“Desha t’ju kujtoj se kam ardhur nga Tirana dhe ju kam takuar në zyrë në datën 10.07.2018 dhe ju kam kërkuar pikërisht këtë, pra të shoh dosjen dhe të piketoj dokumentet që desha të marr. Këtë gjë nuk e morët parasysh, duke më thënë që të bëj kërkesë zyrtare për marrjen e dosjes. Për këtë shkak, kam bërë kërkesën e protokolluar të datës 10.07.2018, ku kërkoja kopje të të gjithë dosjes. Si avokat nuk kam nga ta di çfarë ka apo nuk ka në dosje për t’ju kërkuar këtë apo atë dokument... Sa më sipër, jeni të lutur të procedoni sipas ligjit, duke më vënë në dispozicion të gjithë dosjen”*.

(iii) Në datat 26.05.2018 dhe 25.07.2018, kallëzuesi R. B. ka kërkuar zëvendësimin e subjektit, me arsyen se nuk kishte marrë aktet dhe nuk kishte reagim nga ana e subjektit, kërkesë që nuk është pranuar nga drejtuesja e Prokurorisë. Në vendimin e datës 26.07.2018, të drejtueses së prokurorisë, pasqyrohet se, në bazë të informacionit të dhënë nga prokurorja Stafa, kjo e fundit, me shkresën nr. {\*\*\*/ prot., datë 25.07.2018, ka informuar avokaten V. dhe avokatin F. T., *se në lidhje me kërkimet për njohje dhe marrje aktesh të procedimit penal nr. {\*\*\*/, të vitit 2018, i cili është ende në hetim, duhet të paraqiten pranë organit të prokurorisë për të specifikuar aktet konkrete, të cilat kërkojnë t’u vihen në dispozicion...*

(iv) Avokat T., në datën 12.12.2018, ka kërkuar vënien në dispozicion të dokumentacionit që lidhet me marrjen në pyetje të disa shtetasve, në dijeninë e tij, gjatë muajve shtator dhe tetor 2018, dhe nuk rezulton që të jetë pajisur me kopje të akteve apo përgjigje mbi kërkimin e tij.

(v) Në datën 21.02.2019, shtetasi R. B. i është drejtuar Drejtuesit të Prokurorisë Elbasan, për dijëni Prokurorit të Përgjithshëm, me kërkesë për zëvendësimin e subjektit. Në këtë kërkesë, shtetasi B. shprehet, ndër të tjera, se ka kaluar 1 vit e 1 muaj që prokurorja e çështjes mban peng dosjen dhe kryerjen e plotë të hetimeve, dhe se *qëndrimi i saj negativ u pa që në fillim, pasi nuk i jepte të dëmtuarit R. B. asnjë informacion mbi çështjen dhe asnjë fletë nga dosja. Kopja e dosjes iu dha pas mbi 8 muajsh, me kërkesë insistuese të tij dhe të një avokati të sjellë nga Tirana...*

(vi) Kërkesa e datës 21.09.2019, e shtetasit R. B., për zëvendësimin e subjektit nga ushtrimi i mëtejshëm i ndjekjes penale në kuadër të procedimit penal nr. {\*\*\*/, të vitit 2018, është disponuar nga drejtuesja e prokurorisë, me vendimin e datës 20.03.2019, duke e pranuar atë. Në këtë vendim, ndër të tjera, pasqyrohet se: *“...pas shqyrtimit të kërkesës së paraqitur nga shtetasi R. B., studimit të akteve të dosjes hetimore me nr. {\*\*\*/, të vitit 2018, si dhe informacioneve të dhëna mbi këtë procedim penal nga prokurorja Pranvera Stafa, konstatohet se, në fakt, gjatë gjithë periudhës së hetimit, janë kryer një sërë veprimesh hetimore. Nga ana e shtetasit R. B. janë paraqitur një sërë kërkesash për kryerje veprimesh hetimore, të cilat, në një pjesë të tyre, megjithëse nuk ka një vendim të shkruar nga prokurorja, nëse është marrë apo jo parasysh kërkesa e të dëmtuarit, rezulton të jenë kryer. Veprime të tjera hetimore, të kërkuara nga shtetasi R. B., megjithëse nuk ka një vendim të shkruar për refuzimin e tyre, nuk rezulton të jenë kryer ende nga prokurorja... Në këtë zëvendësim duhet të merret parasysh gjithashtu se palët meritojnë një hetim të drejtë dhe objektiv, i cili jo vetëm duhet të jetë i tillë, por edhe duhet të duket e të besohet nga qytetari. Në rastin konkret konstatohet se ky besim është cenuar, pikësepari nga mungesa e përgjigjeve mbi kërkesat që bën ky shtetas për kryerje*

veprimesh hetimore, të cilat duhet të kishin një përgjigje, qoftë negative apo pozitive, në respektim të neneve 58, 105 dhe 110 të Kodit të Procedurës Penale dhe nën dritën e parimit që drejtësia jo vetëm duhet të bëhet, por edhe të duket”.

24.4. Sa më sipër, *së pari*, trupi gjyqësor, në kuptim të nenit 58 të K. Pr. Penale,<sup>46</sup> si dhe në konsideratë të qëndrimit të Gjykatës së Lartë: “Kolegji sjell në vëmendje se viktimës së veprës penale, Kodi i njeh të drejtat e parashikuara në nenin 58 të tij. Qëllimi i kësaj dispozite (nenit 58 të KPP) është të përcaktojë pozitën e viktimës në procesin penal, si dhe të drejtat e saj procedurale nga momenti i njoftimit të veprës penale e deri në përfundim të procesit. Neni 58 i KPP rendit të drejtat e viktimës së veprës penale, të cilat mund të kategorizohen në të drejta eventuale (potenciale), të cilat viktimë mund të zgjedhë t’i ushtrojë ose jo, dhe të drejta të detyrueshme, ushtrimi i të cilave passjell detyrimin e organit procedues për t’i plotësuar”<sup>47</sup>, çmton të pabazuar pretendimin e subjektit se: *kërkesat e denoncuesit, nëpërmjet avokatit të tij, janë bazuar në nenin 58 të K. Pr. Penale, që lidhen me të drejtat e viktimës për t’u njohur me aktet, prandaj kallëzuesi nuk ka marrë përgjigje me shkrim*. Dispozita e sipërcituar parashikon të drejtën e viktimës që të njihet me aktet e provat, pa cenuar parimin e sekretit hetimor, të cilën Gjykata e Lartë e kualifikon si të drejtë të detyrueshme, me pasojë detyrimin e organit procedues për ta plotësuar, e nga sa pasqyruar më lart, lidhur me kërkesat e vazhdueshme të shtetasit R. B. për t’u njohur/marrë kopje të akteve të dosjes së procedimit penal, nuk rezulton që kjo e drejtë të jetë garantuar prej subjektit, duke përbërë edhe shkak për kërkesën për zëvendësimin e saj. *Së dyti*, aktet e cituara prej subjektit, *deklarimet e shtetasit R. B., të datave 12.01.2018, 15.01.2018, 16.01.2018, 17.01.2018, 19.01.2018, 27.02.2018, 05.07.2018, 27.11.2018*, mbi bazë të së cilave subjekti pretendon se, nga ana e organit procedues, viktimës R. B. i është bërë me dije se hetimet vazhdojnë, ai është njohur me aktet që nuk përbëjnë sekret hetimor dhe i janë marrë të dhënat që vlerësoheshin në ndihmë të hetimit, rezultojnë të jenë procesverbale, *“Për marrjen e të dhënave nga persona që tregojnë rrethana të dobishme për qëllime të hetimit”*. Referuar përmbajtjes së tyre, ndonëse ato demonstrojnë një rol aktiv dhe suportues të subjektit për të kënaqur pritshmëritë dhe dhënë përgjigje shqetësimeve të viktimës në këtë proces, në aspektin formal, nuk rezulton në to ndonjë e dhënë lidhur me njohjen prej shtetasit R. B. me aktet e procedimit penal.

24.5. Pavarësisht këtij konstatimi, që lidhet me mungesën e përgjigjeve formale, prej subjektit karshi kërkesave të përsëritura të viktimës, për njohjen me aktet e dosjes, rezulton një veprimtari e plotë hetimore në drejtim të verifikimit/hetimit të pretendimeve të viktimës, që lidhen me kryerjen e veprës penale të vjedhjes dhe zbulimin e autorëve. Subjekti rezulton se ka kryer logjikshëm veprimtarinë hetimore, duke ndjekur informacionet që kane dalë hap pas hapi nga hetimi dhe duke përdorur çdo mjet kërkimi prove në funksion të zbulimit të së vërtetës dhe vënien para përgjegjësisë së autorëve. Këtë veprimtari procedurale intensive dhe të

---

<sup>46</sup> K. Pr. Penale, në nenin 58 të titulluar “Të drejtat e viktimës së veprës penale”, në pikën 1, parashikon: “1. Viktimë e veprës penale ka të drejtë: a) të kërkojë ndjekjen penale të fajtorit; ... d) të kërkojë në çdo kohë informacion për gjendjen e procedimit, si dhe të njihet me aktet e provat, pa cenuar parimin e sekretit hetimor; dh) të kërkojë marrjen e provave, si dhe të parashtojë kërkesa të tjera përpara organit procedues; e) të informohet për arrestimin e të akuzuarit dhe lirin e tij, në kushtet e caktuara në këtë Kod; ë) të njoftohet për mosfillimin e procedimit, pushimin e çështjes, fillimin dhe përfundimin e gjykimit... j) të ushtrojë të drejta të tjera të parashikuara nga ky Kod...”.

<sup>47</sup> Shih vendimin e Gjykatës së Lartë nr. 298, datë 04.12.2024.

shoqëruar me një gamë të rëndësishme veprimesh hetimore e konfirmon edhe vetë Komisioni në konkluzionet e tij, duke mos konstatuar mangësi profesionale të subjektit të rivlerësimit për sa i përket njohurive ligjore dhe kryerjes logjikshëm të hetimit. Trupi gjykues vlerëson se, ndonëse prokurori ka detyrimin në garantojë disa të drejta të viktimës, një ndër to edhe atë të informimit, nëpërmjet kthimit përgjigje dhe njohjen me aktet, për aq sa nuk cenohet sekreti hetimor, fakti që veprimtaria hetimore e subjektit rezulton të ketë qenë në fakt në ndërveprim, apo në përgjigje të dyshimeve/pistave të ngritura prej viktimës, qoftë edhe në deklaratimet e dhëna në procesverbalet e shumta, ku ka deklaruar mbi rrethana që lidhen me veprën, tregon për një reagim substancial proporcional, të subjektit ndaj kërkesave të tij në raport me të drejtat që i njeh ligji.

24.6. Në përfundim, në lidhje me procedimin penal nr. {\*\*\*/2018, nga shqyrtimi i akteve në dosjen penale, trupi gjykues konstaton se, përgjithësisht, subjekti ka konsideruar dhe ndërmarrë veprime për shumicën e kërkesave të denoncuesit, në cilësinë e viktimës. Mosdisponimi me shkrim i përgjigjeve lidhur me kërkesat e adresuara nga avokatët e viktimës/denoncuesit, për njohje me akte apo për kryerjen e veprimeve hetimore të caktuara, vlerësohet si një mangësi në drejtim të respektimit të të drejtave të viktimës në procesin penal, por kjo mangësi nuk duket se ka ndikuar vetë hetimin dhe as ka cenuar cilësisht këto të drejta. Trupi gjykues ka në konsideratë në këtë vlerësim, se hetimi penal i rastit është shoqëruar me një rol aktiv të viktimës dhe përgjigje të subjektit ndaj kërkesave/informacioneve apo qasjes së tij ndaj hetimit. Rezultojnë veprime në aktet e administruara, që tregojnë për kryerjen e disa veprimeve hetimore në përgjigje të kërkesave të viktimës, si pyetja e tij në tetë raste, riekspertimi, me kërkesën e tij i pamjeve vizive të përfutuara prej USB-ve të sekuestruara, ripyetja e personave që kanë dijeni për ngjarjen, kryerja e kontrollit dhe e sekuestros mbi informacionin e dhënë prej viktimës etj. Në këtë kontekst, trupi gjykues vlerëson se, pavarësisht mangësive, e drejta e viktimës për të marrë pjesë në procesin hetimor nuk është cenuar prej tyre.

25. Lidhur me denoncimin e shtetasit P. B., i cili në cilësinë e pronarit të shoqërisë së ndërtimit “{\*\*\*}” ShPK<sup>48</sup>, bën me dije se, për shkak të prishjes së marrëdhënies kontraktuale të ndërlidhur me shoqërinë turke “{\*\*\*}”, dega Shqipëri (i referuar si “LAJV-I), ka kërkuar zgjidhje të mosmarrëveshjeve në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Për shkak të prishjes së marrëdhënies kontraktuale mes dy shoqërive, punonjësit e shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK kanë mbetur pa punë dhe pa paguar, dhe se nga kjo situatë ndihet i kërcënuar për jetën e tij dhe të

---

<sup>48</sup> Denoncimi i shtetasit P. B. është administruar me nr. {\*\*\*/2018, datë 27.06.2018. Denoncuesi shprehet se ishte administrator i shoqërisë së ndërtimit “{\*\*\*}” ShPK dhe me shoqërinë e kallëzuar kishte lidhur një marrëveshje nënkontraktuese, në bazë të së cilës kishte marrë përsipër kryerjen e disa punimeve në ndërtimin e dy projekteve të hidrocentraleve HPP Banja dhe HPP Moglicë. Marrëveshja kishte filluar të zbatohet që nga muaji nëntor i vitit 2013 deri në datën 16.11.2015, nëpërmjet makinerive të blera prej tij kishte kryer një sërë punimesh, kishte edhe fatura tatimore shitje. Pas kësaj date, sipas tij, shoqëria e tij ishte larguar prej të kallëzuarit nga puna pa i dhënë asnjë lloj shkak, veprim për të cilin ata i ishin drejtuar gjykatës me kërkesëpadi përkatëse, me objekt zgjidhje kontrate në mënyrë të njëanshme dhe shpërblim dëmi. Në kallëzim, kallëzuesi pretendonte se, për shkak të mosmarrëveshjeve lidhur me caktimin e çmimit për punën e kryer, atij i ishin mbajtur dhe nuk i ishin kthyer makineritë pronë e tij. Sipas tij, edhe për shkak të motit të keq, këto pajisje po shkatërroheshin dhe personat e autorizuar prej tij nuk ishin lejuar për marrjen e makinerive. Për shkak se pajisjet pronë e kallëzuesit ndodheshin në Kompaninë e Hecit të Banjës së Qarkut Elbasan, është bërë edhe shpallja e moskompetencës së hetimit të këtij procedimi penal dhe materiali është përcjellë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

familjes, si nga personat që iu detyrohet financiarisht ashtu dhe nga punonjësit e shoqërisë. Nisur nga kjo situatë, në datën 01.02.2016, ka depozituar kallëzim penal për veprën penale “Vetëgjyqësia”, parashikuar nga neni 277 i Kodit Penal, mbi bazën e të cilit, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është regjistruar procedimi penal nr. {\*\*\*}, datë 09.03.2016. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka shpallur moskompetencën dhe e ka përcjellë çështjen në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, e cila, në datën 20.04.2016, ka regjistruar procedimi penal nr. {\*\*\*}, për veprën penale “Vetëgjyqësia”, parashikuar nga neni 277 i Kodit Penal. Denoncuesi pretendon se subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer hetime dhe ka marrë vendim për pushim të çështjes penale, si dhe ka bashkëlidhur disa dokumente në formularin e denoncimit<sup>49</sup>.

**25.1.** Komisioni, në analizë të shpjegimeve të subjektit dhe dokumentacionit të administruar, në raport me ligjin e zbatueshëm në këtë çështje objekt shqyrtimi, ka konkluduar: *se nga ana e subjektit nuk janë ndërmarrë veprime hetimore të logjikshme, gjithëpërfshirëse, të plota dhe me efikasitet, të cilat mund të kishin hedhur dritë mbi rrethanat e faktit penal të kallëzuar, sipas nenit 72, pikat 2 e 3, si dhe nenit 74, pikat 4 e 5 të ligjit nr. 96/2016.* Ky konkluzion është mbështetur në arsyetimin e paraqitur në mënyrë të përmbledhur, si vijon:

(i) Subjekti, në periudhën qershor-dhjetor 2016, ka kryer veprime hetimore, janë mbajtur procesverbale në muajt qershor dhe shtator 2016, me persona që kanë dijeni për veprën penale, si dhe ka mbajtur korrespondencë me shoqërinë “{\*\*\*}”, në muajt qershor, korrik e tetor, për kërkim dokumentacioni, dhe në datën 16.12.2016, është përgatitur relacioni për përfundimin e hetimeve nga OPGj-ja, i miratuar nga subjekti në të njëjtën datë, duke disponuar me vendim për pushimin e çështjes.

(ii) Lidhur me vonesën e pajustificuar të kthimit të përgjigjes mbi kërkesën për informacion dhe dokumentacion, adresuar shoqërisë turke, shpjegimet e subjektit, se kërkesat janë përsëritur, nuk janë vlerësuar bindëse, pasi nga të dhënat e dosjes rezulton se subjekti është mjaftuar vetëm me dërgim shkresash në mënyrë të përsëritur ndaj të kallëzuarve, duke mbetur për muaj të tërë në pritje të përgjigjes, pa marrë masat e duhura për zbatimin e detyrave të konkretizuara në shkresat e përsëritura. Më konkretisht, subjekti nuk ka mundësuar kryerjen e veprimeve hetimore të tilla, si: administrim dokumentesh apo kërkim për paraqitje pranë organit procedues, me mënyrat që njeh ligji, brenda afateve ligjore, të personit të cilësuar në shkresën drejtuar shoqërisë. Rezulton se, gjatë periudhës së pritjes së informacionit nga shoqëria e lartpërmendur, nuk rezulton të jenë kryer veprime të tjera hetimore në kuadër të këtij procedimi penal. Nga aktet nuk rezulton të jetë pyetur shtetasi M. S., për të cilin, në korrespondencën e organit të akuzës me shoqërinë turke, është kërkuar njoftimi i tij për t’u paraqitur, por nga hetimi rezulton se subjekti është mjaftuar vetëm me konfirmimin e shoqërisë në përgjigjen e dhënë, se ky shtetas nuk ndodhej në Shqipëri. Po ashtu, nuk rezultoi të ishin bërë përpjekje për të pyetur punëtorët, të cilët rezultonin të shumtë në numër, për sa kohë pretendohet se kishin mbetur pa marrë pagesat e tyre për shkak të prishjes së kontratave të punës të lidhura drejtpërdrejt me kallëzuesin.

---

<sup>49</sup> *Vendimin datë 16.12.2016, për pushimin e çështjes. Deklaratën e dhënë në policinë e Elbasanit, datë 14.09.2015, nga shtetasja J. B., e bija e denoncuesit. Një deklaratë me shkrim dore e shtetasit P. B., datë 25.08.2015, ku deklaroi se do të shlyejë 2 pagat e prapambetura për punonjësit e shoqërisë së tij. Një letër, datë 05.09.2015, nga një vajzë drejtuar Kryeministrit për mospagesën e babait të saj. Një kontratë individuale pune, e shtetasit J. B. (vajzës së denoncuesit), datë 23.06.2015.*

25.2 Subjekti i rivlerësimit pretendon se konkluzioni i Komisionit dëshmon për një vlerësim jo me objektivitet të akteve të procedimit penal dhe jo në kuadër të qëllimit të ligjit nr. 84/2016. Sipas saj, nuk mund të jetë tregues për vlerësimin profesional hamendësimi *se çfarë do të kishte ndodhur, nëse do të ishin rrethana të tjera*, dhe referuar akteve të dosjes penale nuk ka pasur asnjë mangësi në aspektin e drejtimit, organizimit, kontrollimit të hetimit apo analizës ligjore në përmbajtje të vendimmarrjes. Në vijim, subjekti parashtron sa ka sqaruar në kuadër të barrës së provës, në mënyrë të përmbledhur, si vijon:

(i) Procedimi është regjistruar pa autor, prandaj nuk ka pasur tejkalim të afatit të hetimeve. Përgjigja e kërkuar nga shoqëria turke është pritur në kuadër të vazhdimësisë së hetimeve dhe nuk ka qenë e vetmja provë që pritej për zgjidhjen përfundimtare të çështjes. Plani hetimor, delegimi i veprimeve hetimore, mbledhja e provave të nevojshme dhe të domosdoshme për zgjidhjen e çështjes, janë kryer nga prokurori me përgjegjësi dhe profesionalizëm. Aktet janë prova të pakontestueshme se nuk kemi të bëjmë me hetim sipërfaqësor dhe se veprimtaria e prokurorit është tërësisht në përputhje me parashikimet e nenit 73/2/3 të ligjit nr. 96/2016.

(ii) Nuk janë pyetur të gjithë punëtorët, pasi me provat e grumbulluara konkludohej plotësisht se nuk kishim të bënim me një fakt penal dhe çështja penale duhej pushuar. K. Pr. Penale parashikon se në çdo kohë mund të hiqet dorë nga marrja e provave të planifikuara, që në vijimësi të hetimit apo gjykimit duken të panevojshme, ngaqë rrethanat e faktit janë të qarta. Janë pyetur persona që përfaqësonin të denoncuarin dhe denoncuësit, pra nga të dyja palët, thëniet e të cilëve kanë qenë të mjaftueshme për të konkluduar mbi sa kallëzohej penalisht dhe mbi faktin nëse kishim të bëjmë apo jo me vepër penale.

(iii) Në lidhje me mosmarrëveshjet ndërmjet palëve, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ndodhej për gjykim çështja civile me nr. {\*\*\*} Akti, datë 09.10.2015 dhe datë regjistrimi 12.10.2015, me palë paditës “{\*\*\*}” ShPK, dhe i paditur “{\*\*\*}”, me objekt: *“Shlyerjen e detyrimeve për prishje të kontratës jashtë çdo pike të përcaktuar në kontratë; Detyrimin për kryerjen e pagesave të prapambetura jashtë çdo afati; Detyrimin për shpërblim dëmi me pasojë shkaktimin e dëmit financiar dhe prishjen e imazhit të “{\*\*\*}” ShPK, si dhe shlyerjen e të gjitha detyrimeve të prapambetura”*. Hetimi provoi se kishim të bënim me marrëdhënie juridiko-civile, ku pretendimet e palëve rridhnin nga marrëdhëniet e punës dhe kontratat e lidhura ndërmjet tyre, por nuk kishim të bënim me elemente të veprës penale të vetëgjyqësisë. Kallëzuesi ndihej i kërcënuar nga kërkimet e punëmarrësve, të cilat kishin natyrë civile dhe nuk përmbanin elemente të ndonjë vepre penale.

(iv) Veprimet hetimore kanë qenë në vijimësi (në datat 6-7-27 qershor 2016; 19 korrik 2016; 19-26-27 shtator 2016; 3-4-14 tetor 2016 dhe 16.12.2016), nga prokurori është bërë drejtimi dhe kontrolli mbi hetimin, veprimtaria e organit procedues në kuadër të hetimit mbi faktin lidhet me kërkimin e informacionit dhe studimin e tij. Për shoqërinë private është kërkuar informacion duke respektuar afatin 30-ditor për kthimin e përgjigjes. Nga shoqëria është kthyer përgjigje, në rast të refuzimit të kthimit të përgjigjes nga Prokuroria do të zbatoheshin parashikimet e K. Pr. Penale, për mënyrën e marrjes së dokumentit tek të tretët.

(v) Vendimi i pushimit nuk është shqyrtuar nga gjykata për shkak të mosbërjes në kohë të ankimit nga i interesuari, por ka kaluar të gjitha shkallët e gjyqësorit, me pretendimin për rivendosje në afat. Gjykata e Lartë, në rast të një vendimi pushimi të paarsyetuar, si gjykatë

ligji, do kishte prishur si një vendim absolutisht të pavlefshëm për shkak të mungesës së arsytimit, sikundër bën edhe me vendimet gjyqësore. Për sa kjo nuk ka ndodhur, vendimin e pushimit të çështjes, gjykatat e kanë vlerësuar si plotësisht të arsyetuar.

**25.3.** Trupi gjykues, lidhur me sa pretendon dhe parashtron subjekti, në raport me aktet në dosjen gjyqësore dhe legjislacionin e zbatueshëm, konstaton dhe vlerëson si vijon.

**25.3.1.** *Së pari*, referuar vendimit të subjektit “Për pushimin e çështjes”, marrë në datën 16.12.2016, rezultojnë të pasqyruara veprimet hetimore të kryera në kuadër të këtij procedimi penal, të cilat dëshmohen nga aktet e fashikullit penal. Konkretisht, në datën 06.06.2016, janë marrë të dhëna nga shtetasi turk M. K., drejtor finance në shoqërinë turke “{\*\*\*}”, në prani të përkthyesit të gjuhës turke E. A. Ky shtetas ka deklaruar se shoqëria “{\*\*\*}” ShPK ka filluar punë në datën 14.11.2013, është nënshkruar kontrata për kryerje aktivitet punëtorie me shoqërinë “{\*\*\*}”, punimet e kryera janë faturuar dhe likuiduar pa mbetur asnjë detyrim i pashlyer dhe, në gusht të vitit 2015, kjo shoqëri është larguar vetë, pa asnjë shkresë apo njoftim prej kompanisë “{\*\*\*}” për prishje kontrate. Ky shtetas ka deklaruar se në kantierin e Banjës janë disa makineri, të cilat ata nuk dinë të kujt janë, se prej “{\*\*\*}” ShPK nuk është dorëzuar me shkrim listë e makinerive të pretenduara, se kanë pritur të informohen prej kësaj shoqërie për situatën që ka krijuar, por ajo nuk është paraqitur. Gjithashtu, po në datën 06.06.2016, janë marrë të dhëna nga M. K., avokat në shoqërinë turke, i cili bën të njëjtat deklarime si shtetasi K., dhe në datën 27.09.2016, janë marrë të dhëna edhe nga B. K., menaxher i sigurisë në shoqërinë turke. Avokati K., ndër të tjera, deklaroi se: *“Dua të sqaroj që P. B. i është drejtuar Gjykatës së Tiranës me kërkesëpadi për mosshlyerje të detyrimeve, ndërkohë që detyrimet ndaj tij janë shlyer nga kompania. Unë jam paraqitur në proces në Gjykatën e Tiranës dhe e di se procesi është në fazën e dërgimit të dokumentacionit nga ana e kompanisë sonë që të administrohen në cilësinë e provave. Pra, P. B. nuk ka lënë me dokumentacion ndonjë material apo makineri në ambientet e kantierit të kompanisë “{\*\*\*}”. Do ju vëmë në dispozicion çdo lloj dokumentacioni që kërkohet nga ana juaj”*. Gjithashtu janë marrë të dhëna nga shtetasi P. B., në datën 06.05.2016, nga shtetasi A. dhe A. B., në datën 09.05.2016, të cilët kanë deklaruar se janë pajisur me prokurë prej kallëzuesit për të marrë dhe transportuar makineritë që ishin në hidrocentral.

**25.3.2.** *Së dyti*, prej Drejtuesit të Prokurorisë Elbasan, shoqërisë turke “{\*\*\*}” i janë adresuar, në datën 07.06.2016, shkresa me lëndë *“Kërkim dokumentacioni dhe informacioni”* dhe, në datat 27.06.2016, 19.07.2016, 04.10.2016, shkresat me lëndë *“Kërkim dokumentacioni dhe informacioni (për kujtesë)”*, të cilat kanë të njëjtën përmbajtje. Konkretisht, për nevoja të hetimeve paraprake, kërkohet vënia në dispozicion e kontratës së lidhur mes shoqërive “{\*\*\*}” dhe “{\*\*\*}” ShPK, për llojin e punimeve të ndërtimit, objektet ku do të punohej, mjetet e përdorura, mënyrën e pagesës, shkaqet e prishjes së kontratës, nëse makineritë e pretenduara nga kallëzuesi janë lënë në ruajtje në kantieret e shoqërisë. Gjithashtu kërkohet bërja e mundur e njoftimit të shtetasi anglez që jeton në Turqi, M. S., të përmendur në kallëzimin e shtetasi P. B., për t’u paraqitur para organit procedues në datën ... Shkresat përmbillen me kërkesën për kthimin e përgjigjes, sa më shpejt të jetë e mundur, për efekt të afateve hetimore, shoqëruar dhe me një relacion shpjegues, dokumentacionin fotokopje të njësuar me origjinalin, duke mos u bërë pengesë për hetimin. Duke referuar datat e këtyre kërkesave dhe datat e veprimeve hetimore të pasqyruara në paragrafin më lart, të cilat kryesisht referojnë marrjen e të dhënave prej nëpunësve të kompanisë, të paraqitur pranë organit të akuzës, sipas thirrjes së bërë, trupi

gjykues konstaton se qëndron pretendimi i subjektit, *se përgjigjja e kërkuar nga shoqëria turke është pritur në kuadër të vazhdimësisë së hetimeve dhe nuk ka qenë e vetmja provë që pritej për zgjidhjen përfundimtare të çështjes*, pasi hetimi ka vijuar ndërkohë me marrjen e provave të tjera.

**25.3.3.** *Së treti*, shoqëria turke, në përgjigjen e saj, administruar në datën 13.12.2016 (në shkresë është shtypur data 14.10.2016), informon se ka nënshkruar kontratë shërbimi me shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK, për të kryer punime në fushën e betonimeve, me fuqinë punëtore dhe veglat e saj, si dhe me mjetet e shoqërisë “{\*\*\*}”. Për punimet e dokumentuara, pasi aprovohehin prej shoqërisë “{\*\*\*}”, lëshohej fatura përkatëse dhe shoqëria shlyente faturën e pranuar përmes llogarisë bankare të deklaruar nga dy shoqëritë. Ndër të tjera, informohet se shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, edhe pse është larguar për shkaqe të saj dhe pa njoftim me shkrim, ka dërguar me prokurë njerëz të saj në kantier dhe ka marrë vegla të pretenduara të saj, por pa u shoqëruar me dokument pronësie apo dorëzimi, për të cilat janë mbajtur procesverbalet përkatëse.<sup>50</sup> Lidhur me shtetasin M. S., shoqëria informon se ka qenë i punësuar pranë saj, por për shkak të largimit të tij nga Shqipëria dhe ndërprerjes përfundimisht të marrëdhënieve të punës, nuk ndodhet më dhe nuk vjen më në Shqipëri.

**25.4.** Në këndvështrim të të dhënave të përshkruara më sipër, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit ka kryer një veprimtari të plotë hetimore drejt evidentimit të ndonjë sjellje me natyrë kriminale dhe në vijim të personave përgjegjës. Ajo që në thelb duket se ka pretenduar kallëzuesi, P. B., në emër të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, ka qenë fakti se prej shoqërisë turke “{\*\*\*}”, nuk i ishin dorëzuar mjetet e punës në pronësi të shoqërisë kallëzuese, pas ndërprerjes së njëanshme të marrëdhënieve kontraktore midis shoqërive, duke e dëmtuar financiarisht atë. Gjithashtu, kallëzuesi ka pretenduar se shoqëria turke dhe punëtorët e mbetur të papunë dhe pa pagesë, për shkak të ndërprerjes së marrëdhënieve kontraktore, ishin duke vepruar në kushtet e konsumimit të veprës penale të vetëgjyqësisë, parashikuar nga nenit 277 i K. Penal, nëpërmjet moslejimit të marrjes në dorëzim të pajisjeve në pronësi të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, e që gjendeshin në territorin e kantierit të shoqërisë “{\*\*\*}”, dhe nëpërmjet veprimeve të mundshme hakmarrëse të punëtorëve. Hetimi i subjektit, për sa më sipër, ka synuar të identifikojë ndonjë veprimtari që mund të kualifikohej sipas pretendimeve të kallëzuesit dhe i ka rezultuar se, për të njëjtat probleme, shoqëritë në konflikt gjendeshin në procese gjyqësore, që synonin të zgjidhnin pasojat e ndërprerjes së njëanshme të kontratës së

---

<sup>50</sup> *Bashkëlidhur shkresës, shoqëria “{\*\*\*}” ka përcjellë katër procesverbale me shkrim dore: (i) datë 02.08.2016, për takim në ambientet e zyrës qendrore të shoqërisë, mes përfaqësuesve të saj, z. M. K., E. Gj. dhe z. B. e Sh. A. (për të dytët ka shënimin “nuk pranojnë të firmosin”); (ii) datë 03.08.2016, për takim në zyrat e kantierit Banjë, mes përfaqësuesve të saj, z. M. K., T. E., M. K. dhe z. P. D., autorizuar me prokurë nga z. B., ku përshkruhet se është biseduar lidhur me materialet e pretenduara nga shoqëria “{\*\*\*}”, duke cituar se në rast dokumentimi, vërtetimi, verifikimi dhe aprovimi nga “{\*\*\*}”, materialet mund të merren; (iii) datë 05.08.2016, në kantierin Banjë, ku përshkruhet se materialet e pretenduara nuk u vërtetuan me asnjë lloj dokumentacioni zyrtar/pronësie apo dorëzimi apo dokument tjetër të lëshuar nga “{\*\*\*}”, dhe se është lënë që përfaqësuesit me prokurë të “{\*\*\*}” të vijnë përsëri në datën 06.08.2016. Procesverbali është nënshkruar nga z. M. K. (datë 05.08.2016, në ambientet e zyrave të shoqërisë, ku përshkruhet se materialet e pretenduara nga “{\*\*\*}” ShPK, pasi u verifikuan në inventarin e shoqërisë “{\*\*\*}”, janë vërë re se nuk i përkasin shoqërisë dhe nuk dihet kujt i përkasin, por meqë zënë hapësirat e kantierit, të cilat do të boshatisen, drejtuesit e “{\*\*\*}” pranuan që shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, të marrë me vete materialet e pretenduara, sipas inventarit (procesverbali është nënshkruar për “{\*\*\*}” ShPK, nga z. P. D. dhe z. N. B.*

bashkëpunimit, prej palës kallëzuese. Gjithashtu, nga ajo që ka rezultuar prej hetimit, nuk ka dalë ndonjë e dhënë, që tregon se, me iniciativë dhe pa titull ligjor, shoqëria turke “{\*\*\*}” po mbante në posedim të paligjshëm mjetet e punës në pronësi të kallëzuesit, as vetë kallëzuesi nuk ka identifikuar qartë se për çfarë mjetej flitej dhe si dokumentohej ekzistenca e tyre dhe mbajtja prej shoqërisë tjetër, por edhe nga hetimi nuk kanë rezultuar të dhëna që shkonin në këtë drejtim. Për sa i përket pretendimit për pyetjen e punëtorëve, të cilët mund të reagonin karshi kallëzuesit, për shkak të mosmarrjes së pagave, trupi gjykues vlerëson se një veprim i tillë hetimor, që synon të zbulojë se çfarë mund të ngjasë në të ardhmen, është i pakuptimtë dhe i paarsyeshëm që të kryhet.

**25.5.** Gjithashtu, fakti që gjykata civile po zhvillonte një proces gjyqësor për të zgjidhur të njëjtat pretendime të shtruara edhe si fakte penale, krahas rezultateve të mësipërme të hetimit, që nuk tregojnë për veprime të cilat mund të përbëjnë fakte penale, vlerësohet prej trupit gjykues si një element mbështetës për argumentet e dhëna nga subjekti në vendimin e pushimit të çështjes, se konflikti ka natyrë civile dhe i takon gjykatës kompetente ta zgjidhë atë, ndërsa vepra penale e vetëgjyqësisë nuk provohet se është kryer.

**25.6.** Sa më sipër, në lidhje me procedimin penal nr. {\*\*\*}/2016, pas shqyrtimit të akteve në dosjen penale, trupi gjykues nuk identifikoi ndonjë veprimtari kriminale të evidentuar prej kallëzuesit, për të cilën duhej të zhvilloheshin hetime. Çështja rezulton me natyrë civile dhe duket se ka lindur tipikisht për shkak të zgjidhjes së një marrëdhënie kontraktuale mes palëve, provuar dhe nga fakti i paraqitjes së konfliktit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, nëpërmjet kërkesëpadisë përkatëse, informacioni i administruar prej Gjykatës në fashikullin penal dhe cituar ky fakt edhe nga subjekti në vendimin e pushimit. Lidhur me pyetjen e shtetasit M. S., që rezulton të ketë punuar për shoqërinë turke, nuk do të kishte hedhur dritë më shumë mbi faktet e pretenduara, nga sa kanë referuar punonjës të tjerë të kësaj shoqërie. Për rrjedhojë, trupi gjykues e gjen të pabazuar konkluzionin e Komisionit, se nga ana e subjektit nuk janë ndërmarrë veprime hetimore të logjikshme, gjithëpërfshirëse, të plota dhe me efikasitet, të cilat mund të kishin hedhur dritë mbi rrethanat e faktit penal të kallëzuar, pikërisht për shkak të mungesës së evidentimit të këtij fakti penal, qoftë edhe në fazë pretendimesh.

26. Lidhur me denoncimin e shtetas Sh. M.,<sup>51</sup> bashkëlidhur të cilit ka depozituar artikuj nga media e shkruar lidhur me ngjarjen,<sup>52</sup> e cila pretendon se subjekti i rivlerësimit, nëpërmjet avokatit, ka marrë ryshfet 15.000 euro nga kunati i saj, për të mbyllur çështjen e djalit të tij, dhe akuzon subjektin e rivlerësimit se ka ndryshuar vendngjarjen, ka ndryshuar akuzën, “nga plagosje me armë zjarri”, “në person i kapur me lëndë narkotike në automjetin e tij”, cilëson se, me kërkesë të saj, e ka rihapur çështjen 2 herë dhe pretendon se subjekti i rivlerësimit në bashkëpunim me dy subjekte të tjerë nga gjyqësori e ka mbyllur çështjen, konstatohet si vijon.

**26.1.** Komisioni ka administruar kopjen e fashikullit penal,<sup>53</sup> nga ku ka konstatuar se subjekti dhe të tjerë prokurorë kanë regjistruar e ndjekur veprimet hetimore të procedimit penal nr. {\*\*\*}, datë 06.09.2004, për veprat penale të parashikuara nga nenet 78-1-22-25, 278/2 e 238/2, të K. Penal, ndaj personave nën hetim L. M., R. T., S. K., A. M. e B. K., që hetoheshin nën

<sup>51</sup> Administruar prej Komisionit me nr. {\*\*\*} prot., datë 02.02.2018.

<sup>52</sup> Gazeta “Shekulli”, datë 05.09.2004, fotokopje e artikullit “Hakmarrja, përleshën me armë pesë të plagosur”; fotokopje e artikullit të titulluar: “Terrorizohet Spitali i Elbasanit/ Bluzat e Bardha kërcënohen me vdekje”.

<sup>53</sup> Përcjellë me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 22.11.2023.

masën e sigurimit “arrest me burg”. Për këtë çështje komplekse, e identifikuar kryesisht për konflikte me armë mes dy grupeve, ku në njërin prej tyre ka qenë i përfshirë edhe shtetasi A. M. (nipi i denoncueses), në analizë të dokumentacionit të administruar, fakteve të dala, shpjegimeve të subjektit për barrën e provës, në raport me ligjin e zbatueshëm, Komisioni ka konkluduar: *se moskryerja e të gjitha veprimeve hetimore të nevojshme, moszbatimi korrekt i parashikimeve procedurale penale, argumentimi jo i plotë dhe jo në përputhje me dispozitat ligjore, bien ndesh me kriteret e parashikuara në nenin 73, pikat 2 dhe 3 të ligjit nr. 96/2016, dhe duhet të merren në konsideratë në vlerësimin tërësor të çështjes së subjektit të rivlerësimit, sipas nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.* Ky konkluzion është bazuar në përfundimet si vijon:

(i) Moskryerja e veprimeve hetimore të plota dhe gjithëpërfshirëse, që në vitin 2004, sikurse është konfirmuar edhe me vendimin e shfuqizimit nga drejtuesi i prokurorisë në atë kohë, ku arsyetohet se për ngjarjen e vitit 2004 nuk janë kryer hetime të plota dhe se lind e nevojshme kryerja e më shumë veprimeve hetimore, pasi nga studimi i akteve ka rezultuar se ka pasur të dhëna për autorët e dyshuar të kësaj ngjarjeje.

(ii) Moszbatimi korrekt i parashikimeve procedurale penale, që passolli pavlefshmërinë dhe/ose papërdorshmërinë e akteve.

(iii) Procesimi i subjektit me kërkesën për gjykim, duke ngritur akuzën ndaj shtetasve në fjalë, duke përdorur të njëjtin hetim të kryer në vitin 2004 dhe veprimet hetimore që u shpallën të pavlefshme nga gjykata, janë rrethana që tregojnë mangësi domethënëse profesionale të subjektit.

**26.2.** Subjekti i rivlerësimit pretendon se veprimet hetimore janë kryer në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe zgjidhja ligjore ka qenë e bazuar në ligj, por edhe në këndvështrim të faktit që hetimet janë drejtuar nga dy prokurorët më të lartë në Prokurorinë Elbasan, e bën joproporcional dhe joobjektiv konkluzionin që ka mangësi profesionale për subjektin e rivlerësimit (vendimmarrja ka qenë kolegjiale). Sipas saj, Komisioni nuk ka marrë në konsideratë shpjegimet e dhëna që bazoheshin në dokumentacionin, pjesë e akteve të procedimit penal, nuk ka vlerësuar se të njëjtën zgjidhje ligjore kanë dhënë prokurorët e tjerë, të Prokurorisë Elbasan dhe Prokurorisë për Krime të Rënda, nuk ka mbajtur në konsideratë faktin që pezullimi i hetimeve është vendosur pas konsultimit me zyrën kontrolluese të specializuar në Prokurorinë e Përgjithshme. Në vijim, subjekti parashton sa ka sqaruar, në kuadër të barrës së provës, në mënyrë të përmbledhur, si vijon:

(i) Sikundër rezulton nga aktet, çështja ka qenë tepër komplekse. Në momentet e regjistrimit të procedimit penal, subjekti nuk ka qenë prokurorja që ka ndjekur hetimet, ajo është bërë pjesë e grupit hetimor, me caktim të drejtuesit të prokurorisë, pasi ishin kryer të gjitha veprimet e papërsëritshme, përfshirë edhe këqyrjen e vendngjarjes. Në përfundim të hetimeve, për sa nuk arrihej të provohej se personat nën hetim kishin konsumuar veprat penale për të cilat dyshoheshin, është vendosur pushimi i hetimeve dhe çështja penale është pezulluar, duke kaluar për vazhdimin e hetimeve pranë Drejtorisë së Policisë Elbasan. Ky vendim është marrë pas bërjes së analizës dhe vlerësimit të provave të mundshme të grumbulluara mbi faktin, nga prokurorët që përbënin grupin hetimor si dhe grupi i OPGj-ve të ngarkuar me kryerjen e veprimeve hetimore, mendimet e të cilëve janë dokumentuar në aktet përkatëse. Gjithashtu, është marrë dhe mendimi i Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm, si autoriteti më i lartë kontrollues, pasi dosja është dërguar për vlerësim në Drejtorinë e Krimit të Organizuar në

Zyrën e Prokurorit të Përgjithshëm Tiranë, e cila me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 12.04.2005, ka udhëzuar që procedimi penal të pezullohet dhe të kalohet për zbulim të autorëve në DVP-në e Qarkut Elbasan.

(ii) Drejtoria e Luftës kundër Krimit të Organizuar në Zyrën e Prokurorit të Përgjithshëm Tiranë, e cila më parë kishte studiuar dosjen {\*\*\*}/2004 dhe kishte orientuar pezullimin e hetimeve, pasi ka kërkuar informacion nga Drejtoritë e Policive Vendore, ku gjendeshin dosjet penale të pezulluara, mbi të dhënat shtesë të siguruara nga Policia e Shtetit gjatë kësaj kohe, ka vendosur rifillimin e hetimeve për një grup dosjesh, bashkimin e këtyre procedimeve dhe, për shkak të krijimit të Gjykatës për Krime të Rënda, është vendosur kalimi i akteve të këtyre procedimeve pranë kësaj Gjykate. Prokurorët pranë kësaj Gjykate, në përfundim të hetimeve kanë vendosur që, mbi bazën e provave të grumbulluara, nuk mund të ngrihej akuzë, kanë vlerësuar se nuk provohej autorësia e personave të dyshuar, ndaj kanë pezulluar hetimet.

(iii) Prokurori i Përgjithshëm ka shfuqizuar vendimin e marrë nga Prokuroria për Krimet e Rënda dhe ka urdhëruar vazhdimin e hetimeve për ngjarjen e datës 03.09.2004, duke vlerësuar se në vendimin e shfuqizimit, datë 18.04.2006, janë lënë një sërë detyrash që duhet të ishin kryer, një pjesë e të cilave nuk janë kryer pas kalimit të dosjes në Prokurorinë e Krimeve të Rënda. Pra, prishja e vendimit të pushimit të vitit 2005 ishte domosdoshmëri procedurale për të vazhduar hetimet, por nuk kishte lidhje me faktin që në kohën e marrjes së këtij vendimi hetimet nuk kanë qenë të plota.

(iv) Vazhdimi i hetimeve në vitin 2009 lidhet me sigurimin e të dhënave shtesë nga ana e Oficerëve të Policisë së Shtetit të ngarkuar me hetimin. Grupi hetimor kryesohej nga drejtuesi i prokurorisë, me përbërje krahas saj, edhe të zëvendësdrejtuesit të prokurorisë. Vendimmarrja ka qenë kolektive, pasi studioheshin provat e grumbulluara, hartohej plani hetimor, zgjatjet e hetimeve përtej afatit 3-mujor kanë qenë më se të domosdoshme, për shkak të hetimit kompleks, përdorimit të metodave proaktive, marrjes së akteve procedurale nëpërmjet letërporosisë etj., sa rezultonte se duhej verifikuar nga përgjimet telefonike të miratuara me vendim gjykate. Për shkak të rëndësisë së hetimit, veprimet hetimore kanë qenë sekret. K. Pr. Penale, neni 223/1, parashikon se prokurori i kërkon gjykatës shtyrjen e depozitimit të akteve deri në përfundim të hetimeve, për rastet kur çmon se nga dorëzimi në sekretari i akteve të përgjimit mund të dëmtohen hetimet. Referuar vendimeve të gjykatës që kanë lejuar përgjimet e komunikimeve telefonike, gjykata ka urdhëruar depozitimin e akteve të përgjimit në sekretari, në fund të hetimeve. Po kështu, vëzhgimet ambientale, dokumentet e siguruara nëpërmjet letërporosisë duhet të mbeteshin sekret deri në përfundim të hetimeve, në të kundërt, hetimi do të ishte dekonspiruar. Kjo është arsyeja që grupi hetimor i prokurorëve i ngarkuar me hetimin ka vendosur që komunikimi i vendimeve për zgjatjen e afatit të hetimeve të bëhet në përfundimin të hetimeve, në kuadër të njohjes me të gjitha aktet e procedimit penal. Të pandehurve në momentin e njohjes me këto vendime, ligji u lejonte të drejtën e ankimit brenda 10 ditëve.

(v) Nga ana e grupit hetimor është vlerësuar se çështja penale duhej dërguar për gjykim, pavarësisht mosmiratimit të zgjatjes së afateve të hetimit prej gjykatës, me provat e grumbulluara deri në momentin që nuk ishte marrë vendim për zgjatjen e afatit të hetimeve. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan ka shfuqizuar zgjatjet e afatit hetimor, por kjo ligjërisht nuk çonte automatikisht në mosvazhdimin e procedurave në lidhje me hetimet që po kryheshin. Pas shfuqizimit të vendimeve për zgjatjen e afatit hetimor, grupi hetimor ka hartuar vetëm akte

procedurale dhe nuk ka kryer veprime për të marrë prova. Në kërkesën për gjykim referohen kryesisht veprimet hetimore të kryera deri në zgjatjen e parë të hetimeve, që nuk është miratuar me vendim gjyqësor.

**26.3.** Nga aktet në dosjen gjyqësore, në raport me pretendimet e subjektit dhe ligjin e zbatueshëm, trupi gjykues konstaton dhe vlerëson si vijon.

**26.3.1.** Në mars të vitit 2005, në lidhje me shtetasit ndaj të cilëve zhvilloheshin hetimet, të cilët gjendeshin nën masën e sigurimit “arrest në burg”, është vendosur pushimi i çështjes, si dhe lirimi i menjëhershëm i tyre, më pas pezullimi i hetimeve dhe kalimi për ndjekje të çështjes nga strukturat e Policisë së Shtetit. Mbi bazën e shfuqizimit të këtyre vendimeve nga Prokurori i Përgjithshëm i Prokurorisë, në vitin 2009, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Elbasan ka regjistruar procedimin penal nr. {\*\*\*}, datë 27.01.2009, në ngarkim të personave të dyshuar dhe akuzuar për të njëjtat vepra penale, si në vitin 2004. Për hetimin e kësaj çështjeje është vendosur zgjatja katër herë me nga tre muaj e afatit hetimor, vendime të cilat u janë njoftuar personave të akuzuar pas kalimit të 10 muajve nga marrja e tyre. Këta persona kanë kërkuar pavlefshmërinë e vendimeve të zgjatjes së afateve të hetimit, si dhe papërdorshmërinë e akteve të krijuara pas datës 27.04.2009<sup>54</sup>, deri në datën 27.04.2010. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 22.02.2010, ka pranuar kërkesën e të akuzuarve dhe ka vendosur sipas objektit të saj, duke deklaruar të pavlefshme vendimet për zgjatje të afatit të hetimeve të datave 27.04.2009, 27.07.2009, 27.10.2009 dhe 27.01.2010. Në të njëjtën mënyrë ka disponuar Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 26.07.2010, duke deklaruar të pavlefshëm edhe vendimin e fundit të marrë për zgjatje të afatit të hetimeve, të datës 21.04.2010. Pavarësisht këtyre disponimeve gjyqësore, rezulton se subjekti/grupi hetimor ka vijuar me hartimin e akteve procedurale të nevojshme për të konkluduar për procedimin penal, duke vendosur dërgimin e çështjes në gjyq. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 19.12.2012, ka vendosur pushimin e gjykimit, duke arsyetuar se, për shkak të faktit se vendimet për zgjatjen e afateve janë deklaruar të pavlefshme, të gjitha aktet e tjera procedurale të hartuara prej prokurores/grupit hetimor, gjatë periudhës hetimore të zgjatur, janë të pavlefshme, për pasojë, e tillë është edhe kërkesa për gjykim dhe në thelb i gjithë procedimi penal, që si i tillë duhet të pushohet.

**26.3.2.** Mbi këtë situatë faktike, trupi gjykues konstaton, *së pari*, se Komisioni duket se ka ngarkuar me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit lidhur me faktin që, me vendimin e datës 08.01.2009, të Prokurorit të Përgjithshëm, është shfuqizuar edhe vendimi i marrë prej subjektit për pushimin e çështjes ndaj disa të dyshuarve dhe pezullimin e hetimeve lidhur me këtë procedim, duke konkluduar se subjekti ka demonstruar në këtë mënyrë mangësi profesionale. Trupi gjykues vëren se veprimtaria procedurale/profesionale e subjektit, por jo vetëm, e kontrolluar nga vendimi i mësipërm i Prokurorit të Përgjithshëm, i përket periudhës 2004 – 2005, dhe përtej analizës së rrethanave konkrete, përderisa aftësitë profesionale të subjekteve nuk mund të kontrollohen në kuadër të procesit të rivlerësimit përtej datës 1 janar 2006, sipas parashikimit të nenit 41, pika 4 e ligjit nr. 84/2016,<sup>55</sup> çdo konkluzion i nxjerrë prej Komisionit,

<sup>54</sup> Deri në këtë datë ka qenë tremujori i parë nga regjistrimi i procedimit.

<sup>55</sup> Vlerësimi i aftësive profesionale mund të shtrihet nga 1 janari 2006 e në vazhdim, sipas informacionit që disponohet për etikën dhe aftësitë profesionale.

përtej kësaj periudhe, është pa relevancë në vlerësimin e këtyre aftësive dhe, si i tillë, nuk iu nënshtrua kontrollit të trupit gjykues, por u konsiderua pa peshë për arsyet e mësipërme.

**26.3.3.** Lidhur me konkluzionin se shkelja prej subjektit e rregullave procedurale, që lidhen me zgjatjen e afateve të hetimit, ka sjellë pavlefshmërinë apo papërdorshmërinë e veprimeve hetimore, trupi gjykues vlerëson se, pavarësisht mënyrave se si ka disponuar gjykata, nëpërmjet deklaramit të pavlefshëm të vendimeve për zgjatje të afatit hetimor, konfirmohet se subjekti/grupi hetimor nuk kanë zbatuar me korrektesë dispozitat që rregullojnë zgjatjet e afatit të hetimeve sipas parashikimeve të neneve 324 e 325 të K. Pr. Penale, të kohës kur janë marrë vendimet. Kjo parregullsi lidhet me faktin se, ndonëse dispozitat nuk përcaktojnë saktësisht kohën se kur vendimi për zgjatje i komunikohet të pandehurve/mbrojtësve, ai supozohet të njoftohet në një kohë të arsyeshme, për t'i dhënë mundësi atyre ta kundërshtojnë, gjykatës ta vlerësojë dhe të shmanget veprimtaria hetimore e mëtejshme, pa u siguruar se ajo nuk do të rrezikojë të konsiderohet se ka sjellë si produkt prova të papërdorshme. Nga ana tjetër, dispozitat ligjore të kohës nuk parashikonin shprehimisht se mosrespektimi i këtij rregulli shkaktonte pavlefshmërinë e vendimit të zgjatjes, por vetëm rregullonte pasojat e vlerësimin si të padrejtë të zgjatjes prej gjykatës, që konsistonin në papërdorshmërinë e provave të administruara gjatë këtij segmenti kohor. Disponimet e gjykatës në rastin konkret, duke deklaruar pavlefshmërinë e vendimeve të zgjatjes, duket se kanë tejkaluar parashikimin ligjor përkatës dhe kanë krijuar vështirësi të paparashikuara nga legjislacioni për administrimin e procedimit penal<sup>56</sup>. Ky ambiguitet në interpretimin e normave procedurale solli si pasojë nevojën për qartësi të nenit 324 dhe 325 të K. Pr. Penale, nëpërmjet modifikimeve të kryera me ligjin nr. 37/2017.<sup>57</sup>

**26.3.4.** Gjithashtu, trupi gjykues mban në konsideratë se çështja e marrë në analizë paraqitet tepër komplekse, hetimet për të shtriheshin në një periudhë kohore të largët nga koha e zhvillimit të tyre, rrethana që kanë diktuar zgjatjen e fatit të hetimeve. Në hetimin e saj janë përfshirë disa zyra prokurorie, përfshi edhe strukturat drejtuese në Prokurorinë e Përgjithshme, veprimtaria hetimore e kryer pas regjistrimit të çështjes, në vitin 2009, është drejtuar prej një grupi prej tre prokurorësh, në të cilin, përveç subjektit, kanë bërë pjesë edhe dy prokurorë më të lartë, duket se fokusi i hetimit ka qenë mbledhja dhe administrimi i provave të nevojshme për akuzën dhe kjo ka devijuar vëmendjen nga ndjekja rigoroze e rregullave procedurale. Për shkak të këtyre rrethanave, trupi gjykues vlerëson se është e pamundur të përcaktohet saktësisht roli dhe përgjegjësia e subjektit të rivlerësimin në cenimin e rregullave procedurale, në një masë që do të duhej ta ngarkonte atë me përgjegjësi disiplinore.

**26.4.** Në përfundim, lidhur me denoncimin e shtetases Sh. M., i cili ka lidhje me procedimin penal nr. {\*\*\*}/2004, trupi gjykues, *së pari*, vlerëson se kontrolli nga Komisioni i veprimtarisë profesionale të subjektit, në vitin 2005, del jashtë afatit të përcaktuar në ligjin nr. 84/2016, që

---

<sup>56</sup> Neni 324, pika 4 e K. Pr. Penale të kohës parashikonte se: *Veprimet hetimore të kryera pas mbarimit të afatit nuk mund të përdoren, ndërsa neni 325 i po këtij Kodi parashikonte se: Kur gjykata pranon ankesën, hetimet nuk mund të vazhdojnë ose vazhdojnë vetëm për një afat të caktuar nga ajo.*

<sup>57</sup> Neni 324, pika 4 e K. Pr. Penale në fuqi, parashikon se: *“Provat e marra pas mbarimit të afatit nuk mund të përdoren”, ndërsa neni 325, pikat 3 dhe 3/1 të këtij Kodi parashikojnë se: “3. Kur ankimi pranohet dhe hetimet nuk duhet të vazhdojnë, gjykata urdhëron prokurorin që t'i përfundojë ato brenda një afati jo më të gjatë se 15 ditë. 3/1 - Kur ankimi pranohet, por hetimet duhet të vazhdojnë, gjykata urdhëron prokurorin t'i përfundojë ato brenda një afati të caktuar prej saj. Provat e marra brenda këtij afati janë të përdorshme”.*

përcakton si periudhë fundore për këtë kontroll vitin 2006, duke kufizuar kompetencat e institucioneve të rivlerësimit. Për pasojë, e konsideron konkluzionin lidhur me këtë vlerësim të pambështetur në ligj. *Së dyti*, trupi gjykues, në analizë të konstatimeve që lidhen me moskomunikimin në kohë të vendimeve për zgjatjen e afateve të hetimit dhe vendimeve gjyqësore lidhur me pavlefshmërinë e tyre, vlerëson se, ndërsa dakordësohet me konkluzionin se ato duhet të komunikohen në kohën e marrjes së tyre, mban në konsideratë të gjitha rrethanat e rastit për të përcaktuar peshën e tyre në drejtim të vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit. Në këtë kontekst, vlen të përmendet kompleksiteti i çështjes, përfshirja e subjektit në një grup hetimor që drejtohej nga prokurorë më të lartë dhe ndarja me ta e vendimmarrjes gjatë hetimit penal, paqartësia, si dhe mungesa e një qëndrimi të konsoliduar të jurisprudencës gjyqësore, lidhur me trajtimin e çështjes së njoftimit të vendimit për zgjatjen e afatit hetimor dhe pasojave që vinin prej saj, të cilat relativizojnë përgjegjësinë e subjektit në drejtim të problematikave të konstatuara në këtë rast.

27. Lidhur me denoncimin e shtetasit F. K.<sup>58</sup>, i cili ankohet për magjistratë në organin e akuzës dhe në gjyqësor, ndër ta dhe për subjektin e rivlerësimit, për të cilën pretendon se në bashkëpunim me të tjera subjekte dhe OPGj-në Xh. M., ka ndryshuar dhe falsifikuar provat dhe faktet në mbrojtje të krimit të organizuar dhe ka shpërdoruar detyrën. Në denoncimin e tij, ky shtetas sqaron se, në datën 12.02.2007, ka depozituar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, *kallëzim penal për një krim të mirëorganizuar*, bazuar në nenin 186 të Kodit Penal. Në kallëzim cilësohet se shkak i konfliktit është bërë ligjshmëria e kontratës noteriale të shitjes nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 02.03.2004, për shitjen e truallit nën banesë, me palë shitëse shtetasen A. Sh., banuese në Amerikë, përfaqësuar me prokurë të posaçme nga shtetasi B. P., banues në Elbasan, palë blerëse shtetasi R. E. Sipas pretendimeve të denoncuesit, kjo kontratë noteriale shitjeje, e përdorur për të nxjerrë një dokument hipotekor nga punonjësit e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, është bërë në kundërshtim të ligjit nga notere N. Gj., me përdorimin e një prokure të përkthyer, të falsifikuar dhe të palegalizuar. Denoncuesi në kallëzimin e tij shprehet se pala blerëse, kontratën noteriale të shitjes e ka përdorur në institucione shtetërore dhe private dhe se me *përpilimin dhe falsifikimin e kësaj prokure në gjuhë të huaj në bashkëpunim, dhe përdorimi i saj* i ka sjellë pasoja të rënda, duke i prishur banesën ku jetonte prej vitit 1980, me një dëm prej 50 milionë lekësh. Denoncuesi ngre pretendimin se, për shkak të miqësisë dhe njohjeve me noteren Gj., subjekti i rivlerësimit, në bashkëpunim me të tjera subjekte, gjatë hetimit, qëllimisht dhe me dashje, kanë falsifikuar provat dhe faktet, dhe se fillimisht, në datën 02.03.2007, ka marrë vendim për mosfillim të procedimit penal dhe, në datën 17.12.2007, ka marrë vendim për pushimin e çështjes. Të dyja këto vendime janë rrëzuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe i janë kthyer prokurorisë për vazhdim të hetimit. Përpara këtij fakti, denoncuesi ka kërkuar përjashtimin e subjektit nga hetimi i çështjes dhe ka bërë kallëzim penal në datën 12.02.2007, për atë dhe OPGj-në Xh. M., për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

27.1. Komisioni, në raport me shpjegimet e subjektit, dokumentacionin e administruar dhe ligjin e zbatueshëm, nisur nga rrethanat e çështjes, ka konstatuar se subjekti nuk ka kryer hetime të plota në drejtim të faktit të kallëzuar, për më tepër që i ka disponuar të dhënat mbi të

---

<sup>58</sup> Administruar në Komision me nr. {\*\*\*}, datë 13.12.2017. *Bashkëlidhur denoncimit, shtetasi F. K. ka depozituar disa dokumente mbi procesin hetimor ndër vite për këtë çështje.*

cilat duhet të bënte hetime, konkretisht zarfin ku ndodhej prokura, i cili mbante shënimin për datën 29.10.2004, ndërsa përkthimi në gjuhën shqipe datonte në shkurt 2002, çka do të thotë se subjekti duhet të kishte hetuar mbi faktin se si u krye përkthimi i një dokumenti në kohën kur zarfi nuk kishte mbërritur ende. Në vlerësim të Komisionit, *moskryerja e këtij veprimi hetimor, mënyra jo e saktë e vlerësimit të fakteve dhe provave, bie ndesh me kriteret e parashikuara për vlerësimin e aftësisë profesionale, parashikuar në nenin 73, pikat 2 dhe 3 të ligjit nr. 96/2016*. Ndërsa, lidhur me shfuqizimin e vendimit të pushimit të subjektit, duke konstatuar se, referuar aktit të drejtuesit të prokurorisë, evidentohet paraqitja e fakteve të reja nga kallëzuesi, Komisioni i ka çmuar bindëse shpjegimet e subjektit, duke mos konkluduar në ndonjë problematikë.

27.2. Subjekti i rivlerësimit pretendon se vendimmarrja e saj ka qenë e drejtë, se ka vepruar plotësisht në përputhje me nenin 72, pikat 3 dhe 4 të ligjit nr. 96/2016, dhe se nuk ka pasur prishje vendimi dhe urdhërim regjistrim emri për person të caktuar apo ngritje akuze, gjykata ka prishur vendimin e mosfillimit me argumentin se duhet regjistruar procedimi penal për të shuar të gjitha pretendimet e kallëzuesit, por jo që ishim përpara një vepre penale të konsumuar. Sipas saj, që hetimi ka qenë i plotë e provon më së miri fakti që pretendimet e parashtruara në kallëzimin penal, nga shtetasi F. K., janë bërë pjesë e debatit gjyqësor, dhe ka qenë ky shtetas që ka hequr dorë dhe nga ankimi gjyqësor. Konkluzioni i Komisionit duket sikur është vlerësim jo vetëm për subjektin, por edhe *për gjykatën që ka kontrolluar këtë vendimmarrje*, dhe, duke u shprehur se nuk është në misionin e Komisionit të jetë vlerësues për zgjidhjen ligjore të çështjeve të bëra nëpërmjet vendimmarrjes gjyqësore, subjekti potencon se ligji nr. 84/2016 nuk mund të përmbajë parashikime për të cenuar fuqinë e ligjeve të tjera në fuqi apo parimeve të përgjithshme të së drejtës. Në vijim, subjekti parashtron sa ka sqaruar në kuadër të barrës së provës, në mënyrë të përmbledhur, si vijon:

(i) Gjykata, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 18.05.2007, ka vendosur prishjen e vendimit “Për mosfillimin e procedimit penal”, datë 02.03.2007, me argumentin që “Prokura e Posaçme”, dokumenti i hartuar në gjuhën angleze pranë një noteri në Amerikë, përkthyer në Shqipëri, është një dokument i palegalizuar, në kundërshtim me ligjin nr. 9060, datë 05.08.2003 dhe VKM-së datë 07.03.2003. Ky dokument është përdorur për llogari të shtetases Shëngjergji nga shtetasi B. P., si për tjetërsimin e pronës, në kontratën e shitjes së hartuar nga notere N. Gj., dhe për regjistrimin e saj, të ndryshuar në ZVRPP-në Elbasan. Ky konstatim i gjykatës nuk dëshmonte për ekzistencën e ndonjë vepre penale. Në gjykatë nuk u soll ndonjë e dhënë, që të krijonte bindje për gjykatën se kemi të bëjmë me një prokurë të falsifikuar. Fakti që një prokurë është noterizuar nga noteri pa pasur vulë apostile, nuk përbën vepër penale, personi që paraqet dokumentin, mban përgjegjësi për vërtetësinë e dokumentit, është detyrë e gjykatës të mos pranojë administrimin e dokumenteve që nuk janë në formën e kërkuar nga ligji. Gjykata civile nuk ka konstatuar mungesën e vulës apostile. Kjo shkelje e gjykatës nuk përbën vepër penale, por i jep të drejtë palës së dëmtuar për të goditur vendimin gjyqësor, si të pabazuar në prova. Kemi cenim të marrëdhënies juridiko-civile dhe jo cenim marrëdhënies të mbrojtur nga e drejta penale.

(ii) Vendimi i mosfillimit është marrë bazuar dhe në faktin që pretendimet e ngritura nga ankuesi ishin parashtruar në kallëzime të mëparshme, të verifikuara. Vendimet që kishin marrë prokurorët e mëparshëm ishin kontrolluar nga gjykata dhe ishin gjetur të drejta. Kjo vendimmarrje bazohej në vendimet përkatëse të Prokurorisë, Gjykatës së Faktit e Apelit, të

cilat i kishin dhënë rrugë ligjore, sa pretendohet nga ankuesi. Megjithatë, për sa gjykata urdhëroi kryerjen e veprimeve hetimore, është regjistruar procedim penal dhe janë kryer veprimet hetimore të urdhëruara, në përfundim të tyre nuk ka rezultuar konsumim i elementeve të ndonjë vepre penale dhe është vendosur pushimi i çështjes. Ndaj vendimit të pushimit, F. K. ka bërë ankim në gjykatë dhe ka hequr dorë nga ankimi.

27.3. Trupi gjykues, pasi analizoi pretendimet e subjektit të rivlerësimit, në raport me dokumentacionin e administruar në dosjen gjyqësore dhe ligjin e zbatueshëm, konstaton dhe vlerëson si vijon.

27.3.1. Më datë 12.02.2007, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Elbasan ka regjistruar materialin hetimor nr. {\*\*\*}, lidhur me kallëzimin e shtetasit F. K. , i cili ka pretenduar se tjetërsimi i pasurisë, shitja e truallit ku ndodhej e ndërtuar banesa e tij, është bërë në kundërshtim me ligjin nga përdorimi i një dokumenti, prokurë e posaçme, e falsifikuar dhe e palegalizuar.

27.3.2. Më datë 02.03.2007, subjekti i rivlerësimit ka marrë vendimin “Për mosfillimin e procedimit”, për materialin nr. {\*\*\*}, datë 12.07.2007, ku ndër të tjera shprehet se: [...] *Lidhur me të gjitha sa pretenduar nga kallëzuesi në kallëzimin e datës 12.02.2007, nga ana jonë janë bërë verifikimet përkatëse, nga të cilat rezultoi se: lidhur me kallëzime të mëparshme të bëra nga shtetasi F. K. , të cilat kanë pasur në thelb të njëjtin objekt me kallëzimin e paraqitur në këtë moment, nga ana e prokurorisë i është dhënë zgjidhje ligjore. Më datë 26.06.2006, është vendosur mosfillimi i procedimit penal<sup>59</sup> për materialin kallëzues të shtetasit F. K. , vendim i ankimuar dhe i lënë në fuqi nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, dhe në bazë të verifikimit të bërë nga ana jonë, rezulton se ky vendim është ankimuar pranë Gjykatës së Apelit Durrës, në datën 10.10.2006 dhe aktualisht është në gjykim. Nga ana jonë është verifikuar e gjithë praktika dokumentare që pretendon kallëzuesi F. K. , pranë zyrës së noteres N. Gj. dhe pas këqyrjes së dokumentacionit në arshivën e saj është gjetur në origjinal një zarf, me dërgues shtetasja A. A. dhe marrës shtetasi B. P., në anë të të cilit lart janë dy pulla poste, me mbishkrimin “USA 2001” dhe një vulë afër tyre. Bashkëlidhur këtij zarfi është një dokument, i cili, në bazë të përkthimit legal në gjuhën shqipe, të bërë nga përkthyes N. C., më datë 18.02.2002, rezulton të jetë një prokurë e posaçme, e bërë nga shtetasja A. A., në gjuhën angleze, në emër të B. P., në përmbajtje të së cilës, ajo i jep të drejta B. P. lidhur me tjetërsimin e një pasurie të paluajtshme. Këto dokumente u morën me cilësinë e provës materiale ... Prokura e posaçme, e lëshuar nga A. A., është përkthyer në datën 18.02.2002. Duke pasur parasysh këtë fakt, nuk ka vend për zbatimin e ligjit nr. 9060, dt. 05.08.2003 dhe VKM-së 134, dt. 07.03.2003, pasi nuk kanë fuqi prapavepruese si dispozita të mëvonshme. Lidhur me këtë fakt, kallëzuesit i është dhënë përgjigje në vendimin e mosfillimit, datë 26.06.2006... prokura e posaçme ekziston në origjinal pranë zyrave përkatëse dhe ky fakt u verifikua nga ana jonë [...].*

---

<sup>59</sup> Referuar akteve të depozituara, konkretisht vendimit nr. {\*\*\*}, datë 22.09.2006, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor Elbasan, rezulton se vendimi i datës 26.06.2006, “Për mosfillimin e procedimit penal” është marrë për kallëzimin e bërë nga shtetasi F. K., ndaj prokurorit P. A., për veprën penale të “Shpërdorimit të detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Në vendimin e gjykatës pasqyrohet se shtetasi F. K. ka denoncuar shtetasin B. P. për veprën penale të “Falsifikimit të dokumenteve”, parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal, dhe nga ana e prokurorit A., pas verifikimit, me vendimin e datës 24.09.2004, është vendosur “Mosfillimi i procedimit penal”, vendim i ankimuar në gjykatë prej shtetasit F. K., dhe se në të gjitha shkallët e gjyqësorit është vendosur rrëzimi i kërkesës së tij, si e pabazuar në prova e në ligj.

27.3.3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 18.05.2007,<sup>60</sup> ka vendosur pranimin e ankimit të shtetasit F. K., prishjen e vendimit “Për mosfillimin e procedimit penal”, datë 02.03.2007, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, duke e urdhëruar atë për vazhdimin e hetimeve lidhur me këtë procedim. Në këtë vendim, gjykata shprehet se e gjen të pabazuar arsyetimin e bërë në vendimin e prokurorisë, se duke qenë se prokura është përkthyer në datën 18.02.2002, nuk ka vend për zbatimin e ligjit nr. 9060, dt. 05.08.2003 dhe VKM-së 134, dt. 07.03.2003, sepse këto janë dispozita të mëvonshme dhe nuk kanë fuqi prapavepruese, pasi prokura e posaçme, pavarësisht datës së përpilimit të saj, ka shërbyer për të kryer veprimet e tjetërsimit të pasurisë së paluajtshme në datën 02.03.2004, sipas kontratës së shitjes nr. {\*\*\*}, të hartuar nga notere Gj., e po kështu, në datën 24.02.2004, është bërë plotësimi i dokumentit “Aplikim kërkesë për regjistrim”, para ZVRPP-së Elbasan. Duke theksuar se data e përpilimit të prokurës në shtetin e huaj dhe data e përkthimit të saj në shtetin shqiptar nuk lidhen aspak me efektet juridike në aplikimin ndaj kësaj prokure, si një akt i autoritetit të huaj, të ligjit nr. 9060, dt. 05.08.2003 dhe VKM-së 134, dt. 07.03.2003, për legalizimin apo formën e caktuar ligjore që duhet të ketë ky akt për t’u bërë i zbatueshëm ligjërisht përpara organeve shtetërore e publike shqiptare, për më tepër, gjykata ka konstatuar se ky akt është përdorur përpara institucioneve shqiptare pas hyrjes në fuqi të akteve të sipërpërmendura dhe koncepti i fuqisë prapavepruese në këtë rast nuk gjen kategorikisht zbatim. Gjithashtu, gjykata konstaton se *nga organi i prokurorisë nuk është bërë verifikimi i plotë dhe konkludimi i duhur për sa i përket vijueshmërisë së veprimeve me datën kur është përpiluar kjo prokurë, datën kur është marrë nga shtetasi P., datën kur është përkthyer dhe datave kur janë kryer veprime përpara organeve përkatëse shtetërore e publike me këtë prokurë. Pasi nga këqyrja e kopjes së zarfit postar, ku ndodhej kjo prokurë, rezulton se ka një vulë me mbishkrimin “Waterbury CT 067 IA.29 Oct. 2004”, ndërkohë që përkthimi në gjuhën shqipe nga përkthyesi shqiptar rezulton të jetë bërë në datën 18.02.2002 (pra, daton në kohë përpara mbërritjes së zarfit me prokurën në shtetin shqiptar), dhe veprimi i shitjes para noteres dhe aplikimit në ZVRPP-në Elbasan datojnë para datës së pasqyruar në zarf, respektivisht në datën 02.03.2004, kontrata e shitjes dhe më datë 24.02.2004 është bërë edhe plotësimi i dokumentit “Aplikim kërkesë për regjistrim” para ZVRPP-së Elbasan. Për sa i përket pretendimeve të ngritura nga ankuesi për kallëzimet e mëparshme të bëra prej tij, gjykata konstatoi se, me vendimet përkatëse të Prokurorisë dhe Gjykatës së Faktit e të Gjykatës së Apelit i është dhënë zgjidhje ligjore, pavarësisht kontestimeve të tij dhe disponimit të ndryshëm ligjor që ka konkluduar kjo Gjykatë në rastin konkret. Në përfundim, gjykata konkludon se kërkesa e ankuesit është e bazuar dhe për shkaqet e sipërcituara, vendimi i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan duhet të priset dhe të vazhdojë hetimi lidhur me materialin kallëzues të paraqitur nga ankuesi dhe me zgjidhjen e problemeve të konstatuara nga kjo gjykatë.*

27.4. Sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se qëndron konkluzioni i Komisionit, se subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer verifikimet e duhura e të nevojshme në drejtim të faktit të kallëzuar. Pretendimi i subjektit se prishja e vendimit të mosfillimit është bërë nisur nga fakti që prokura që ishte bërë pjesë e dosjes së verifikimit të kallëzimit penal, ishte pa vulë apostile, rezulton të jetë i pabazuar, duke pasur në konsideratë arsyetimin e vendimit nr. {\*\*\*}, datë 18.05.2007, të Gjykatës Rrethit Gjyqësor Elbasan, sipas të cilit, përpos vlerësimit si të pabazuar të

---

<sup>60</sup> Vendimi i Gjykatës nuk është ankimuar dhe ka marrë formë të prerë më datë 28.05.2007.

arsyetimit të prokurorisë/subjektit lidhur me detyrimet e buruara prej ligjit nr. 9060, datë 05.08.2003 dhe VKM-së nr. 134, datë 07.03.2003, për përdorim në shtetin shqiptar të dokumenteve të përpiluara në shtete të huaja, me të njëjtën peshë është vlerësuar edhe moskryerja e verifikimeve të duhura, lidhur me dokumentet e administruara si provë. Trupi gjykues konstaton gjithashtu se rezulton se subjekti i ka disponuar të dhënat mbi të cilat duhet të bënte hetime lidhur me kontradiktoritetin e datës së gjendur mbi zarfin me të cilin është postuar prokura e posaçme, e marrë në analizë, dhe datës së hartimit të kontratës së shitblerjes, në të cilën ishte përdorur ajo prokurë. Mungesa e këtij vlerësimi, nuk gjendet e justifikuar me pretendimet e subjektit se kallëzuesi, për shkak të proceseve gjyqësore, e kishte humbur të drejtën e tij të pronësisë mbi truallin prej 66 m<sup>2</sup>, në emër të së cilës ai ngrinte çështjet ligjore.

28. Lidhur me denoncimin e avokates S. S.,<sup>61</sup> që i përket procedimit penal nr. {\*\*\*}/2017, hetuar nga subjekti i rivlerësimit, në analizë të rrethanave konkrete të çështjes dhe pretendimeve të subjektit, Komisioni ka konkluduar se: *Konstatimet mbi këtë procedim penal duket se dëshmojnë mangësi domethënëse në veprimtarinë profesionale të subjektit të rivlerësimit, e konkretisht si në mbikëqyrjen e punës së OPGJ-së, në ndërtimin e hetimit, si dhe në analizën dhe arsyetimin logjik (të prokurores) mbi aplikimin e masës së sigurimit, në raport me respektimin e parimeve juridike dhe të drejtave themelore të njeriut, që cenojnë në këtë mënyrë indikatorë të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016, duke i vlerësuar ato në referencë të nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 84/2016. Ky konkluzion mbështetet në përfundimet se subjekti:*

(i) Ka miratuar procedurën hetimore të ndërmarrë nga OPGJ-ja pa verifikuar e mbikëqyrur të dhënat e konstatuara, në procesverbalin e arrestimit në flagrancë të z. B. nuk rezulton asnjë deklaram, që vërteton zgjedhjen e tij për t'iu caktuar një avokat kryesisht dhe jo një avokat mbrojtës të zgjedhur prej tij, siç e kërkon ligji. Nga të dhënat e dosjes rezulton se këtij të akuzuari, në të shumtën e rasteve, i është marrë nënshkrimi pa u dokumentuar vullneti/zgjedhja e tij për të drejtat e tij sipas letrës së të drejtave dhe, për rrjedhojë, duket se nga ana e subjektit nuk janë respektuar masat që sigurojnë mbrojtjen procedurale për shtetasin e dyshuar.

(ii) Në caktimin e masës së sigurimit personal “Arrest në burg”, subjekti iu është referuar përgjithësisht dispozitave të procedurës penale (neneve 228-230 të Kodit të Procedurës Penale), ndërkohë që nuk janë mbajtur në konsideratë faktet që i akuzuari ishte i papunë, i padënuar më parë, rrezikshmëria e veprës penale, marrëdhëniet juridike që ajo ka prekur, pasojat e ardhura prej kryerjes së saj, raporti/shkaqet e lidhura me veprimet e të dyshuarit, rreziku që autori mund të arratisë, i cili duhet thënë se pranoi fajësinë. Në vlerësimin e Komisionit, përmbushja e kushteve dhe e kriterëve në caktimin e masave të sigurimit në këtë rast duhej të përcaktohej nga vlerësimi objektiv i fakteve dhe i rrethanave konkrete të çështjes, në harmoni dhe të udhëhequra nga parimet e sundimit të ligjit, sigurisë juridike, proporcionalitetit, si dhe duke respektuar të drejtat e liritë themelore të njeriut dhe jurisprudencës së Gjykatës Evropiane.<sup>62</sup>

28.1. Konkluzionet e mësipërme të Komisionit janë mbështetur edhe në konkluzionet e arritura prej vëzhguesit ndërkombëtar, të prezantuara në aktin “Gjetje”, bashkëlidhur dosjes përkatëse, e administruar në përputhje me nenin 49, pika 10 e ligjit nr. 84/2016.<sup>63</sup> Nëpërmjet “Gjetjes”, vëzhguesi ndërkombëtar sjell në pah se Komisioni duhet të marrë në konsideratë qëndrimet e

<sup>61</sup> Administruar në Komision me nr. {\*\*\*} prot., datë 28.05.2018.

<sup>62</sup> Vendimi i GJEDNJ-së, çështja “Simons v. Belgium”, 2012, paragrafi 32.

<sup>63</sup> Administruar në Komision me nr. {\*\*\*} prot., datë 21.02.2024.

pasqyruara në të, që rezultojnë të jenë ato mbi të cilat Komisioni ka mbështetur konkluzionin e tij të përshkruar më lart.<sup>64</sup>

**28.2.** Subjekti i rivlerësimit pretendon se konkluzioni i Komisionit vjen totalisht në kundërshtim me parashikimet e K. Pr. Penale dhe, në rastin e procedimit penal nr. {\*\*\*}/2017, detyra është përmbushur prej saj me profesionalizëm. Duke theksuar se prokuroria është organi që drejton kërkesën për caktim mase sigurimi, se ka qenë gjykata që ka kontrolluar dhe vlerësuar provat dhe kërkimet e prokurorisë, në kohë reale, dhe pasi i ka gjetur të drejta, ka vendosur mbi masën e sigurimit dhe dënimin, vendimmarrje ndaj së cilës i pandehuri nuk ka ushtruar ankim, subjekti parashtron sa ka sqaruar në kuadër të barrës së provës, në mënyrë të përmbledhur, si vijon:

(i) Procedimi penal ka filluar mbi bazë të njoftimit të viktimës E. T. në Sallën Operative të DVP-së Elbasan, se po ndjek një person që ka vjedhur në dyqanin e tij. Patrulla e policisë vënë në ndjekje të autorit të vjedhjes, ka bërë të mundur kapjen e A. B., për këtë fakt është hartuar procesverbali i kapjes në flagrancë, si dhe raporti përkatës për shoqërimin e personave, në datën 26.11.2017, në përputhje me parashikimet e K. Pr. Penale. Ndodhur para këtij fakti, nga ana e OPGj-së në DVP-në Elbasan, janë bërë veprimet e para hetimore me iniciativë, sipas parashikimeve të K. Pr. Penale, Kreu IV, neni 293 e vijues. Aktet të cilat janë me sigël të Prokurorisë Elbasan, pasi përdoret modeli i dërguar nga Prokuroria e Përgjithshme, janë dërguar në prokurori me shkresë përcjellëse nga DVP-ja Elbasan dhe janë regjistruar me nr. {\*\*\*}prot., datë 27.11.2017.

(ii) Më datë 26.11.2017, nga ana e OPGj-së janë kryer me iniciativë veprime hetimore, si marrja e kallëzimit penal të viktimës E. T., si dhe marrja e deklarimit të këtij shtetasi në cilësinë e personit që ka dijeni për rrethanat e çështjes, procesverbal për këqyrjen dhe marrjen e provës materiale, procesverbal i kontrollit të vendeve, procesverbal për këqyrjen e kamerave të sigurisë. Këto akte procedurale, brenda afatit të parashikuar në nenet 300 dhe 301 të K. Pr. Penale, janë dërguar në prokurori dhe janë vlerësuar si të ligjshme nga prokurori i çështjes. Gjithashtu, në këtë datë, nga ana e OPGj-së, pasi është konstatuar se kemi të bëjmë me vepër penale dhe identifikim të autorit të saj, është bërë referimi te prokurori i gatshëm, prej të cilit është caktuar avokat *kryesisht* me qëllim garantimin e të drejtave të personit nën hetim, për sa personi që kishte kryer vjedhjen, nuk kishte zgjedhur mbrojtës dhe nuk ka pretenduar për mbrojtës nga familjarët përpara OPGj-së. Njoftimi i A. B., për mundësinë e zgjedhjes vetë të një avokati mbrojtës dhe që ka të drejtën e heshtjes, i është bërë që në momentet e shoqërimit,

---

<sup>64</sup> Në mënyrë të përmbledhur, qëndrimet e vëzhguesit në “Gjetjen” e tij janë: i) Mospërmbushja dhe dështimi dukshëm i subjektit të rivlerësimit për të mbrojtur të drejtat procedurale të personit të arrestuar, nga veprimet e dukshme arbitrare të OPGJ-së, të miratuara pa vëzhgim/supervizim nga ana e subjektit të rivlerësimit; ii) Bazën ligjore dhe arsyetimin e dhënë nga subjekti i rivlerësimit gjatë kërkesës së caktimit të masës së sigurisë “Arrest me burg” për të pandehurin, e cila i është referuar përgjithësisht dispozitave të procedurës penale referuar kësaj mase sigurimi (nenet 228-230 të K. Pr. Penale), ndërkohë që nuk i ka kontekstualizuar këto dispozita për çështjen penale konkrete individuale; iii) Çështja në fjalë kishte të bënte me veprën penale “Vjedhja” e dy palë gërshërë, me vlerë shumë të parëndësishme monetare (minimale), e cila nuk është vepër e një rëndësie të jashtëzakonshme. I dyshuari e ka pranuar fajin në mënyrë të përsëritur, brenda më pak se 24 orëve nga verifikimi i rrethanave nga OPGJ-ja, dhe në një procedurë shumë të diskutueshme ligjore. Është gjetur në banesë, është i martuar dhe i papunë. Këto rrethana, me logjikë, tregojnë se nuk ka pasur rrezik të veçantë ikeje/arratisjeje, pengimi të hetimeve, apo përsëritje të veprës penale nga ana e të dyshuarit, gjë që shtron pyetjen nëse kërkesa për caktimin e masës së sigurimit personal të arrestit me burg, e kërkuar nga subjekti i rivlerësimit, është e justifikuar ose proporcionale.

dhe këtë e provon nënshkrimi i tij në deklaratën për njohjen me të drejtat e personit nën hetim, procedura e njoftimit të letrës së të drejtave është ripërsëritur nga OPGJ-ja në momentin e kryerjes së arrestimit të tij në flagrancë, duke garantuar plotësisht të drejtat e personit nën hetim për t'u asistuar nga një mbrojtës i zgjedhur prej tij apo familjarëve të tij.

(iii) Më datë 26.11.2017, ora 17:00, A. B. është pyetur si person nën hetim në prani të avokatit mbrojtës E. N., i caktuar kryesisht me vendimin e prokurorit të datës 26.11.2017. OPGJ-ja, në procesverbalin e marrjes së të dhënave nga personi ndaj të cilit zhvillohen hetime, shënon se A. B. është pyetur si person ndaj të cilit zhvillohen hetime, fakti pse gabimisht në pyetjen e tij, ai përdor termin: “ju akuzoheni”, në vend të: “ju dyshoheni”, nuk e bën procesverbalin e deklaramit të pavlefshëm si akt, në kuptim të parashikimeve të neneve 128 dhe 129 të K. Pr. Penale, për më tepër që është nënshkruar pa asnjë vërejtje nga personi nën hetim, i cili ka deklaruar në prani të avokatit mbrojtës pa pasur asnjë pretendim në lidhje me mënyrën si është proceduar gjatë marrjes së deklaramit të tij.

(iv) Procesverbali për kontrollin e banesës së A. B., në orën 12:20 minuta, brenda orarit të lejuar sipas nenit 206 të K. Pr. Penale, i kryer me iniciativën e OPGJ-së, ishte i ligjshëm, pasi plotësoheshin kriteret e parashikuara nga neni 202, paragrafi 3, në lidhje me nenin 298 të K. Pr. Penale (gjendje flagrance); kishte arsye të bazuara që OPGJ-ja të mendonte se në banesë gjendeshin sende (gërshërët e vjedhura 3 javë më parë), të cilat rrezikonin të fshiheshin nga familjarët, nëse kontrolli nuk do të ishte ushtruar urgjentisht (parandalimi i fshehjes apo humbjes së provës materiale). Kjo urgjencë nuk mund të priste nxjerrjen e një vendimi kontrolli, personi është kapur me sendet që tregojnë se kishte kryer veprën penale dhe pamjet e kamerave krijojnë dyshim të arsyeshëm se sendet e vjedhura mund të gjendeshin në banesën e tij. Gjatë kontrollit të banesës, A. B. ka pasur prezent një njeri të besuar, babain e tij.

(v) Avokati i zgjedhur nga familjarët është paraqitur pasi A. B. ishte vendosur në dhomat e paraburgimit, pra pasi ishin kryer veprimet e para procedurale dhe ishte hartuar procesverbali i arrestimit në flagrancë. Pretendimet e avokates S. lidhen me përgjegjësinë e personelit që administrojnë dhomat e paraburgimit, për të cilin pretendon se nuk e ka lejuar të takohet me klientin e saj dhe nuk ka asnjë pretendim për shkelje procedurale prej prokurores apo OPGJ-së, që ka kryer veprimet hetimore me A. B.

(vi) Kodi Penal, neni 134/2 i tij, nuk e lidh veprën penale të vjedhjes me vlerën e sendeve të vjedhura. Në rastin konkret, autori tregon për shkallë të lartë rrezikshmërie, ka realizuar një vjedhje tri javë më parë dhe tek i njëjti vend është kthyer dhe ka realizuar vjedhjen për herë të dytë, ka pranuar fajësinë, pasi ka qenë i detyruar nisur nga fakti që kishte të bënte me pamje të regjistruara nga kamerat e sigurisë, pasi për vjedhjen e parë fillimisht ka tentuar ta mohojë, duke thënë se i ka blerë gërshërët. Kualifikimi i veprës penale *vjedhje në mënyrë të përsëritur*, i cili është gjetur i drejtë edhe prej Gjykatës, dëshmon për një shkallë të lartë rrezikshmërie shoqërore të veprës penale dhe të autorit, rrethanat lehtësuese janë marrë në konsideratë, duke e çuar këtë çështje me gjykim të drejtpërdrejtë, në funksion të arritjes së qëllimeve të dënimit penal, kërkesa për caktimin e masës së sigurimit personal *arrest me burg* është e justifikuar dhe proporcionale me veprën penale të konsumuar. Kjo masë sigurimi është kërkuar nisur nga ekzistenca e rrezikut të përsëritjes së veprës penale dhe nisur nga marzhi i dënimit që parashikon dispozita përkatëse, rreziku i ikjes ishte i pranishëm.

28.3. Trupi gjykues, pas shqyrtimit të akteve në dosjen gjyqësore, në raport me pretendimet e subjektit si më sipër, bazuar në legjislacionin e zbatueshëm, konstaton dhe vlerëson si vijon.

28.3.1. *Së pari*, referuar akteve procedurale për dokumentimin e veprimeve hetimore të kryera me iniciativë, në datën 26.11.2017, rezulton se OPGj-ja: (i) Në orën 10:40 mban procesverbal “Për kallëzimin e veprës penale”, nga shtetasi E. T.; (ii) Në orën 11:20 mban procesverbal, “Për marrjen e të dhënave nga personi që ka dijeni për veprën penale”, nënshkruar nga shtetasi E. T., ku sërish ky i fundit deklaron se *vjedhjen e kryer nga z. B. mund ta vërtetojë me pamjet e kamerave të sigurisë, që do t’i hedhë në CD dhe mund t’jua vërë në dispozicion*; (iii) Në orën 12:20 – 13:00 mban procesverbal “Për kontrollin e vendeve”, për kontrollin me iniciativë për shkak të *gjendjes së flagrancës*, të shtëpisë së z. B., firmosur nga z. B., babai i tij dhe 4 punonjës policie, në të cilin është plotësuar me shkrim dore: *“Pasi u njoha me arsyen e kontrollit ... gjatë kontrollit nuk kërkoj avokat mbrojtës... këto gërshërë i kam blerë para tre javësh në një dyqan, në vendin e quajtur ‘Kryqëzimi i Cërrikut’”*; (iv) Në orën 14:00, mban procesverbal “Për sekuestrimin e sendeve”, lidhur me sekuestrimin e sendit: *“I disk me pamje filmike të datës 05.11.2017 dhe 26.11.2007, të dyqanit të shtetasit T., që ndodhet në lagjen ‘Çlirimi’ të qytetit të Elbasanit”*, nga shtetasi T.; (v) Në “Procesverbal i këqyrjes së pamjeve filmike të sekuestruara në datën 26.11.2017” (nuk shënohet ora) pasqyron se *nga ana policisë është sekuestruar një disk me pamjet filmike të ambienteve të brendshme të dyqanit të shtetasit T., dhe përshkruan çfarë rezulton nga këqyrja e pamjeve filmike të datës 5.11.2017 dhe 26.11.2017*; (iv) Në orën 16:30 mban procesverbal “Për sekuestrimin e sendeve”, për sekuestrimin e *1 palë gërshërë*, ku pasqyrohet se personi që i zotëronte këto sende, deklaron: *“Këto gërshërë unë i kam vjedhur sot, në një dyqan të ‘Kryqëzimi i Cërrikut’, në qytetin e Elbasanit”*, si dhe me shkrim dore pasqyrohet emër, mbiemër dhe nënshkrimi i shtetasit A. B.

28.3.2. *Së dyti*, subjekti i rivlerësimit, në vendimin e datës 26.11.2017, “Për caktimin e mbrojtësit”, shprehet se, pasi është njohur me materialet hetimore, konstaton se ndaj shtetasit A. B., *në cilësinë e personit ndaj të cilit po zhvillohet hetimi*, janë duke u kryer veprimet hetimore për veprën penale “Vjedhje”, se ai do të pyetet nga OPGj-ja dhe, *meqenëse ekzistojnë kushtet e parashikuara nga neni 49/a,<sup>65</sup> germa “ë” e K. Pr. Penale, vendos të caktojë mbrojtës kryesisht për personin nën hetim, A. B.*

28.3.3. *Së treti*, në orën 17:00, në procesverbalin “Për marrjen e të dhënave nga personi ndaj të cilit zhvillohen hetime”, i nënshkruar nga avokati mbrojtës i caktuar kryesisht, shtetasi A. B. dhe OPGJ-ja, pasqyrohet se pyetja e tij bëhet në *prani të avokatit mbrojtës E. N.*, se këtij shtetasi i janë shpjeguar, prej OPGj-së, e drejta e heshtjes, arsyet pse po merrej në pyetje, të dhënat ndaj tij, karta e të drejtave të të pandehurit. OPGJ-ja adreson pyetjen: *ju akuzoheni për vjedhje..., shtetasi B. pranon se ishte informuar për të drejtat e tij, ishte njohur me arsyet pse akuzohej, në prani të avokatit mbrojtës të caktuar kryesisht dhe ka pranuar kryerjen e veprës penale, në dy raste. Në orën 19:30, në procesverbalin për arrestimin në flagrancë, firmosur nga z. B. dhe OPGJ-ja, ky i fundit ka njoftuar të arrestuarin se, në bazë të nenit 255 të K. Pr. Penale, ai kishte*

---

<sup>65</sup> “I pandehuri pa mjete të mjaftueshme financiare” parashikon: “Kur nuk janë rastet e mbrojtjes së detyrueshme dhe i pandehuri që nuk ka mjete financiare të mjaftueshme kërkon mbrojtës, organi procedues cakton mbrojtësin nga lista e vënë në dispozicion nga institucionet e ndihmës juridike falas. Shpenzimet e mbrojtjes mbulohen nga shteti”.

të drejtë të zgjidhte një avokat, të heshte dhe çfarëdo që do të deklaronte, do të përdorej kundër tij në gjykim. Me pëlqimin e të arrestuarit, OPGJ-ja ka njoftuar familjarët për arrestimin.

**28.3.4.** *Së katërti*, më datë 28.11.2017, subjekti i është drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, me kërkesë “*Për vleftësimin e arrestit në flagrancë, caktimin e masës së sigurimit dhe gjykimin e drejtpërdrejtë të procedimit penal nr. {\*\*\*}, viti 2017*”, kundër të pandehurit A. B., akuzuar për veprën penale “Vjedhje”, e kryer më shumë se një herë, parashikuar nga neni 134/2 i K. Penal. Subjekti shprehet në kërkesë se arrestimi në flagrancë i të pandehurit, i kryer nga Oficeri i Policisë Gjyqësore është i ligjshëm, pasi është kryer në përputhje me nenin 251 e vijues të K. Pr. Penale dhe se ekzistojnë kushtet dhe kriteret e parashikuara në nenet 228/1, 3/a, b, 229/1, 2, 230/1 të këtij kodi, që ndaj të pandehurit të caktohet një masë sigurimi personal me karakter shtrëngues. Në caktimin e llojit të masës së sigurimit për të dyshuarin duhet të mbahen parasysh rrezikshmëria e veprës penale, raportet shoqërore që ajo prek, pasojën e ardhur nga kjo veprimtari, përhapjen e kësaj figure krimi, moshën e të arrestuarit, faktin që është i padënuar, si dhe duke parë vetë dispozitivin e veprës penale të parashikuar nga neni 134/2 i Kodit Penal, duke kërkuar që ndaj tij të caktohet masë sigurimi “arrest me burg”, parashikuar nga neni 238 i Kodit Penal. Në lidhje me kërkesën për gjykimin e drejtpërdrejtë të kësaj çështjeje penale, subjekti parashtron se ekzistojnë të gjitha kriteret e përcaktuara në ligjin procedural dhe material penal, për aplikimin e kësaj procedurë të posaçme.

**28.3.5.** *Së pesti*, referuar vendimit nr. {\*\*\*}, datë 29.11.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, që ka disponuar kërkesën e prokurores Stafa, duke e pranuar atë, dhe vleftësuar të ligjshëm arrestin në flagrancë ndaj personit nën hetim, A. B., të caktojnë si masë sigurimi personal ndaj tij, atë të “Arrestit në burg”, si dhe të pranojnë kërkesën për gjykimin e çështjes me gjykim të drejtpërdrejtë, duke caktuar zhvillimin e tij në datën 12.12.2017, ditë në të cilën është zhvilluar edhe gjykimi i kësaj çështjeje dhe shpallur vendimi për zgjidhjen e saj.

**28.4.** Për sa më lart, trupi gjykues konstaton se veprimet e subjektit të rivlerësimit, lidhur me procedimin në fjalë, janë kryer duke ndjekur një ritëm të shpejtë përshtatur dinamikës së ngjarjes dhe nivelit të provueshmërisë së veprës penale për të cilën akuzohej i arrestuari. Veprimet e para hetimore, të kryera me iniciativë prej OPGJ-ve, në përputhje me nenin 293 e vijues të K. Pr. Penale, rezulton se janë kontrolluar e legjitimuar prej subjektit, në cilësinë e prokurores së çështjes, në përputhje me këto dispozita. Fakti i caktimit të një mbrojtësi kryesisht është kryer në momentet e para të shoqërimit të personit të dyshuar, pasi ai, ndërsa rezulton se është njohur me letrën e të drejtave, ka shprehur vullnetin të japë shpjegime në prani të mbrojtësit të caktuar kryesisht, avokatit E. N.,<sup>66</sup> në funksion të qëllimit për t’i garantuar atij të drejtën e mbrojtjes së parashikuar prej nenit 296, paragrafi 1 i K. Pr. Penale.<sup>67</sup> Pasi i dyshuari Baho është arrestuar në flagrancë, sipas procesverbalit të mbajtur për këtë qëllim, ai ka kërkuar të njoftohen familjarët për të zgjedhur një mbrojtës, i cili i është siguruar prej organeve

<sup>66</sup> Në procesverbalin “Për marrjen e të dhënave nga personi ndaj të cilit zhvillohen hetimet, datë 26.11.2017, ora 17:00 pasqyrohet, ndër të tjera, se i dyshuari deklaron: pasi m’u bë me dije dhe m’u vu në dispozicion letra e të drejtave dhe pasi u vura në dijeni për arsyen për të cilën akuzohem, sqaroj se unë do të jap shpjegime në prani të avokatit mbrojtës, E. N.

<sup>67</sup> Oficerët e Policisë Gjyqësore marrin të dhëna nga personi ndaj të cilit zhvillohen hetimet në praninë e detyrueshme të mbrojtësit të tij, me përjashtim të rasteve të personit të arrestuar në flagrancë ose të ndaluar, të cilët merren në pyetje sipas rregullave të nenit 256. Kur mbrojtësi nuk është gjetur ose nuk është paraqitur, Policia Gjyqësore kërkon nga prokurori që të caktojë një mbrojtës tjetër. Në çdo rast, përpara se të procedohet me marrjen në pyetje, atij i jepet letra e të drejtave. Zbatohen rregullat e neneve 34/a dhe 38 të këtij Kodi.

proceduese. Mungesa e kontaktimit të tij me mbrojtësen e zgjedhur prej familjarëve të tij, nuk ka ardhur si pasojë e ndonjë veprimi refuzues të subjektit të rivlerësimit, por prej veprimeve kundërshtuese që e kanë penguar këtë kontakt, të punonjësve të dhomave të paraburgimit, ndaj të cilëve avokatja S. ka bërë kallëzim, i cili është trajtuar prej një tjetër prokurori të zyrës.<sup>68</sup> Në këtë kontekst, trupi gjykues nuk konstaton shkelje të rregullave procedurale që lidhen me garantimin e të drejtave të mbrojtjes së të dyshuarit. Vërtetësia apo cilësia e akteve procedurale që janë hartuar prej OPGJ-ve në rastin konkret, ndonëse nuk paraqiten në nivelin e duhur profesional, nuk mund të shërbejnë si shkaqe për të cenuar legjitimitetin e veprimtarisë së tyre, për sa kohë që nuk rezulton dhe as është pretenduar prej të dyshuarit, se këto shkelje, që lidhen me të drejtën e mbrojtjes, kanë ndodhur. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se konkluzionet e Komisionit, që i adresohen veprimtarisë procedurale të subjektit, që ka lejuar mosgarantimin e së drejtës së mbrojtjes, bazohen kryesisht në faktin që aktiviteti procedural i Policisë Gjyqësore nuk rezulton të jetë në nivelin e duhur, por jo në ndonjë të dhënë konkrete, që provon cenimin e së drejtës së mbrojtjes. Në të gjithë këtë vlerësim, trupi gjykues mban në konsideratë edhe faktin se e gjithë veprimtaria procedurale objekt kontrolli është kryer me iniciativë prej Oficerëve të Policisë Gjyqësore, në kushtet e gjendjes së flagrancës, dhe përfaqëson kryesisht veprime të papërsëritshme hetimore, të zhvilluara në harkun kohor të dy ditëve, dhe në kushtet e provueshmërisë së veprës penale dhe pohimit të fajësisë prej vetë të dyshuarit, elemente që duket se kanë diktuar edhe vlerësimin me një diligjencë më të ulët të kësaj veprimtarie prej subjektit të rivlerësimit.

**28.5.** Lidhur me konkluzionin e Komisionit, për mungesën e proporcionalitetit të caktimit të masës së sigurimit “Arrest në burg”, që ka sjellë edhe cenim të së drejtave të të pandehurit, trupi gjykues analizoi në funksion të shqyrtimit të këtij momenti, jo vetëm faktet që janë parashtruar në vendimin e Komisionit, dhe që mbështesin konkluzionin e mësipërm, të cilat konfirmohen prej këtij gjykimi, por edhe disa elemente të tjera, të cilat u vlerësuan relevante për arritjen e një përfundimi rreth kësaj vendimmarrjeje. Në këtë kontekst, trupi gjykues ndan të njëjtin qëndrim me Komisionin dhe qëndrimin e vëzhguesit ndërkombëtar, në dokumentin “Gjetje”, se masa e arrestit në burg, për një individ me të dhënat e të pandehurit, akuzuar për veprën penale të “vjedhjes së dy palë gërshtëre”, me një vlerë pa asnjë domethënie ekonomike, është joproporcionale dhe e padrejtë në këndvështrim të dispozitave procedurale që rregullojnë vendosjen e masave të sigurimit personal. Krahas këtij vlerësimi, trupi gjykues analizoi edhe disa rrethana të tjera të rëndësishme, për të matur peshën e konstatimit të mësipërm drejt përgjegjësisë apo mangësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, të renditura si vijon.

**28.5.1.** Sipas legjislacionit tonë penal, vepra penale e vjedhjes konsiderohet e konsumuar, pavarësisht vlerës së sendit të vjedhur. Në rastin konkret, vlera e parëndësishme financiare, nuk shmang përgjegjësinë penale, e cila cilësohet sipas paragrafit të dytë të nenit 134 të K. Penal, duke qenë se personi i akuzuar e ka kryer atë dy herë, në harkun kohor të tri javëve.

**28.5.2.** Sipas statistikave të dorëzuara nga subjekti në Komision, rezulton se në periudhën në fjalë, pothuajse për çdo rast të regjistrimit të procedimeve penale për veprën penale të “Vjedhjes”, parashikuar nga neni 134, paragrafi 1 dhe 2 të K. Penal, masat e sigurimit të kërkuara prej organit të prokurorisë kanë qenë ato të “arrestit me burg”, parashikuar nga neni

---

<sup>68</sup> *Materiali kallëzues është mosfilluar me vendimin datë 11.12.2017, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.*

238 i K. Pr. Penale, duke demonstruar një politikë penale represive të të gjithë institucionit, për sa i përket masave të sigurisë për këtë kategori veprash penale.

**28.5.3.** Kërkesa e subjektit të rivlerësimit, si prokurore e çështjes, është miratuar nga gjyqtari i hetimeve paraprake, i cili ka funksion kryesor të tij garantimin në këtë fazë të procesit penal, të të drejtave e lirive të individëve, pavarësisht kërkesave që paraqiten prej organit të akuzës.

**28.5.4.** Kërkesa e prokurores/subjektit për vleftësimin si të ligjshëm të arrestit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit “Arrest me burg”, është shoqëruar me kërkesën për gjykim të drejtpërdrejtë, sipas parashikimit të nenit 400 të K. Pr. Penale, si forma më efikase dhe e shpejtë e procedimit në një proces penal. Neni 400 i Kodit parashikon se kjo formë gjykimi mund të zhvillohet në kushtet e arrestit në flagrancë të autorit dhe pohimit të fajësisë, si dy kushte që lejojnë prokurorin dhe gjykatën të operojnë me këtë rit gjyqësor. Përdorimi i gjykimit të drejtpërdrejtë justifikon, nga pikëpamja e administrimit të procesit penal, mbajtjen e personit nën masën e “arrestit në burg”, pasi kjo masë nuk do t’i shërbejë nevojave të hetimit, por të gjykimit dhe ekzekutimit të vendimit penal të pritshëm, në një kohë të shpejtë.

**28.5.5.** Në gjykimin e drejtpërdrejtë të zhvilluar nga gjykata, subjekti, në cilësinë e prokurores së çështjes, ka kërkuar deklarinim fajtor të të pandehurit për veprën penale të “Vjedhjes”, parashikuar nga neni 134, paragrafi 2 i K. Penal, dhe dënimin e tij me gjashtë muaj burgim, që përfaqëson minimumin e dispozitës. Gjykata e ka dënuar përfundimisht të pandehurin me katër muaj burgim, për shkak të aplikimit të shkurtuar dhe ka vendosur edhe pezullimin e ekzekutimit të këtij dënimi, sipas parashikimit të nenit 59 të K. Penal. Ndërsa subjekti nuk ka ushtruar ankim ndaj këtij vendimi të gjykatës, rezulton se për të pandehurin, e arrestuar në datën 26.11.2017, është urdhëruar lirimi i menjëhershëm nga burgu, në datën 15.12.2017.<sup>69</sup> Kjo mënyrë e të administruarit të procesit prej subjektit ka siguruar ushtrimin me efikasitet të ndjekjes penale dhe zbatim të balancuar të nevojave të sigurimit me ato të përfundimit të procesit penal e ekzekutimit të vendimit të dënimit.

**28.6.** Sa më sipër, lidhur me procedimin penal nr. {\*\*\*/2017, trupi gjykues, ndonëse konstaton si jo të përshtatshme caktimin e masës së sigurimit “Arrest në burg”, për veprën penale të vjedhjes së një sendi me vlerë të parëndësishme, në kuptim të nenit 230 të Kodit të Procedurës Penale, e vlerëson këtë papërshtatshmëri në kontekstin e të gjitha rrethanave të rastit, të cilat tregojnë se në fokusin e subjektit, në kërkesën për caktimin e masës, krahas sanksionit të parashikuar nga neni 134/2 i Kodit Penal, i palidhur me vlerën e sendit të vjedhur, kanë qenë njëkohësisht edhe elemente si efikasiteti i procesit dhe mosrëndimi pa të drejtë i autorit të veprës. Të tilla elementë janë ato që lidhen me kërkesën për gjykim të drejtpërdrejtë, ndjekjen e një politike penale për masat e sigurimit në raste të hetimit të kësaj vepre penale edhe nga prokurorë të tjerë, caktimin e një dënimi me minimumin e sanksionit penal që parashikon dispozita dhe pezullimin e ekzekutimit të tij, pa ushtruar ankim prej subjektit të rivlerësimit. Trupi gjykues i vlerësoi këto elemente, por jo vetëm, në përcaktimin e peshës që do të sillte në vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit, paraqitja e një kërkesë për një masë të papërshtatshme në raport me rastin.

---

<sup>69</sup> *Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan nr. {\*\*\*}, datë 15.12.2017, ka marrë formë të prerë në datën 03.01.2018.*

29. Në përfundim të analizës më sipër, trupi gjykues, duke rikonsideruar qëndrimet e mbajtura sa më lart, në kuadër të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, arriti në konkluzionin se ato nuk janë të mjaftueshme për të konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë. Problematikat e konstatuara në kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe ato të konstatuara në kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, krahasuar edhe me standardin e vlerësimit të përdorur prej Kolegjit, në raste të tjera, rezultuan jobindëse dhe të paaplikueshme për zbatimin e nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.
30. Në këto kushte, trupi gjykues e gjen të pambështetur në prova e në ligj vendimin objekt ankimi dhe, duke konfirmuar se subjekti ka arritur nivel të besueshëm në të tria kriteret e rivlerësimit, siç edhe Komisioni ka pranuar, çmon se vlerësimi i përgjithshëm i tyre, nuk mund të çojë në shkarkimin e saj nga detyra. Për pasojë, vendimi objekt shqyrtimi duhet të ndryshohet.

### **PËR KËTO ARSYE,**

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

### **VENDOSI:**

1. Ndryshimin e vendimin nr. 740, datë 08.03.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Pranvera Stafa.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall në Tiranë, më datë 09.10.2025.

**ANËTAR**

**Sokol ÇOMO**

*nënshkrimi*

**ANËTARE**

**Albana SHTYLLA**

*nënshkrimi*

**ANËTARE**

**Natasha MULAJ**

*nënshkrimi*

**RELATORE**

**Ina RAMA**

*nënshkrimi*

**KRYESUESE**

**Rezarta SCHUETZ**

*nënshkrimi*